



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 71 regjistër (JR)
Datë 17.11.2021

Nr. 33 i vendimit
Datë 08.07.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 08.07.2024, ditën e hënë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Steven Kessler, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 71/2021 (JR), datë 17.11.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin apo prishjen e vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Theo Jacobs, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Sali Hasa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sikundër shprehet në vendimin e tij nr. 433, datë 03.09.2021¹, dhe përfundoi hetimin administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, arriti në konkluzionet, si më poshtë.

Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë, ka rezultuar se:

- a. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1997 – 2016;*
- b. Ka bërë deklaram të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm;*
- c. Ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;*
- d. Ka kryer veprime dhe mosveprime që cenojnë figurën e magjistratit dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.*

Sa më sipër, rezulton se në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Sali Hasa, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar si të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

¹ Shih paragrafin 7, faqe 2 të vendimit të Komisionit nr. 433, datë 03.09.2021.

4. Në përfundim, bazuar në nenin 55, pika 5, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 433, datë 03.09.2021, Komisioni vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë [...]*”.

II. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor Prof. Dr. Ermir Dobjani² (në vijim “përfaqësuesi ligjor”), iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 433, datë 03.09.2021, me pretendimin se ky vendim është marrë në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 179/b, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi, me anë të të cilit Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është rezultat i një vendimmarrjeje të paracaktuar dhe të njëanshme.
6. Subjekti i rivlerësimit e shoqëroi ankimin e tij me akte shkresore³, për të cilat kërkoi marrjen në cilësinë e provave të reja dhe bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016 ka kërkuar nga Kolegji ndryshimin apo prishjen e vendimit të Komisionit nr. 433, datë 03.09.2021.
7. Shkaqet procedurale të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t’u mbrojtur në mënyrë efektive, si për shkak të mosnjohjes me dosjen e plotë të hetimit administrativ, ashtu dhe për shkak të kohës së pamjaftueshme e kushteve të papërshtatshme në të cilat ndodhej;

7.2 Refuzimi i kërkesës për pezullimin e procedurës së rivlerësimit, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata penale ose deri në lirimin fizik të tij, është i pabazuar në ligj;

7.3 Vendimi i Komisionit cenon parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, sipas përcaktimeve të nenit 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 100 të Kodit të Procedurave Administrative;

7.4 Subjekti i rivlerësimit ka qenë i paragjykuar si fajtor jo vetëm penalisht, por edhe nga ana administrative si “prokuror i korruptuar”;

² Shih prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2021.

³ Bashkëlidhur ankimit janë paraqitur aktet: i) njoftim nr. {***} akti., datë 07.07.2021, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; ii) dëftesë postare për dorëzim rekursi pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 18.08.2021; iii) kërkesë me shkrim dore e përfaqësuesit ligjor për marrje të dosjes së rivlerësimit, e regjistruar me nr. {***} prot., datë 21.10.2021; iv) shkresë kthim përgjigje e Komisionit nr. {***} prot., datë 27.10.2021; v) kërkesë e datës 27.10.2021, me lëndë “Kërkesë e përsëritur [...]”; vi) kërkesë e datës 30.10.2021, me lëndë “Kërkesë e ripërsëritur [...]”; vii) deklaratë e përfaqësuesit ligjor e datës 29.10.2021, mbi njohjen me dokumentet e dosjes së rivlerësimit; viii) kërkesë e datës 01.11.2021, me lëndë “Kërkesë e ripërsëritur[...]”; ix) leje qarkullimi automjeti për dy kamionë në pronësi të shtetasit Q. D..

7.5 Komisioni ka cenuar parimin e paanësisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi subjekti i rivlerësimit, jo vetëm nuk është njohur me identitetin e këshilltarëve ekonomikë, por as nuk i është krijuar mundësia për të marrë dijeni e të debatojë mbi metodologjinë e analizës financiare, ndërkohë që tabelat financiare nuk janë shoqëruar me shpjegime të thjeshta e të qarta;

7.6 Komisioni ka cenuar parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit lidhur me masën e shkarkimit në raport me shkeljet e konstatuara dhe në mënyrë të gabuar ka cituar në bazën ligjore të vendimit nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016;

7.7 Dispozitat kushtetuese dhe ligjore mbi procesin e rivlerësimit, cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe bien ndesh me liritë dhe të drejtat e njeriut.

8. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

8.1 Në lidhje me pasurinë “*truall me sipërfaqe 500 m² dhe banesë me sipërfaqe 130 m²*”, subjekti i rivlerësimit pretendon se: *a) Komisioni nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie; b) Komisioni e ka keqkuptuar apo e ka paraqitur të shkurtuar deklarimin e subjektit mbi burimin e krijimit; c) Komisioni ka llogaritur në mënyrë të gabuar vlerën e ndërtimit të banesës sipas çmimeve të EKB-së; ç) Ka burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ka pasaktësi për shumat e shitblerjes së tokës e banesës mbi të.*

8.2 Në lidhje me pasurinë “*apartament me sipërfaqe 163 m², në Durrës*”, subjekti i rivlerësimit pretendon se: *a) Deklarata që ngarkon me përgjegjësi subjektet është deklarata e pasurisë vetting; b) Burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer shuma prej 2.500.000 lekësh nga shitja e banesës në Kavajë; c) Komisioni i referohet në mënyrë të gabuar vlerës së ndërtimit në tregun e lirë për vitin 2005, sipas udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2005”; ç) Detyrimi për deklarimin për herë të parë është vendosur në vitin 2006 me ligjin nr. 9530, datë 11.05.2006; d) Kjo pasuri është përfshirë në mënyrë të gabuar në analizën financiare përpara vitit 2003 ;*

8.3 Në lidhje me pasurinë “*apartament me sipërfaqe 90 m², në Sarandë*”, subjekti i rivlerësimit pretendon se: *a) kredia për blerjen e kësaj pasurie nuk është marrë sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, por është marrë nga bashkëshortja e tij, sipas një vendimi të Këshillit Bashkiak Sarandë; b) pavarësisht se mandatarkëtimi nuk është i njohur nga legjislacioni tatimor, kjo nuk do të thotë se pagesa nuk është kryer; c) dyshimi se çmimi i blerjes ka qenë më i ulët, nuk bazohet në ndonjë element apo indicie për favorizim, përkundrazi, injoron ligjin e kërkesës dhe ofertës, sidomos kushtet e urgjencës që kishte pala shitëse dhe nevojat e saj për para (likuiditet) në momentin e kryerjes së transaksionit.*

8.4 Në lidhje me pasurinë “*tokë kullotë në Himarë*”, subjekti i rivlerësimit pretendon se *nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe se ka shpjeguar bindshëm dhurimin e sipërfaqes prej 1000 m² nga shtetasi V. R..*

8.5 Në lidhje me pasurinë “automjet tip “Mercedes-Benz””, subjekti i rivlerësimit pretendon se: a) *Fatura tatimore e shitjes ku përfshihet edhe TVSh-ja, shërben njëkohësisht edhe si kontratë; b) Komisioni ka llogaritur në mënyrë të gabuar si detyrime edhe penalitetet që nuk i janë kërkuar e as paguar huadhënësit I. M.; c) Komisioni nuk ka kryer hetime në lidhje me huadhënësin dhe në mënyrë të gabuar nuk ka përfshirë si burim të ligjshëm shumën 1.000.000 lekë të marrë hua; ç) Në vendim nuk janë pasqyruar sqarimet e dhëna në kërkesën e datës 24.08.2021 (prapësimet), mbi fitimin neto të huadhënësit dhe depozitat bankare, që provojnë mundësitë për huadhënie; d) Komisioni nuk ka arsyetuar në vendim mbi argumentet e dhëna në prapësime se automjetet kanë qenë të përdorura, shtesës së vlerës për shkak të riparimeve kapitale, çmimet e tyre që kanë qenë të momentit sipas ligjit të kërkesës e ofertës, si dhe kryerjes së transaksioneve në çdo rast me dokumente zyrtare dhe me persona me të cilët nuk ka pasur konflikt interesi (ky i fundit ngrihet si pretendim për të gjitha pasuritë automjete).*

8.6 Në lidhje me pasuritë e luajtshme, automjete tip “Peugeot”, “Audi A4” dhe “Volkswagen”, subjekti i rivlerësimit pretendon se *analiza financiare mbi mundësinë e blerjes së tyre është e gabuar, pasi është pjesore dhe e pambështetur në ligj. Për automjetin tip “Peugeot”, subjekti i rivlerësimit ka ngritur edhe pretendimin se nuk mban përgjegjësi pse e ka deklaruar në ILDKPKI me vonesë shitblerjen e tij.*

8.7 Në lidhje me pasuritë në përdorim, subjekti i rivlerësimit pretendon se *në vendimin e Komisionit nuk janë parashtruar përgjigjet e dhëna ndaj pyetësorëve gjatë hetimit administrativ, dhe arsyet përse nuk janë marrë parasysh.*

8.8 Në lidhje me dhurimin në formën e mbulimit të shpenzimeve të një udhëtimi nga shtetasit J. e M. B., subjekti i rivlerësimit pretendon se *bashkëshortja e subjektit znj. M. H. dhe znj. M. B. (T.) kanë lidhje familjare mes tyre dhe, në këto kushte, nuk mund të flitet për konflikt interesi apo të konsiderohet si humbje e besimit të publikut.*

8.9 Në lidhje me shpenzimet e arsimimit të fëmijëve, subjekti i rivlerësimit pretendon se: a) *Në vendim nuk mund shkruhet “subjekti pretendon” për sa kohë është provuar se dy fëmijët e tij kanë qenë me bursa studimi në Rusi; b) Komisioni, si organ quasi gjyqësor, nuk mund të vendosë standarde mbi shpenzimet e jetesës; c) Për efekt të analizës financiare, duhet të konsiderohet shuma 7.880 euro, e transferuar për fëmijët për studime përmes Western Union, duke qenë se kjo shumë është deklaruar dy herë; d) Për dhurimet e gjyshërve dhe dajës së fëmijëve, është menduar se nuk ishte e nevojshme të deklaroheshin, pasi janë kryer cash.*

8.10 Në lidhje me analizën financiare dhe metodologjinë e përdorur, subjekti i rivlerësimit pretendon se: a) *Komisioni nuk ka tagër që të përllogarisë shpenzimet e subjekteve bazuar në vendimet e KPA-së, sepse çdo rast është individual; b) Është e pakuptueshme se si është llogaritur pamundësia financiare në total, në shumën 15.212.981 lekë; c) Metodologjia financiare me analiza pjesore nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore.*

9. Pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit, paraqiti parashtrime⁴ shoqëruar me akte shkresore, përmes të cilave i ka kërkuar Kolegjit: (i) *Pezullimin e shqyrtimit të ankimit të subjektit Sali Hasa kundër vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, derisa të përfundojë shqyrtimi i rekursit penal të të gjykuarit kundër vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;* (ii) *shqyrtimin e çështjes (JR) nr. 71/2021, që i përket subjektit Sali Hasa në seancë plenare me pjesëmarrjen e palëve, për të debatuar në lidhje me aktin e ekspertimit privat të datës 21.05.2024, që ka përgatitur eksperti z. E. M.;* (iii) *Bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë ndryshimin apo prishjen e vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
10. Subjekti i rivlerësimit vijoi të paraqesë akte shkresore edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike të çështjes në Kolegj, përmes depozitimit të tyre në seancën gjyqësore publike të zhvilluar në datën 24.06.2024 dhe, pas saj, në datën 02.07.2024, si dhe gjatë seancës gjyqësore të datës 04.07.2024, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji që bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin apo prishjen e vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë (në vijim “Kushtetuta”) dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Sali Hasa, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁴ Shih dokument i datës 22.05.2024 i titulluar “Depozitim të akteve të parashtrimeve dhe aktit të ekspertimit financiar” dhe dokument i datës 24.05.2024, i titulluar “Depozitim shtesë për parashtrimet e subjektit të rivlerësimit Sali Hasa”, paraqitur nga përfaqësuesit ligjorë Erajd Dobjani dhe Ermir Dobjani të caktuar, sipas prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2023.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 433, datë 03.09.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankim, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
14. Për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të kryer në Komision, sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, trupi gjykues vlerësoi të trajtojë në fillim shkaqet procedurale të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit dhe të shqyrtojë aktet shkresore të paraqitura bashkëlidhur ankimit dhe në parashtrimet e paraqitura përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi.
15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni i ka cenuar të drejtën për t’u mbrojtur në mënyrë efektive, si për shkak të mosnjohjes me të gjitha dokumentet që janë mbledhur gjatë hetimit administrativ duke iu referuar konkretisht dokumentacionit mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, e drejtë e mohuar edhe përfaqësuesit të tij ligjor, ashtu dhe për shkak të kohës së pamjaftueshme e kushteve të papërshtatshme në të cilat ndodhej, duke shfaqur haptazi një nxitim të paarsyeshëm për caktimin e seancës dëgjimore të datës 01.09.2021.* Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i referohet faktit se në momentin e dërgimit të rezultateve të hetimit nga ana e Komisionit ai ndodhej nën masën e sigurimit personal “Arrest me burg” pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”) “Jordan Misja” e, për këtë arsye, nuk ka pasur mundësinë fizike, kohore, psikologjike dhe kushtet e duhura për të realizuar mbrojtjen e tij bazuar në procesin e rregullt ligjor.

15.1 Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga analiza e akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se: (i) më datë 30.06.2021⁵, Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit pranë ambienteve të IEVP-së “Jordan Misja”, njoftimin mbi përfundimin e hetimit administrativ dhe rezultatet e hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke i kaluar barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të drejtën për t’u njohur e për t’u pajisur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit duke u paraqitur pranë ambienteve të Komisionit çdo ditë brenda orarit zyrtar. Përmes këtij njoftimi, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit edhe të drejtën për të paraqitur prova e shpjegime deri në datën 19.07.2021; (ii) më datë 05.07.2021⁶, subjekti i rivlerësimit, përmes avokatit Erajd Dobjani⁷, duke konfirmuar marrjen dijani të njoftimit mbi përfundimin e hetimit administrativ në datën

⁵ Shih shkresë nr. {***} prot., datë 30.06.2021, e Komisionit me lëndë “Njoftim rezultate hetimi”.

⁶ Shih kërkesën e subjektit të rivlerësimit e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 07.07.2021.

⁷ Shih prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.06.2021, sipas së cilës avokati Erajd Dobjani caktohet si përfaqësues ligjor për përfaqësimin në të gjitha shkallët e hetimit dhe gjykimit të çështjes penale që lidhet me akuzën “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve” të subjektit Sali Hasa.

02.07.2021, në ambientet e IEVP-së “Jordan Misja”, ku mbahej në zbatim të masës së sigurisë “Arrest në burg”, ka kërkuar nga Komisioni që t’i dërgohet një kopje e dosjes së plotë të procedurës së rivlerësimit, përfshirë dhe dokumentacionin mbi kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale; (iii) në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioni i është drejtuar më datë 08.07.2021⁸, avokatit Erajd Dobjani, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, duke e informuar se mund të paraqitej pranë Komisionit për t’u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit dhe për të marrë kopje të tyre; (iv) më datë 12.07.2021⁹, avokati Erajd Dobjani ka informuar Komisionin se ai nuk kishte tagra përfaqësimi të subjektit Sali Hasa në procesin e rivlerësimit, por e përfaqësonte atë vetëm në procesin penal që po zhvillohej ndaj tij, për këtë arsye ka udhëzuar që dokumentacioni i kërkuar dhe çdo lloj njoftimi të bëhej zyrtarisht nëpërmjet postës zyrtare, duke iu drejtuar subjektit të rivlerësimit në vendin ku mbahej i paraburgosur; (v) në datën 13.07.2021, Komisioni i ka dërguar¹⁰ subjektit të rivlerësimit pranë IEVP-së “Jordan Misja” dokumentacionin e procedurës së rivlerësimit në formatin CD, duke i kujtuar afatin e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve deri në datën 19.07.2021; (vi) më datë 19.07.2021 subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar¹¹ Komisionit pezullimin e procedurës së rivlerësimit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për akuzat penale ndaj tij, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Në këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar faktin se në kushtet e paraburgimit, mbrojtja ndaj barrës së provës të dërguar nga Komisioni ishte objektivisht e pamundur për t’u realizuar brenda datës 19.07.2021, jo vetëm për shkak të presionit të madh psikologjik dhe kohor për të përgatitur njëkohësisht mbrojtjen nga akuza penale, por edhe për një sërë shkaqesh të tjera, të tilla si, gjendja e rënduar shëndetësore duke qenë i diagnostikuar me {***} dhe {***}, mungesa e kompjuterit ku mbante korrespondencën e zhvilluar me Komisionin, legjislacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin e dorëzuar, si dhe mungesën e dosjes së hetimit administrativ të Komisionit, ku për këtë të fundit ka informuar se nuk e ka marrë në dorëzim deri në datën e paraqitjes së kërkesës, pra, më 19.07.2021. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kërkesës së tij vendimin nr. {***}, datë 22.06.2021, të KLP-së “Për pezullimin nga detyra të prokurorit Sali Hasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë”, vërtetimin nga mjeku i familjes Sarandë me datë 13.06.2021, mbi diagnozat {***} dhe {***} (patologji kardiake), si dhe mjekimin përkatës; (vii) më datë 26.07.2021, Komisioni i njoftoi subjektit¹² refuzimin e kërkesës për pezullimin e procesit të rivlerësimit dhe njëkohësisht e njoftoi për shtyrjen e afatit për paraqitjen e provave e shpjegimeve deri më datë 01.09.2021, datë në të cilën do të zhvillohej seanca dëgjimore; (viii) më datë 28.07.2021¹³, IEVP “Jordan Misja” ka informuar Komisionin se [...] subjekti, Sali Hasa, i cili ndodhet pranë IEVP “Jordan Misja” me masë sigurie “Arrest në burg”, i ka marrë dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit e dërguar nga KPK-ja, në formatin CD, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.07.2021, më datë 28.07.2021. Shtetasit Sali Hasa i është vënë në dispozicion nga institucioni në mënyrë që t’i mundësohet aksesit që subjekti të përdorë materialin e dërguar në formatin CD një PC [...], por subjekti ka ngritur pretendime se PC është e ngadaltë. Gjithsesi nga ana e institucionit për të evituar pretendimet e tij (më datë 29.07.2021) do i vihat në dispozicion një tjetër PC me qëllim që subjekti të ketë aksesin e nevojshëm në materialin e vënë në dispozicion nga ana juaj [...]. Subjekti i rivlerësimit përmes një shënimi me shkrim dore ka deklaruar se: “Sot në datën 28.07.2021, ora 11:45, mora CD të dërguar nga KPK-ja. E shikoj të pamundur që brenda afatit të kthej përgjigjet, pasi pajisja është shumë e ngadaltë dhe nuk hapen folderat”; (ix) më datë 24.08.2021, subjekti i

⁸ Shih shkresën e Komisionit me nr. {***} prot., datë 08.07.2021.

⁹ Shih shkresë e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 12.07.2021.

¹⁰ Shih shkresë e Komisionit me nr. {***} prot., datë 13.07.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

¹¹ Shih kërkesë e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 21.07.2021.

¹² Shih shkresë e Komisionit nr. {***} prot., datë 26.07.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

¹³ Shih shkresë nr. {***} prot., datë 28.07.2021, e IEVP-së “Jordan Misja”, drejtuar Komisionit.

rivlerësimit depozitoi në Komision shpjegime¹⁴ mbi rezultatet e hetimit në të cilat ka kërkuar, ndër të tjera, pyetjen e disa dëshmitarëve, si dhe marrje provash të reja; (x) më datë 26.08.2021, subjekti i rivlerësimit i dërgoi Komisionit një tjetër kërkesë¹⁵ për pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga gjykata penale ose lirimin e tij fizik, për shkak të pamundësisë për t'u përgatitur në lidhje me barrën e provës së dërguar nga Komisioni dhe seancën dëgjimore të datës 01.09.2021; (xi) më datë 30.08.2021, në përgjigje të kërkesave të tij, Komisioni e ka informuar¹⁶ subjektin e rivlerësimit mbi refuzimin e kërkesës për thirrje dëshmitarësh dhe marrje provash, bazuar në pikën 5, shkronjat “a” dhe “d”, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që sa i takon kërkesës për pezullim ka informuar se ka dhënë përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 26.07.2021; (xi) më datë 31.08.2021, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, IEVP “Jordan Misja” ka informuar se subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij kishte deklaruar se *nuk mund të paraqitet në KPK, pasi nuk disponon veshjen e përshtatshme*; (xii) më datë 01.09.2021, Komisioni zhvilloi seancën dëgjimore në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk mori pjesë dhe nuk u përfaqësua nga ndonjë përfaqësues ligjor.

15.2 Veç sa më sipër, nga analiza e akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve në Kolegj, trupi gjykues konstaton se: (i) me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2021, GjPKKO-ja ka caktuar masën e sigurisë “arrest në burg” ndaj personit nën hetim Sali Hasa, ndërsa me vendimin nr. {***}, datë 21.06.2021, të po kësaj gjykate, është vendosur vazhdimi i kësaj mase sigurimi; (ii) më datë 07.07.2021, përmes njoftimit me nr. {***} akti, është njoftuar avokati Erajd Dobjani se gjykimi në shkallë të dytë i çështjes penale që i përket ankimit ndaj vendimit të masës së sigurimit, cituar më sipër, do të zhvillohet në datën 14.07.2021, i cili më datë 18.08.2021, ka paraqitur rekurs për çështjen penale pranë GjPKKO-së; (iii) pas shpalljes së vendimit të Komisionit nr. 433, datë 03.09.2021, përfaqësuesi ligjor Ermir Dobjani, në datën 21.10.2021, i ka kërkuar Komisionit¹⁷ t'i vihet në dispozicion dosja që ka shërbyer për marrjen e vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit, si dhe çdo dokument tjetër jashtë saj që ka pasur të dhëna për subjektin e rivlerësimit, me qëllim përgatitjen e ankimit ndaj këtij vendimi; (iv) në datën 27.10.2021, Komisioni ka informuar¹⁸ përfaqësuesin ligjor Ermir Dobjani se kopja e dosjes hetimore dhe e seancës dëgjimore të datës 01.09.2021, sikurse i ishte komunikuar në rrugë elektronike një ditë më parë, pra, në datën 26.10.2021, mund të tërhiqej pranë ambienteve të Komisionit brenda orarit zyrtar; (v) po në datën 27.10.2021, përfaqësuesi ligjor, i është drejtuar Komisionit me një tjetër kërkesë me objekt “*Kërkesë e përsëritur për vënien fizikisht në dispozicion të dosjes së procedurës së rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa*”; (vi) përmes deklaratës së datës 29.10.2021, të plotësuar pranë Komisionit, përfaqësuesi ligjor, duke konfirmuar njohjen me dokumentacionin fizik të dosjeve të subjektit që përfaqëson, ka deklaruar se nuk i është plotësuar kërkesa për t'u njohur me raportin e DSIK-së, si dhe raportin e dërguar nga KLGj-ja në lidhje me aftësitë profesionale. Ai ka deklaruar, gjithashtu, se në dosjet e vëna në dispozicion, nuk gjendeshin përgjigjet për shkresat nr. {***} prot., datë 10.04.2020, drejtuar KLP-së, si dhe përgjigjet për shkresën nr. {***} prot., datë 10.04.2020, drejtuar

¹⁴ Ky dokument titullohet “*Kërkesë, për marrje provash dhe pyetje të dëshmitarëve*”, datë 24.08.2021, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.08.2021.

¹⁵ Shih kërkesë e subjektit të rivlerësimit e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 27.08.2021.

¹⁶ Shih shkresë e Komisionit me nr. {***} prot., datë 30.08.2021.

¹⁷ Shih kërkesë e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 21.10.2021.

¹⁸ Shih shkresë e Komisionit me nr. {***} prot., datë 27.10.2021.

Prokurorisë së Përgjithshme; (vii) në datën 30.10.2021, përfaqësuesi ligjor i është drejtuar Komisionit me një tjetër kërkesë me objekt *“Kërkesë e ripërsëritur për njohje të të gjithë dokumentacionit të dosjes për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa”*, në të cilën ka kërkuar t’i viheshin në dispozicion aktet e cituara në deklaratën e datës 29.10.2021; (viii) në datën 01.11.2021, përfaqësuesi ligjor i është drejtuar sërish Komisionit me kërkesë me objekt *“Kërkesë e ripërsëritur për njohje të të gjithë dokumentacionit të dosjes për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa”*, në të cilën, përveç sa kërkohej në kërkesën e mëparshme të datës 30.10.2021, ka kërkuar edhe disa vendime të marra nga Komisioni referuar vendimit përfundimtar; (ix) sipas Aktit të Ekspertimit Mjeko-Ligjor nr. {***}, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, mbi gjendjen shëndetësore të shtetasit Sali Hasa të kryer me kërkesë të GjPKKO-së, me vendimin e datës 28.03.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit [...] është diagnostikuar dhe vuan nga {***}, {***}, si dhe {***}. Sëmundjet nga të cilat është diagnostikuar ky shtetas janë kronike, të cilat mund të trajtohen në kushtet e paraburgimit. Rekomandohet të ndiqet me konsulta nga specialistë të fushës”.

15.3 Bazuar në situatën e fakteve më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni, me njoftimin mbi përfundimin e hetimit administrativ në datën 30.06.2021, e ka informuar subjektin e rivlerësimit lidhur me faktin se pavarësisht administrimit të raporteve përkatëse për të tria kriteret e vlerësimit, hetimi administrativ kishte përfunduar vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë duke i vënë në dispozicion atij dhe përfaqësuesit ligjor dokumentacionin mbi këtë kriter. Në vlerësimin e trupit gjykues, Komisioni ka përmbushur detyrimin ligjor duke i bërë me dije subjektit të rivlerësimit çështjet për të cilat provat kanë pasur nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 e, po në zbatim të kësaj dispozite, i ka dhënë subjektit të rivlerësimit aksesin vetëm në dosjen e hetimit administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke nënkuptuar që dhënia e aksesit në dokumentacionin që i përket kriterit të kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale do të ishte në varësi të mbrojtjes për barrën e provës kaluar atij për kriterin e pasurisë. Po kështu, trupi gjykues vëren se pas shpalljes së vendimit objekt shqyrtimi, përfaqësuesi ligjor është paraqitur në Komision në datën 29.10.2022 dhe ka nënshkruar një deklaratë në të cilën konfirmon faktin se është njohur me dosjen e subjektit që ai përfaqëson, përveç dokumentacionit që lidhet me kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale. Në kushtet kur vendimmarrja e Komisionit është bazuar vetëm në kriterin pasuror, trupi gjykues e konsideron të përmbushur detyrimin ligjor të Komisionit për t’i garantuar subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit të tij ligjor aksesin në dosjen e procedurës së rivlerësimit.

15.4 Në vijim të analizimit të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se në harkun kohor nga njoftimi i rezultateve të hetimit më datë 30.06.2021, deri në zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka qenë nën masën e sigurisë “Arrest me burg”¹⁹ dhe mbahej pranë IEVP-së “Jordan Misja”, institucion pranë të cilit i është dërguar edhe njoftimi mbi përfundimin e hetimit administrativ dhe rezultatet e hetimit. Ndonëse në dijëni të faktit se subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e mungesës së lirisë fizike, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me dosjen e hetimit administrativ dhe për të marrë kopje të saj, duke u paraqitur pranë ambienteve të tij çdo ditë, brenda orarit zyrtar, duke i caktuar një afat prej 19

¹⁹ Caktuar me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2021, të GjPKKO-së.

(nëntëmbëdhjetë) ditësh për të paraqitur prova e shpjegime mbi rezultatet e hetimit. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se Komisioni i ka dërguar subjektit të rivlerësimit dosjen e procedurës së rivlerësimit në formatin CD pranë IEVP-së “Jordan Misja” 13 (trembëdhjetë) ditë pas njoftimit të tij të parë mbi rezultatet e hetimit, pa i dhënë një afat shtesë për paraqitjen e provave apo shpjegimeve në lidhje me barrën e provës, por duke i kujtuar që afati për paraqitjen e tyre do të ishte ai i njoftuar më parë, pra, pas 6 (gjashtë) ditësh. Dosja e hetimit administrativ u morr në dorëzim nga subjekti i rivlerësimit pranë IEVP-së 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas datës së dërgimit të saj nga Komisioni dhe, për këtë arsye, ky i fundit e zgjati me 1 (një) muaj, deri në datën e mbajtjes së seancës dëgjimore, afatin e paraqitjes së shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit. Ndonëse në një procedurë administrative, sipas nenit 151²⁰ të Kodit të Procedurave Administrative, ndër vendet e njoftimit përcaktohen edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, trupi gjykues vlerëson se në një proces të tillë si procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, dhe kërkohet natyrshëm impenjim maksimal për t’iu përgjigjur nevojave të procesit të rivlerësimit në fazën përfundimtare të tij, dërgimi i njoftimit mbi përfundimin e hetimit administrativ dhe rezultatet e hetimit në të tilla rrethana nuk do t’i mundësonin subjektit të rivlerësimit mbrojtjen e nevojshme.

15.5 Mbështetur në këtë arsyetim, trupi gjykues e gjen të pajustificuar procedurën e ndjekur nga Komisioni për dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ në kushtet e mungesës së lirisë fizike të subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, e vlerëson të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës së tij për mbrojtje efektive. Kjo sjellje e Komisionit u vlerësua se ka cenuar të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor dhe, për këtë arsye, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me qëllim konstatimin e plotë të situatës faktike, trupi i gjykues vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me çështjen e tij para Kolegjit. Në këtë mënyrë, trupi gjykues i vlerësoi të korrigjuara gabimet procedurale të kryera nga Komisioni gjatë procedurës së rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, i çmoi të zgjidhura të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkeljet nga ana e Komisionit të parimeve të përgjithshme në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

- 16.** *Refuzimi i kërkesës për pezullim të procedurës së rivlerësimit nga ana e Komisionit deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata penale ose deri në lirim fizik të subjektit të rivlerësimit është e pabazuar në ligj dhe as praktikë në kuadër të një hetimi të plotë.*

16.1 Në shqyrtim të këtij shkak ankimi, bazuar në situatën e fakteve të përshkruara në paragrafin 15.1 më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesat e subjektit për pezullimin e procedurës së rivlerësimit deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë nga gjykata penale për akuzën e ngritur ndaj tij apo deri në lirim fizik, ka vendosur refuzimin e tyre

²⁰ Neni 151, pika 1, shkronja “b” parashikon: “1. Njoftimi bëhet në: [...] b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”.

me arsyetimin se procesi administrativ, që po zhvillohet në kuadër të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, nuk lidhet dhe nuk është në varësi të procesit penal që po zhvillohej ndaj tij. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar një kërkesë të tillë edhe me parashtrimet e paraqitura në Kolegj²¹, duke kërkuar *pezullimin e shqyrtimit të ankimit të subjektit Sali Hasa kundër vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, derisa të përfundojë shqyrtimi i rekursit penal të të gjykuarit Sali Hasa kundër vendimit nr. {***}, datë 23.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës në Kolegj printim nga faqja e internetit të Gjykatës së Lartë “*Detajet e çështjes*” me nr. {***}, në të cilën është publikuar data e regjistrimit të rekursit të subjektit të rivlerësimit Sali Hasa, më 17.07.2023, akt për të cilin trupi gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vendosi refuzimin e marrjes në cilësinë e provës, duke qenë i aksesueshëm në burime të hapura²².

16.2 Për t’iu përgjigjur pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Kolegjit²³, sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është një proces i një natyre të posaçme, i cili zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe autonome nga çdo proces tjetër gjyqësor që gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vend. Nëse procesi i rivlerësimit për subjekte të ndryshme do të duhej të kushtëzohej nga procedimet civile, penale apo administrative, Kushtetuta dhe ligji do të kishin përcaktuar shprehimisht detyrat për institucionet e rivlerësimit dhe procedurat që do të duhej të ndiqeshin për të mundësuar efikasitetin e procesit të rivlerësimit që rrjedhin nga kohëzgjatja e procedimeve të tjera të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se vendimi objekt shqyrtimi është bazuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe jo në rezultatin e procedimit penal të regjistruar ndaj subjektit të rivlerësimit e, për pasojë, vlerëson se nuk plotësohen kushtet për pezullimin e gjykimit, sipas nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile. Bazuar në këtë arsyetim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

17. *Vendimi i Komisionit cenon parimin e arsytimit të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 57, pika 4 e ligjit nr.84/2016 dhe të nenit 100 të Kodit të Procedurës Administrative, pasi: (i) në vendim nuk është arsyetuar përse hetimi është kryer vetëm për kriterin e pasurisë dhe në përmbajtje të tij nuk është parashtruar asnjë gjetje apo konkluzion në lidhje me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) në vendimin e Komisionit nuk janë parashtruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit të dhëna në përgjigje të pyetësorëve dhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, provat e paraqitura dhe kërkesat me shkrim të tij dhe as është arsyetuar për rrëzimin e tyre; (iii) mosmarrja parasysh e prapësimeve, provave apo kërkesave që ka paraqitur subjekti me kërkesën e dërguar në datën 24.08.2021 është e pabazuar dhe nuk referohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile apo Kodit të Procedurave Administrative, ku bazohet kërkesa; (iv) në*

²¹ Në parashtrimet e datës 22.05.2024.

²² Linku i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë: <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/search?term=Sali%20Hasa>

²³ Vendimet nr. 22 (JR), datë 22.06.2022 dhe nr. 51 (JR), datë 12.12.2023, të Kolegjit.

paragrafin 23, shkronja “e” e vendimit, parashtrohet se subjekti ka bërë shpjegime me shkrim në seancë dëgjimore, ndërkohë që ai nuk ka qenë prezent.

17.1 Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se vendimi objekt ankimi është marrë duke u bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Kjo dispozitë ligjore e vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, bën që vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, të mos cenojë parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

17.2 Në vijim të analizimit të shkakut të ankimit, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se për secilën pasuri të hetuar është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit, si dhe fakti nëse shpjegimet apo provat e sjella prej tij kanë mundur ose jo të përmbysin barrën e provës. Fakti që në vendimin e Komisionit nuk janë cituar në mënyrë analitike të gjitha shpjegimet apo aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk nënkupton apo provon mungesë analize të shpjegimeve dhe akteve, përkundrazi, trupi gjykues vëren se Komisioni ka mbajtur qëndrime për çështje të caktuara, argumentuar me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë dhe të argumentojë deri në atë masë sa të përmbysë barrën e provës, çka dëshmon në vetvete se provat e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi nga ana e trupit gjykues. Kjo tregon që Komisioni ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre, nga pritshmëritë dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk tregon se ka munguar vlerësimi për to. Megjithatë duke mbajtur parasysh pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur në mënyrë të plotë prova dhe shpjegime, në vlerësimin e trupit gjykues edhe analiza e tyre në vendimin e Komisionit ka qenë e cunguar dhe jo e plotë, për këtë arsye trupi gjykues vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të shqyrtojë çështjen në prani të subjektit të rivlerësimit, duke i dhënë mundësinë për t’u dëgjuar dhe paraqitur prova të reja përpara trupit gjykues të Kolegjit, duke i garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

17.3 Sa i takon pretendimit tjetër për mospasqyrimin në vendim të kërkesave të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se pasqyrimi i tyre nuk përbën një ndër elementët e detyrueshëm të vendimit, sipas nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Detyrimi i Komisionit në rastin e kërkesave për marrje prove është që refuzimi i tyre të bëhet me vendim të arsyetuar, duke argumentuar shkaqet e refuzimit, sipas nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që jo të gjitha kërkesat e depozituara nga subjekti rezultojnë të jenë kërkesa për marrje provash. Në rastin konkret, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vëren se Komisioni i është përgjigjur me shkrim dy kërkesave të subjektit për pezullimin e procesit të rivlerësimit me anë të shkresave nr. {***} prot., datë 26.7.2021 dhe nr. {***} prot, datë 30.08.2021. Lidhur me kërkesën e datës 24.08.2021, përmes së cilës subjekti i rivlerësimit, ndër

të tjera, ka kërkuar marrjen e provave të reja dhe thirrje dëshmitarësh²⁴, rezulton që Komisioni, në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.08.2021, ka informuar subjektin e rivlerësimit për refuzimin e saj, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Qëndrimi i Komisionit lidhur me këto kërkesa është pasqyruar në paragrafët 14.2 dhe 14.3 të vendimit objekt ankimi. Në analizë të këtyre fakteve, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka përbushur detyrimin ligjor, sipas nenit 49, pikat 6 dhe 9 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, për t’u përgjigjur me shkrim ndaj subjektit të rivlerësimit. Për sa cituar në vendimin nr. 433, datë 03.09.2021, paragrafi 23, shkronja “e” se *Komisioni ka marrë në analizë ndër të tjera dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore*, ndërkohë që subjekti nuk ka qenë i pranishëm në këtë seancë, trupi gjykues e vlerëson si një pakujdesi të karakterit material, për sa kohë në përmbajtje të vendimit nuk rezulton të jetë pasqyruar ndonjë shpjegim konkret. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit përmban elementet bazë të vendimit, përshkrimin e rrethanave të çështjes, analizën e provave të administruara për kriterin e pasurisë, si dhe përfundimet e arritura lidhur me to, sikurse parashikohet në nenin 57, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

18. *Komisioni ka paragjykuar negativisht subjektin e rivlerësimit për rrethanat e rastit që u krijuan në qershor 2021 që lidhen me arrestimin e tij më datë 19.06.2021, jo vetëm penalisht, por edhe nga ana administrative si “prokuror i korrumpuar”, dhe se ka qenë e planifikuar që procesi i rivlerësimit të tij duhej kryer sa më shpejt për ta hequr nga lista e madhe e vetting-ut. Njoftimi për zhvillimin e seancës dëgjimore një ditë përpara zhvillimit të saj, në kushtet kur ai nuk kishte mundësi të paraqitej i veshur në mënyrë dinjitoze e serioze, por me pranga në duar dhe i shoqëruar nga policia, përbën tentativë për trajtim poshtëruës, sipas nenit 3 të KEDNj-së, në të cilën parashikohet se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.*

18.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimit për subjektin Sali Hasa ka nisur me shortimin e tij në datën 12.11.2019²⁵ dhe, në një hark kohor prej 1 (një) vit, 7 (shtatë) muaj e 18 (tetëmbëdhjetë) ditë nga kjo datë, deri në datën e dërgimit të rezultateve të hetimit, më 30.06.2021, Komisioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin e rivlerësimit përmes dërgimit të 4 (katër) pyetësorëve dhe administrimit të përgjigjeve të tyre, përkatësisht në datat 16.01.2020, 22.04.2020, 08.06.2020 dhe 09.06.2021. Një kohëzgjatje e tillë, në një periudhë gjatë së cilës ka pasur ndërveprim aktiv mes subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit, dëshmon se ka qenë kohë më se e mjaftueshme për këtë të fundit për të pasur një vendimmarrje të pa nxituar dhe të pa ndikuar nga rrethana të jashtme. Pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, se ai ka qenë i paragjykuar si “prokuror i korrumpuar”, ndonëse i pakuptimtë në kushtet kur nuk provohen motivet për një vendimmarrje të paragjykuar, për sa kohë që vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm si në drejtim të

²⁴ Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar: (i) të pyeten si dëshmitarë shtetasit H. L. dhe H. (G.) L.; (ii) të thirren dhe të pyeten si dëshmitarë 5 (pesë) personat që kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2021, Sh. A., Ll. Sh., K. D., G. H., G. Q. dhe tre avokatët A. P., G. M. dhe A. S., nga Kavaja; (iii) të kërkojnë në degët e bankave të nivelit të dytë në Durrës dhe Kavajë, të dhënat për depozita bankare për periudhën 2006 - 2010, në emër të I. M..

²⁵ Link: <https://kpk.al/njoftim-143/11/>

shkaqeve me natyrë procedurale, ashtu edhe atyre themelore nga ana e Kolegjit, nga kontrolli i procedurës së ndjekur nga Komisioni, verifikimi i përmbajtjes së vendimit, por edhe rezultateve të hetimit, trupit gjykues nuk i rezulton ndonjë sjellje paragjyquese apo të jetë përdorur një gjuhë e tillë në drejtim të subjektit të rivlerësimit.

18.2 Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *njoftimi për zhvillimin e seancës dëgjimore një ditë më parë se të zhvillohej, në kushtet kur ai nuk kishte mundësi të paraqitej i veshur në mënyrë dinjitoze e serioze, por me pranga në duar dhe i shoqëruar nga policia përbën tentativë për trajtim poshtërues*, trupi gjykues, në referim të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, vëren se me shkresën nr. {***} prot., datë 26.07.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, Komisioni e ka informuar atë, ndër të tjera, edhe për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 01.09.2021. Në kërkesën e datës 26.08.2021 drejtuar Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shprehet se [...] *Në lidhje me shkresën tuaj “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 26.07.2021, drejtuar personit tim, ku më bëni të ditur se kërkesa ime për pezullim të procedurës së vetting-ut nuk merret në konsideratë, sepse procesi administrativ i rivlerësimit kalimtar nuk lidhet apo është në varësi të procesit penal që po zhvillohet ndaj meje, si dhe se më datë 01.09.2021 është planifikuar për t’u zhvilluar seanca dëgjimore ndaj meje [...].* Nga analiza e këtyre akteve, përkundër sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ai ka marrë dënimin për datën e seancës dëgjimore të paktën 5 (pesë) ditë përpara zhvillimit të saj, kohë e mjaftueshme edhe për të marrë masa për një veshje të përshtatshme, sipas konceptit të tij, njësoj sikurse do të kishte vepruar nëse do të paraqitej përpara gjykatës së juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për tentativë për trajtim poshtërues të tij nga ana e Komisionit.

- 19.** *Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe parimin e gjykatës së paanshme, për arsye se: (i) mosnjohja me identitetin e këshilltarëve ekonomikë nuk garanton zbatimin e parimit të paanësisë dhe ekzistencën e konfliktit të interesit me ta; (ii) ekspertët që kanë kryer analizat financiare nuk janë caktuar sipas kërkesave që ka parashikuar Kodi i Procedurës Civile në nenet 225 – 230 të tij; (iii) subjekti nuk i është krijuar mundësia që të njihet me metodologjinë e përdorur nga këshilltarët ekonomikë dhe, tabelat e paraqitura nuk janë shoqëruar me shpjegime të thjeshta dhe të qarta për t’i krijuar mundësi subjektit të rivlerësimit që të kuptojë dhe të debatojë lidhur me to; (iv) subjekti nuk ka pasur mundësi të konsultohet me një ekspert financiar dhe për këtë kërkon nga Kolegji kryerjen e një ekspertimi financiar. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës në Kolegji²⁶ dy akte ekspertimi privat “Mbi analizën financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e z. Sali Hasa nga viti 1982 deri në vitin 2016”, të hartuara nga kontabilisti i miratuar E. M.²⁷ të datave 21.05.2024 dhe 21.06.2024.*

19.1 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mosbërja me dije e emrave të ekspertëve të cilët kanë kryer analizat financiare nuk garanton zbatimin e parimit të paanësisë dhe ekzistencën e konfliktit të interesit, në vlerësimin e trupit gjykues është i pabazuar në ligj, pasi referuar nenit 30 të Kodit të Procedurës Administrative, nëpunësi publik, i cili i nënshtrohet zbatimit të kësaj norme, duhet të ketë kompetenca vendimmarrëse në procedurën administrative objekt kontrolli. Duke qenë se

²⁶ Me parashtrimet e datës 22.05.2024 dhe në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024.

²⁷ Person Fizik “E. M.”, me NIPT {***}, objekt “Kryerja e shërbimeve të kontabilitetit”.

analiza financiare kryhet nga këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, e cila referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, nuk ka kompetenca vendimmarrëse në çështjet e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi përpara rastit të shkeljes së dispozitave ligjore për konfliktin e interesit dhe parimin e paanësisë. Trupi gjykues sjell në vëmendje se këshilltarët ekonomikë nuk janë ekspertë në kuptim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, por detyrat dhe kriteret për zgjedhjen e tyre janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, që kanë të bëjnë me mosnjohjen e metodologjisë së përdorur për analizën financiare, paqartësinë e tabelave financiare dhe pamundësinë e tij për të debatuar lidhur me to, ndonëse nga verifikimi i dokumentit “Rezultate hetimi për subjektin e rivlerësimit” evidentohen tabela të analizës financiare qartësisht të lexueshme, shoqëruar me shpjegime për metodologjinë e përdorur nga Komisioni për kryerjen e analizës financiare dhe tabelën përmbledhëse të analizës financiare të hartuar për të gjithë periudhën e rivlerësimit, në kushtet që trupi gjykues i Kolegjit konstatoi shkelje në procedurën e ndjekur nga Komisioni, me pasojë cenimin e të drejtës së subjektit të rivlerësimit për mbrojtje efektive, me vendim të ndërmjetëm vendosi të çelë hetimin gjyqësor e të pranojë në cilësinë e provës, ndër të tjera, edhe dy aktet e ekspertimit të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, duke i garantuar në këtë mënyrë zbatimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në lidhje me analizën financiare.

20. *Komisioni ka cenuar parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi masa e shkarkimit nuk është proporcionale me shkeljet e konstatuara, me qëndrimin pozitiv dhe bashkëpunimin ndaj procesit të rivlerësimit, si dhe për shkak se nuk janë mbajtur parasysh koha dhe rrethanat e realitetit shqiptar që kanë kaluar gjithë subjektet e rivlerësimit nga viti 1990. Komisioni në mënyrë të gabuar në bazën ligjore të këtij vendimi ka cituar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që subjekti është shkarkuar vetëm për kriterin e pasurisë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit referon pikën 24²⁸ të Komentarit “Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë”, si dhe nenin 14²⁹ të Kodit të Procedurës Administrative.*

20.1 Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se referuar dispozitave të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës³⁰ së konsoliduar të Kolegjit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit tërësor të çështjes dhe synon që masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara dhe e bazuar vetëm në standarde objektive. Në vendimin objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer, jo vetëm deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/016, por ka kryer veprime e mosveprime që cenojnë figurën e magjistratit dhe humbasin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, të cilat kualifikohen, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Siç do të shtjellohet rast pas rasti në vijim të këtij vendimi, këto shkelje që kanë çuar në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, qoftë më vete apo në vlerësimin harmonik dhe të përgjithshëm të tyre, vlerësohen nga trupi gjykues si të tilla që nuk lejojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Edhe pretendimi tjetër i subjektit se aplikimi i nenit 61,

²⁸ Në këtë pikë parashtrohet: “Kjo specifike që paraqet realiteti shqiptar pas viteve 90 imponon respekt të parimit të proporcionalitetit një vlerësim diskrecionar të aseteve konkrete nga organet përkatëse [...]”.

²⁹ Në nenin 14 të Kodit të Procedurës Administrative, përcaktohet: “[...] organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”.

³⁰ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2 (JR), datë 27.02.2020, nr. 20 (JR) datë 08.09.2020, nr. 36 (JR), datë 16.12.2020 dhe nr. 24 (JR), datë 16.12.2020.

pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kërkon vlerësimin në të tria kriteret e kontrollit të subjekteve të rivlerësimit, në vlerësimin e trupit gjykues është i pabazuar në ligj, pasi dispozitat e ligjit nr. 84/2016 nuk e lidhin aplikimin e këtij konkluzioni në formë kumulative me secilin prej kriterëve. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut lidhet me vlerësimin tërësor, sipas kuptimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kritere apo vlerësimin tërësor të procedurave, ku në rastin konkret, sikurse arsyetohet në paragrafin 75 të këtij vendimi, aplikimi i kësaj dispozite i referohet vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë.

21. *Dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe bien ndesh me liritë dhe të drejtat e njeriut. Subjekti i rivlerësimit referon dispozita dhe nocione të cilat sipas tij janë të papërcaktuara, të tilla si: “të ardhura të ligjshme”, “shpjegim bindshëm”, “besimi i publikut te sistemi i drejtësisë”. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje faktin që dispozitat kushtetuese dhe ligjore, të cilat rregullojnë procesin e rivlerësimit, iu janë nënshtruar dhe kanë kaluar filtrat e analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, fillimisht nga Komisioni i Venecias³¹ e më pas nga Gjykata Kushtetuese përmes vendimeve nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78/2017, që ka gjykuar pajtueshmërinë e ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën. Trupi gjykues çmon, gjithashtu, se referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: [...] është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...], përdorimi nga Komisioni i koncepteve të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit të cilit i përkasin.*
22. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i rivlerësimit i kishte bashkëlidhur ankimit, si dhe akteve të përcjella bashkëlidhur parashtrimeve të tij në Kolegji, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë në zbatim të së cilës u pranuan provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të hetimit të mëtejshëm të çështjes.
23. Me vendim të ndërmjetëm të datës 24.06.2024, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë në cilësinë e provës aktet e paraqitura në formën e duhur ligjore³², si dhe

³¹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e)

³² i) Akt ekspertimi privat i datës 21.06.2024; ii) nxjerrje lëvizje llogarie në Raiffeisen Bank ShA, për subjektin Sali Hasa, për periudhën 2011-2017; iii) shkresat nr. {***} prot., nr. {***} prot., nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., datë 30.05.2024, të Komisarariatit të Policisë Sarandë, mbi hyrje-daljet në kufi sipas raportit të Transportation Information Management System (në vijim “TIMS”) të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve për periudhën 01.1.2004 – 31.12.2016; iv) certifikatë familjare e shtetases M. B.; v) certifikatë familjare e familjes T.; vi) certifikatë familjare e familjes S.; vii) certifikatë familjare e familjes D.; viii) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2023; ix) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2021; x) akt ekspertimi privat i datës 21.05.2024; xi) mandatpagesat nr. {***}, datë 02.10.1996 dhe nr. {***}, datë 20.11.1996, lëshuar nga arka e shoqërisë “{***}”.

të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit që aktet e paraqitura jo në formën e duhur ligjore³³ t'i paraqesë, deri në datën 02.07.2024. Trupi gjykues vendosi, gjithashtu, të mos marrë në cilësinë e provës aktet të cilat janë printime nga burime të hapura³⁴, me argumentin se mund t'i aksesonte ato drejtpërdrejt nëse do të paraqitej nevoja, si dhe disa akte të cilat janë tashmë të administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes.

24. Me vendim të ndërmjetëm të datës 04.07.2024, trupi gjykues, pasi konstatoi se aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në datën 02.07.2024³⁵ dhe ato të paraqitura gjatë seancës gjyqësore publike të datës 04.07.2024³⁶, plotësonin kërkesat ligjore, vendosi pranimin e tyre në cilësinë e provës, dhe njëkohësisht vendosi rrëzimin e kërkesës së përfaqësuesit ligjor, për të kërkuar të dhëna bankare në lidhje me huadhënësin I. M., me arsyetimin që në zbatim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në kuadër të procesit të rivlerësimit është subjekti i rivlerësimit ai që ka barrën e provës për të provuar shterimin e të gjitha mjeteve ligjore për të siguruar informacionin e nevojshëm mbi provueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për personin tjetër të lidhur, ndërkohë që dokumentacioni i paraqitur nuk provonte përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për të shteruar të gjitha mjetet procedurale të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

³³ i) Shkresë nr. {***} prot., datë 12.05.2022, e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe akte shoqëruese; ii) tabelë përmbledhëse mbi shuma parash të dërguara nëpërmjet Western Union, në periudhën 2004 – 2010, shoqëruar me kopje të transfertave; iii) veprim arke kryer në Raiffeisen Bank ShA, me përshkrim pagesa për bileta avioni; iv) veprim arke kryer në Bankën e Kursimeve, datë 02.04.2004; v) veprim arke kryer në Raiffeisen Bank ShA, datë 04.04.2005; vi) deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie e vitit 2003; vii) dokument në gjuhën ruse me nr. {***}, datë 14.01.2022 dhe nr. {***}, datë 15.01.2020; viii) veprim arke kryer në Raiffeisen Bank ShA, datë 19.04.2006; ix) kontratë shitblerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.03.2002; x) kontratë shitblerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2003; xi) njoftim nr. {***} akti, datë 07.07.2021 dhe dokumenti postar mbi dorëzimin e rekursit; xii) vërtetim nr. {***}, datë 15.01.2020, nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; xiii) vërtetim nr. {***} prot., datë 31.03.2021, nga Shërbimi Informativ Shtetëror (në vijim "ShISH") mbi të ardhurat e M. H.; xiv) kërkesë me nr. {***} prot., datë 21.10.2021, për marrje të dosjes së rivlerësimit; xv) shkresë kthim përgjigje e Komisionit nr. {***} prot., datë 27.10.2021; xvi) kërkesë e datës 27.10.2021, me lëndë "Kërkesë e përsëritur [...]"; xvii) kërkesë e datës 30.10.2021, me lëndë "Kërkesë e ripërsëritur [...]"; xviii) Deklaratë e përfaqësuesit ligjor e datës 01.11.2021; xix) kërkesë e datës 01.11.2021, me lëndë "Kërkesë e ripërsëritur [...]"; xx) leje qarkullimi automjeti për dy kamionë në pronësi të shtetasit Q. D..

³⁴ i) Printim nga Zyra e Shtypit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e datës 24.03.2010, mbi bursat e studimit në Rusi për vitin akademik 2010 - 2011; ii) kopje e faqes on-line të Gjykatës së Lartë, për datën e regjistrimit të rekursit.

³⁵ Aktet janë paraqitur me vërtetimet e njësisë me origjinalin me nr. {***} rep., datë 28.06.2024; nr. {***} rep., datë 28.06.2024; nr. {***} rep., datë 28.06.2024; nr. {***} rep., datë 26.06.2024; nr. {***} rep., datë 04.06.2024; nr. {***} rep., datë 04.06.2024; nr. {***} rep., datë 26.06.2024; nr. {***} rep., datë 26.06.2024 dhe nr. {***} rep., datë 26.06.2024.

³⁶ i) Aktmarrëveshje e sigurimit vullnetar për M. H. dhe kontribut vullnetar; ii) mandatarëkëtim i datës 25.04.2001, për derdhje kontributi vullnetar nga M. H. në Bankën e Kursimeve; iii) librezë kontributesh për sigurimet shoqërore për vitet 1996 - 2000; iv) librezë pune e M. H.; v) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 28.05.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës; vi) kërkesë e datës 11.11.2021, drejtuar Institutit të Statistikave; vii) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 02.12.2021, e Institutit të Statistikave; viii) komunikim elektronik i datës 24.11.2021, kthim përgjigje nga Instituti i Statistikave; ix) shkresë nr. {***} prot., datë 13.07.2021, e Komisionit; x) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 28.07.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; xi) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 28.01.2020, e ASHK-së Vlorë; xii) kërkesë e datës 05.07.2021, për kopje të njehsuar të të gjitha dokumenteve [...]; xiii) shkresë nr. {***} prot., datë 08.07.2021, e Komisionit; xiv) njoftim i datës 09.07.2021, i avokatit Erajd Dobjani; xv) kërkesë e datës 19.07.2021, për pezullimin e procedurës së rivlerësimit; xvi) shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.07.2021, e Komisionit; xvii) kërkesë e datës 24.08.2021, për marrje provash dhe pyetje dëshmitarësh.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

Në lidhje me pasurinë “Truall me sipërfaqe 500 m² dhe banesë me sipërfaqe 130 m², në Kavajë”

25. Komisioni në vendimin e ankimit ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, nuk justifikon shpenzimet e kryera për ndërtimin e karabinasë me sipërfaqe 130 m² në Kavajë, si dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e ligjshëm financiar në shumën e deklaruar prej 2.000.000 lekësh, e cila është deklaruar se ka shërbyer për ndërtimin e këtij objekti. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Kundër këtyre konkluzioneve, subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim dhe në parashtrimet e tij në Kolegj disa pretendime, që trajtohen në vijim.
26. Komisioni nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me burimin e krijimit të ndërtesës me sipërfaqe 130 m², pasi nuk ka kërkuar të dhëna për personin e lidhur Z. D. dhe se, duhet saktësuar se biznesi nuk ishte i familjes së tij, por i babait të bashkëshortes, i cili ka hapur biznesin bar-kafe, të regjistruar që në vitin 1992-2005 dhe ka paguar rregullisht detyrimet tatimore. Sipas subjektit, bashkëshortja e tij ka punuar në këtë biznes gjatë kësaj periudhe, por ka paguar sigurime vullnetare vetëm për 5 (pesë) vite dhe në total ka përfituruar 1.500.000 lekë. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh tradita e popullit shqiptar që vajza nuk mund t’i kërkonte babait kontratë, si dhe ajo që babai nuk mund të shfrytëzonte vajzën e tij të martuar dhe që kishte fëmijë për të ushqyer.

26.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit analizoi fillimisht deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting dhe deklaramet e interesave privatë të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, në drejtim të burimit të financimit të kësaj pasurie, nga të cilat konstaton se: (i) Në deklaratën e pasurisë vetting deklarohet: (a) Në datën 01.09.1998 kam blerë nga shtetasi G. S. S. një sipërfaqe trualli prej 500 m², për shumën 400.000 lekë me kontratë paraprake me avokat dhe e formalizuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2001, pas marrjes vërtetim pronësie”. Vlera e pasurisë: “400.000 lekë. Gjendje cash 1.100.000 lekë”, 100%; (b) Në këtë truall është ndërtuar një banesë, në karabina me sipërfaqe 130 m², e filluar me shumën e mbetur cash dhe të ardhura nga paga e bashkëshortes, të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996-2001. Shpenzime ndërtimi gjithsej 2.000.000 lekë. [...]. Për të mbështetur deklaramet e tij, në lidhje me të ardhurat nga paga të bashkëshortes M. H. në periudhën 1996 – 2001, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (a) aktmarrëveshje e sigurimit vullnetar nr. {***} për periudhën 01.01.1996 – 31.12.2000, lidhur mes M. H. dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; (b) mandatarkëtimi i datës 25.04.2001 për derdhjen në Bankën e Kursimeve të vlerës 148.135 lekë me përshkrim “Derdh kontribut vullnetar periudha 12.01.1996 – 31.12.2001”; (c) dokument i titulluar “Kontribut – vullnetar” në shumën që duhet paguar në vlerën 147.840 lekë; (ç) librezë kontributesh për sigurim shoqëror në emër të M. H., për periudhën 1996 – 2000. (ii) Në deklaram i pasurive, të detyrimeve financiare të

të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ose deklarimi para fillimit të punës³⁷ (në vijim “DPFP”) të vitit 2004, deklarohet : (a) Truall ndërtimi të blerë nga G. S. e Rr. S. prej 500 m² në vlerën 500.000 lekë më datë 09.05.2001; (b) Shtëpi banimi të ndërtuar mbi këtë truall, e pa përfunduar, me vlerë 2.000.000 lekë më datë 20.10.2001; (c) Në rubrikën “Të ardhurat” deklarohen shitje e truallit dhe e banesës së papërfunduar, në vlerën 2.500.000 lekë, sipas kontratë shitblerjeje me datë 19.03.2004; [...].

26.2 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni, duke marrë shkas nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, që një ndër burimet që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit karabina në vlerën 2.000.000 lekë kanë qenë *të ardhurat nga paga e bashkëshortes, të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996 – 2001*, pa dhënë specifikime mbi përkatësinë e biznesit, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve³⁸ dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore³⁹ mbi anëtarët e familjes⁴⁰, nga ku nuk rezultuan të dhëna që ata të kishin ushtruar aktivitetet tregtar. Pas kërkesës së Komisionit për të depozituar dokumentacion justifikues për të provuar burimin financiar të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit karabina, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *[...] për ndërtimin e karabinasë, si burim i të ardhurave kanë qenë të ardhura të bashkëshortes time, të kursyera, e cila ka punuar si banakiere në biznesin privat të familjes së saj, konkretisht të babait të saj, të ndjerit Z. D. në qytetin e Kavajës. Për periudhën që ka punuar në këtë aktivitet, subjekti pretendon se bashkëshortja ka paguar sigurimet shoqërore vullnetare, duke depozituar kopje të librezës së kontributeve në emër të saj për vitet 1996-2000 dhe mandatarkëtim të datë 25.04.2001, paraqitur edhe më parë me deklaratën e pasurisë *vetting*. Ndërsa, me përgjigjet e pyetësorit 3, subjekti ka sqaruar se *të ardhurat nga puna e bashkëshortes në biznesin familjar me babain e saj, të ndjerin Z. D., në lokalin “{***}”, që kishin në qytetin e Kavajës, janë përdorur për të paguar detyrimet që lindnin ndaj punëtorëve që kryenin punime, në ndërtimin fillimisht të themeleve të banesës, pastaj të mureve dhe atyre që kanë mbuluar me soletë banesën e ndërtuar.**

26.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me konstatimet si vijojnë: (i) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar, i cili ka shërbyer për ndërtimin e karabinasë, në shumën e pretenduar nga subjekti prej 2.000.000 lekësh dhe 3.624.140 lekësh;* (ii) *nuk konfirmohet punësimi i bashkëshortes së subjektit te aktiviteti tregtar në emër të personave të lidhur me të (babai), për të cilin është deklaruar burimi i të ardhurave për ndërtimin e kësaj pasurie.* Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaroi se bashkëshortja e tij ka punuar pranë bar-kafesë së hapur që në vitin 1992 e deri në vitin 2005 nga babai i saj Z. D.. Ajo punonte në këtë biznes si banakiere, rreth 8 (tetë) orë çdo ditë dhe babai i paguante *cash* çdo muaj 25.000 lekë. Për të vërtetuar faktin se shtetasi Z. D. ka pasur aktivitet tregtar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, shkresën nr. {***} prot., datë 28.05.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore

³⁷ Dorëzuar në ILDKPKI më datë 17.03.2005.

³⁸ Shih shkresë nr. {***} prot., datë 10.04.2020, e Komisionit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

³⁹ Shih shkresë nr. {***} prot., datë 10.04.2020, e Komisionit drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

⁴⁰ Familja e subjektit të rivlerësimit, sipas përbërjes së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, përbëhet nga katër anëtarë: subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja M. H., i biri L. H. dhe e bija A. H..

Durrës. Për të vërtetuar faktin se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme, ka paraqitur prokurë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.04.2006, sipas së cilës 6 (gjashtë) trashëgimtarët e Z. D.⁴¹ kanë caktuar përfaqësues të tyre z. Q. D. për të tërhequr shumën e depozituar nga trashëgimlënësi në Raiffeisen Bank ShA, dega Kavajë, në shumën 2.652.475 lekë, më datë 19.04.2006, 1/6 e të cilës, i takoi bashkëshortes, M. H.. Ndërsa për të vërtetuar punësimin e bashkëshortes pranë biznesit të babait të saj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklarata noteriale të disa qytetarëve të Kavajës⁴², për të cilat ka kërkuar nga Komisioni të thirren e të pyeten si dëshmitarë.

26.4 Veç sa më sipër, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj në datën 22.05.2024, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për të ardhurat nga pagat e bashkëshortes M. H. për periudhën 1996-2001, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë karabina, duhet të mbahet parasysh paga minimale e caktuar nga shteti në këto vite, dhe se këtyre të ardhurave duhet t'u shtohen edhe të ardhurat nga pagat e realizuara nga puna e saj pranë ShISh-së, për periudhën 1991-1995. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj vërtetimin nr. {***} prot., datë 31.03.2022, të këtij institucioni, referuar të cilit të ardhurat *neto* nga pagat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës në fjalë rezultojnë në vlerën 33.368 lekë.

26.5 Për t'iu përgjigjur pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se kuadri kushtetues dhe ligjor që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016, kanë përcaktuar qartë detyrimin që barra e provës në procesin e rivlerësimit i takon subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të kësaj dispozite, nga analiza e situatës së fakteve të përshkruar më sipër, trupi gjykues vëren se hetimi administrativ i Komisionit ka nisur fillimisht ndaj rrethit të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, që në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, janë bashkëshorti/ja e subjektit të rivlerësimit, i biri dhe e bija⁴³, i orientuar nga deklarimi i bërë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilin në asnjë moment nuk specifikohet apo qartësohet se *biznesi familjar* ka qenë i babait të bashkëshortes, Z. D.. Megjithatë, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka saktësuar gjatë procesit të rivlerësimit se si burim krijimi për ndërtimin e karabinasë kishin shërbyer të ardhurat nga puna e bashkëshortes në biznesin e babait të saj, trupi gjykues vëren se Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion justifikues këto të ardhura dhe në përfundim të hetimit administrativ ka përmbushur edhe detyrimin ligjor, duke i kaluar subjektit barrën e provës, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për mungesë dokumentacioni provues lidhur me burimin e krijimit të objektit karabina.

⁴¹ Bazuar në dëshminë e trashëgimisë, sipas vendimit nr. {***}, datë 07.03.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

⁴² i) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 24.08.2021, e shtetasit A. P.; ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2021, e shtetasit L. M.; iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.08.2021, të shtetasit A. S.; iv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2021, të shtetasve Sh. A., Ll. Sh., K. D., G. Gj. dhe G. Q.

⁴³ Neni 3, pika 13 përcakton: "Person i lidhur" është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit".

26.6 Lidhur me deklaratat noteriale të disa qytetarëve të Kavajës, për të cilët subjekti ka kërkuar edhe thirrjen e pyetjen e tyre në cilësinë e dëshmitarëve nga Komisioni për të provuar marrëdhënien e punësimit të bashkëshortes në biznesin e babait të saj, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji ka tashmë një qëndrim të konsoliduar⁴⁴, sipas së cilit deklaratat noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit nuk kanë efekt provues në këtë proces, nëse nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara. Në rastin konkret, trupi gjykues nuk konstaton në dosjen gjyqësore ndonjë dokument të kohës apo të afërt me kohën, që të provojë punësimin e M. H. në aktivitetin ekonomik të babait të saj Z. D. apo shumën e të ardhurave të përfituara nga ky punësim, si në DPFPP-në e vitit 2004, ashtu dhe në deklaratën *e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie ose deklarimi i parë*, i vitit 2003, të plotësuar në funksionin e punonjësit të Ministrisë së Rendit Publik të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës me parashtrimet në Kolegji. Dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga bashkëshortja M. H. për periudhën 01.01.1996 – 31.12.2000, duke qenë kontribute mbi bazë vullnetare, në vlerësimin e trupit gjykues nuk provojnë marrëdhënien e punësimit dhe të ardhurën konkrete të përfituar prej saj. Po kështu, edhe prokura e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.04.2006, me të cilën përfaqësuesi i trashëgimtarëve të Z. D., Q. D., ka tërhequr nga Raiffeisen Bank ShA, dega Kavajë, më datë 19.04.2006 shumën 2.652.475 lekë, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar ekzistencën e të ardhurave të bollshme të babait të bashkëshortes, në vlerësim të trupit gjykues nuk jep informacion mbi masën konkrete të të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në periudhën në fjalë. Referimi i subjektit të rivlerësimit të *tradita*, në vlerësimin e trupit gjykues, mund të justifikohet vetëm në drejtim të mungesës së një kontrate pune mes bashkëshortes së tij dhe babait të saj për shkak të marrëdhënies së posaçme, por nuk mund të shihet e lidhur me detyrimin ligjor për pagesën e detyrimeve përkatëse. Në të tilla kushte, në mungesë të një kontrate për shkak të marrëdhënies të posaçme mes babait dhe vajzës së tij dhe çdo të dhënë tjetër të kohës⁴⁵, mbetet e paprovuar marrëdhënia e punësimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në biznesin e babait dhe, për më tepër, shuma konkrete e të ardhurave të përfituara. Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes, në biznesin e babait të saj Z. D., nuk përmbushin standardin e kërkuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme në analizën financiare të kryer në funksion të verifikimit të burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

26.7 Sa i takon, pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, që të ardhurave të bashkëshortes nga puna pranë biznesit të babait në periudhën 1996-2001, duhet t’u shtohen edhe të ardhurat nga paga e saj në ShISH për periudhën 1991-1995, trupi gjykues konstaton se këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim krijimi të pasurisë objekt shqyrtimi. Megjithatë, edhe nëse këto të ardhura, që rezultojnë në vlerën 33.368 lekë, do të konsideroheshin si një ndër burimet e krijimit të pasurisë, në vlerësimin e trupit gjykues nuk do të

⁴⁴ *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), nr. 11/2019 (JR) dhe nr. 34/2019 (JR).*

⁴⁵ *Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji [...] e bazojnë vendimin e tyre vetëm [...] në prova që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.*

sillnin ndonjë ndikim të qenësishëm në analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi do të reduktonin diferencën negative në vlerën respektive.

27. *Komisioni e ka paraqitur të shkurtuar ose e ka keqkuptuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit mbi burimin e krijimit, në paragrafin 2.4 të vendimit. Sipas subjektit në deklarimin “shuma e mbetur cash” duhet pasur parasysh shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Kavajë, në vlerën 1.500.000 lekë. Nga kjo shumë është paguar blerja e truallit prej 500 m² dhe i kanë mbetur 1.000.000 lekë, që i ka përdorur për ndërtimin e banesës prej 130 m² në Kavajë.*

27.1 Nga shqyrtimi i pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me përmbajtjen e vendimit⁴⁶, trupi gjykues konstaton që deklarimi i kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*⁴⁷ është paraqitur në mënyrë korrekte në vendim. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni mund të ketë keqkuptuar deklarimin e tij mbi burimin e krijimit, trupi gjykues vlerësoi ta analizojë në raport me konkluzionin e arritur nga Komisioni për këtë pasuri. Nga kontrolli i arsyetimit në vendim, trupi gjykues konstaton se Komisioni konkluzionin e tij, për mungesë të burimeve financiare të ligjshme të ndërtimit të banesës karabina me sipërfaqe 130 m² në vlerën 2.000.000 lekë, ia atribuon mungesës së ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga puna pranë biznesit të babait të saj Z. D., ndërsa në lidhje me burimin tjetër të financimit të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si *shuma e mbetur cash*, nuk ka mbajtur ndonjë qëndrim. Edhe nga kontrolli i analizës financiare për periudhën para vitit 2003 dhe 2003-2016 të Komisionit, pasqyruar në tabelën në faqen 32 të vendimit, trupi gjykues konstaton se në të rezulton të jetë e përfshirë si e ardhur e ligjshme shuma prej 1.500.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Kavajës në vitin 1998, ndërsa çmimi i truallit me sipërfaqe 500 m² është llogaritur në vlerën 500.000 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen këtë pretendim jorelevant për shqyrtim në raport me konkluzionin e arritur nga Komisioni për këtë çështje.

28. *Komisioni në mënyrë të gabuar ka llogaritur vlerën e ndërtimit të banesës prej 130 m², sipas çmimeve të EKB-së, për faktin se ajo ishte karabina, pra, vetëm mure dhe çati, pa punimet hidraulike dhe elektrike dhe pa pajisjet përkatëse. Sipas subjektit, ndërtimi i objektit është bërë prej tij dhe jo me shoqëri ndërtimi.*

28.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se Komisioni, përmes pyetësorëve 2 dhe 3 i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime mbi periudhën e saktë të ndërtimit të karabinasë dhe të paraqesë dokumentacion shoqërues lidhur me pagesat në vlerën 2.000.000 lekë kryer për këtë pasuri. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar: *“Për shkak se ka kaluar një kohë shumë e gjatë, nuk kam ruajtur*

⁴⁶ Në paragrafin 2.4 të vendimit, Komisioni shprehet: *“Subjekti ka deklaruar se mbi këtë truall është ndërtuar një banesë në fazën e karabinasë me sip. 130 m², e filluar me shumën e mbetur cash dhe nga të ardhurat nga paga e bashkëshortes, të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996-2001. Shpenzime ndërtimi gjithsej 2.000.000 lekë”.*

⁴⁷ Në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohet: *“Në datën 01.09.1998 kam blerë nga shtetasi G. S. S. një sipërfaqe truall prej 500 m², për shumën 400.000 lekë me kontratë paraprake me avokat dhe e formalizuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2001, pas marrjes vërtetim pronësie”. Vlera e pasurisë: “400.000 lekë. Gjendje cash 1.100.000 lekë”, 100%; (ii) Në këtë truall është ndërtuar një banesë, në karabina me sipërfaqe 130 m², e filluar me shumën e mbetur cash dhe të ardhura nga paga e bashkëshortes, të ushtruar në biznesin familjar në vitet 1996-2001. Shpenzime ndërtimi gjithsej 2.000.000 lekë. [...]”.*

ndonjë dokument [...] për blerjen e materialeve që kanë shërbyer për ndërtimin e karabinasë me sipërfaqe 130 m² në Kavajë, për shumën e deklaruar 2.000.000 lekë. Në atë kohë kur janë ndërtuar banesa karabina [...] rreth vitit 1998, deri në shitjen e saj shtetasit H. L., nuk janë mbajtur akte dhe nuk janë kryer veprime bankare për të paguar punën e punëtorëve dhe materialet e blera nga persona të ndryshëm, që shisnin me pakicë apo me shumicë materiale ndërtimi. Nuk kam ruajtur ndonjë dokument që të provojë faktin se janë kryer shpenzime në shuma të caktuara për blerjen e këtyre materialeve dhe pagesën për punën e bërë nga punëtorët. Punimet janë kryer në vitin 1998 dhe nuk mund të paramendoja se do të vinte një ditë që duhej të ruheshin këto dokumente për t'i deklarua, apo që në vitin 2004 do të filloja punë si prokuror”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁴⁸, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “[...] mbi këtë tokë kam filluar të ndërtoj pa leje një banesë njëkatëshe qysh në vitin 1998, me sipërfaqe 130 m². Punimet nuk i kam bërë me ndonjë firmë ndërtimi, por kam punuar edhe vetë dhe me ndihmën sidomos të vëllait tim I. H., i cili ka pasur dhe ka profesion murator dhe bojaxhi [...]. Mua më kanë ndihmuar si punëtorë pa pagesë edhe 2 burrat e motrave të mia, si dhe shokë e miq në Kavajë, fakt që ka qenë traditë në atë zonë kur bëheshin shtëpitë familjare dhe nuk punësoheshin specialistë me pagesë. Kurse materialet e ndërtimit si çimento, hekur, rërë, gëlqere etj., i kam blerë tek tregtarët e shumicës me para në dorë. Transportin e këtyre materialeve e bënte pa pagesë vëllai i gruas time Q. D., që ka pasur mjet transporti për materiale ndërtimi që nga viti 1992 e deri nga viti 2015, gjë që vërtetohet me dokumentacion nga Drejtoria e Mjeteve të Transportit Rrugor në Durrës [...]”.

28.2 Për sa sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion që objekti me sipërfaqe 130 m² ndërtuar mbi truallin 500 m² ndodhur në Kavajë ishte në fazë karabina, si dhe nuk ka depozituar situacione punimesh, fatura tatimore etj., për të provuar vlerën e shpenzuar për ndërtimin e ndërtesës me sipërfaqe 130 m², trupi gjykues, referuar edhe përcaktimeve të pikës 26⁴⁹ të Udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095 , datë 10.10.2016, e vlerëson të drejtë llogaritjen e vlerës së ndërtimit 3.624.140 lekë, sipas koston mesatare në shkallë republike për ndërtimin e banesave nga EKB-ja për vitin 1998, përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 28.04.1999. Sa i takon dokumenteve leje qarkullimi automjeti e datës 28.01.1993 për kamion të markës IFA dhe datës 12.10.1998 për kamion të markës Büssing në pronësi të shtetasit Q. D. përfituar me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.10.1997, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj në cilësinë e provës, në mbështetje të pretendimit se nuk ka paguar kosto për transportin e materialeve të ndërtimit, në vlerësimin e trupit gjykues nuk përbëjnë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit e, si

⁴⁸ Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës: (i) ka mungesë dokumentacioni ligjor për ndërtimin e objektit (mungesë leje ndërtimi dhe akte të tjera që vërtetojnë ndërtimin e objektit). Duket se subjekti ka kryer ndërtim pa leje. Gjithashtu, subjekti nuk paraqiti dokumentacion për të provuar ndërtimin e kryer; (ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit karabina me sip. 130 m², në Kavajë, në shumën e deklaruar prej 2.000.000 lekësh; (iii) në analizën financiare, ndërtimi në fjalë është vlerësuar me koston e EKB, sipas Udhëzimit të KM-së nr. 214, datë 28.04.1999, në vlerën prej 3.624.140 lekësh.

⁴⁹ Pika 26 e udhëzimit të sipërcituar, përcakton: “Për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë kryer ndërtime, shtesa ose rikonstruksione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.”.

të tilla, vlerësohen pa ndikim në vendimmarrje, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

29. *Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për këtë pasuri dhe se nuk ka asnjë pasaktësi për shumat e shitblerjeve të tokës dhe banesës së ngritur mbi të.*

29.1 Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, megjithëse ka arritur në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri ka qenë i pamjaftueshëm, i pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, në përfundim i ka atribuuar atij vetëm pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Nga përmbajtja e vendimit, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin për deklarim të pasaktë e ka lidhur me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* se ndërtesa me sipërfaqe 130 m² është shitur me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2004, ndërkohë që kjo ndërtesë nuk ka qenë objekt i kësaj kontrate. Kurse mospërputhjet mes deklaratës së pasurisë *vetting* dhe kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, lidhur me vlerën e blerjes së tokës me sipërfaqe 500 m², Komisioni i ka lënë në nivel konstatim fakti, pa i atribuuar ndonjë pasojë ligjore. Në kushtet kur të ardhurat e përfituara nga shitja e ndërtesës me sipërfaqe 130 m² pretendohen nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i një tjetër pasurie që trajtohet në vijim, trupi gjykues vlerëson që qëndrimin e tij lidhur me këtë fakt ta mbajë në kuadër të analizimit të burimit të pasurisë pasardhëse. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues, bazuar në arsyetimin në paragrafët e mësipërm, kontrollon përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj analizën financiare të kryer në Komision, për të gjitha shpenzimet e kryera në periudhën e marrë në analizë, jo vetëm për pasurinë objekt kontrolli, nga ku rezultoi diferencë negative në vlerën (-) 8.576.698 lekë.

30. *Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për ndërtimin e banesës me sipërfaqe 130 m², duke u gjendur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

Në lidhje me pasurinë “Apartament me sipërfaqe 163 m², në Durrës”

31. Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim kontradiktor, të pasaktë dhe të rremë lidhur me vlerën dhe burimin e ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e saj, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.* Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këto konkluzione duke ngritur në ankim dhe parashtrime pretendimet që analizohen në vijim.
32. *Deklarata e cila vendos përballë përgjegjësisë subjektin e rivlerësimit është deklarata *vetting*, ndërsa deklarimet përpara vitit 2016 nuk merren parasysh, pasi ligji nuk ka fuqi prapavepruese dhe se nuk është kryer deklarim i rremë. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit i referohet Komentarit “Mbi reformën kushtetuese dhe në sistemin e drejtësisë⁵⁰”. Me parashtrimet*

⁵⁰ Citon se: “Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me deklaratën *vetting* dhe jo me interesat privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja. Këto të fundit nuk mund të shërbejnë si

në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës edhe dy kontrata shitblerjeje⁵¹, që i përkasin banorëve të tjerë të pallatit, për të vërtetuar faktin se ai ka kryer deklarime të sakta në lidhje me këtë pasuri, pasi vlera për metër katror e apartamentit të blerë prej tij është më e lartë se çmimi i blerjes së apartamenteve sipas këtyre kontratave.

33. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se përveç kuadrit ligjor⁵², sipas së cilit deklarimet e paraqitura më parë pranë ILDKPKI-së mund të shërbejnë si prova në këtë proces, Kolegji ka tashmë edhe një jurisprudencë të konsoliduar⁵³ lidhur me vlerën e deklarimeve periodike, sipas së cilës kontrolli i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe krahasimi i saj me deklarimet e mëparshme i shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij, nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar etj. Bazuar në këtë arsytim, trupi gjykues kontrollon vërtetësinë e deklaramit të kryer nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke e analizuar në raport me deklarimet e tij në deklaratat e interesave periodikë privatë vjetorë (në vijim “DIPP”) të dorëzuara më parë në ILDKPKI dhe dokumentacionin justifikues të administruar në dosjen gjyqësore, nga të cilat konstaton se:

33.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Në vitin 2001 është lidhur kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2001, formalizuar mbi marrëveshjen verbale me ndërtuesit A. M. dhe M. Ç., bërë në vitin 1999, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 163 m² në Durrës, për vlerën 50.000 USD. Pjesa takuese: 100%. Në vijim deklaron: Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2005, është blerë banesa e porositur sipas kontratës së porosisë të vitit 2001 me M. Ç. e A. M., për një vlerë prej 1.700.000 lekësh, redaktuar nga noter M. K., në Durrës. Burimi i kësaj shume është prishja e depozitës së kursimit në emër të bashkëshortes në Bankën e Kursimit Durrës. Mbeten gjendje cash 800.000 lekë. Ky apartament është bërë i banueshëm në vitin 2012 me gjendjen dhe me kursimet familjare për 7 (shtatë) vite. Shpenzime 1.700.000 lekë për blerjen e apartamentit. Mbeten cash 800.000 lekë dhe bëhet i banueshëm apartamenti me to dhe me kursimet për 7 (shtatë) vite.*

33.2 Në DPFP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë pasuri, ndërkohë deklaron: *Depozitë me afat në Bankën e Kursimit Durrës, me të ardhura nga shitja e truallit e banesës së pa përfunduar. Vlera: 2.500.000 lekë.100%. Data e krijimit: 19.03.2004.*

shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. [...] Kjo sepse subjekti i rivlerësimit nuk mund të shkarkohet për një shkak që Kushtetuta dhe ligji i kohës nuk e parashikonin”.

⁵¹ i) Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.03.2002, të lidhur mes shtetasit A. M. në cilësinë e shitësit dhe blerësit H. F. me objekt shitblerjeje e apartament me sipërfaqe 127,5 m², me çmim 1.800.000 lekë; ii) kontratë shitblerjeje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2003, mes shitësit H. Ç. dhe blerësit Gj. Th., me objekt shitblerjeje apartament me sipërfaqe 134,8 m², me çmim 1.900.000 lekë.

⁵² Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelitimit”.

⁵³ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit: nr. 6/2018 (JR); nr. 7/2018 (JR); nr. 8/2018 (JR); nr. 9/2018 (JR); nr. 10/2018 (JR); nr. 12/2018 (JR); nr. 9/2019 (JR) dhe nr. 19/2019 (JR).

33.3 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sip. 153 m² e përfunduar nga firma “{***}”, Durrës. Nuk ka ndryshime të tjera, por gjendja është si në deklarimin e vitit 2004. Nuk deklarohet vlera e pasurisë. Në rubrikën “Detyrime financiare”, deklaron: *Nuk kam asnjë detyrim financiar personave juridikë ose fizikë brenda e jashtë vendit.**

33.4 Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sipërfaqe 153 m² e përfunduar nga firma “{***}”, Durrës. L. nr. {***}, rr. {***}, ap. {***}, me kontratë sipërmarrje që nga viti 1999. Shlyer me këste deri në momentin e regjistrimit në ZVRPP-në Durrës, 500.000 lekë çdo vit. Vlera e pasurisë është deklaruar 50.000 USD, pjesa takuese 100%. Në vijim, deklaron: *Pakësuar depozita nga Raiffeisen Bank për shumën gjendje depozitë për pagimin e këstit të fundit. 2.500.000 lekë.**

33.5 Nëpërmjet kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2001, administruar në dosjen e Komisionit, porositi Sali Hasa porositi nga sipërmarrësi, shoqëria “{***}” ShPK⁵⁴, përfaqësuar nga M. Ç.⁵⁵ e A. M., ndërtimin e një apartamenti 3+1, me sipërfaqe ndërtimi 163,3 m², me çmim 50.000 USD. Sipas kontratës, kjo vlerë do të likuidohet nga porositi si vijon: (i) kësti i parë në datën e lidhjes së kontratës e barabartë me shumën 6.500 USD likuiduar më datë 01.02.2001 dhe 6.500 USD më datë 15.02.2001; (ii) kësti i dytë në vlerën 6.500 USD më datë 28.02.2001 dhe 6.500 USD më datë 15.03.2001; (iii) kësti i tretë në vlerën 6.000 USD do të likuidohet më datë 15.04.2001, 6.000 USD më datë 15.05.2001 dhe 6.000 USD më datë 15.06.2001; (iv) kësti i fundit, prej 12% të vlerës totale të apartamentit 6.000 USD, do të likuidohet me dorëzimin e apartamentit dhe pa kryerjen e kësaj pagese, apartamenti nuk dorëzohet për banim. Sipërmarrësi detyrohet të përfundojë apartamentin deri më datë 30.10.2001.

33.6 Referuar dokumentacionit të përcjellë në Komision nga AShK, Drejtoria Vendore Durrës⁵⁶: (i) pasuria “apartament”, nr. {***}, sipërfaqe 163,28 m², figuron e regjistruar në bashkëpronësi të A. M. dhe H. Ç., prej datës 01.11.2001; (ii) sipas kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2005, pala shitëse A. M. dhe H. Ç. deklarojnë se apartamentin e banimit në bashkëpronësi të tyre të regjistruar në ZVRPP-në Durrës me nr. {***}, z.k. {***}, sipërfaqe ndërtimi 163,28 m², ia kanë shitur palës blerëse Sali Hasa, në vlerën 1.700.000 lekë të likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. *Në këtë kontratë blerësi ka deklaruar se ka marrë apartamentin në dorëzim dhe nuk ka asnjë pretendim ndaj shitësve;* (iii) subjekti i rivlerësimit Sali Hasa ka aplikuar për regjistrimin e kësaj pasurie më datë 30.06.2005⁵⁷.

33.7 Gjatë hetimit administrativ⁵⁸, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrimin se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2001 dhe pagimi i kësteve sipas saj nuk janë respektuar asnjëherë, për arsye se firma ndërtuese nuk kishte kryer punimet me korrektësi, por i

⁵⁴ Në bazë të leje ndërtimi nr. {***}, datë 08.08.2000, dhe leje sheshi ndërtimi nr. {***}, datë 20.06.2000, është ndërtuar banesë tetëkatëshe.

⁵⁵ Në kontratën e shitblerjes dhe certifikatën për vërtetim pronësie ky shtetas ka gjeneralitetet H. Ç..

⁵⁶ Shih shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 27.7.2020, e AShK, Drejtoria Vendore Durrës drejtuar Komisionit.

⁵⁷ Shih kërkesë për regjistrim dhe lëshim certifikate nr. {***}, datë 30.06.2005.

⁵⁸ Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, pas kërkesave të Komisionit për të dhënë sqarime mbi shlyerjet, këstet e pagesave, burimin financiar të kësaj blerje, arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike 2004, arsyet e mosdeklarimit të vlerës në vitin 2005, si dhe të paraqesë prova për vërtetuar pagesat e kryera.

kishte zvarritur ato në vite, deri në vitin 2005. Për këto arsye, ishte rënë dakord mes palëve që të hartohej kontrata e shitjes së këtij apartamenti në karabina e papërfunduar (pa pajisje, vetëm me muret e suvatuara), për vlerën 1.700.000 lekë. Subjekti ka deklaruar se burimi financiar për këtë banesë vjen nga pakësimi i depozitës në vlerën 2.500.000 lekë që bashkëshortja e tij ka pasur në Bankën e Kursimeve, dega Durrës, tërhequr në vitin 2004, nga e cila 1.700.000 lekë është paguar për likuidimin e çmimit të apartamentit sipas kontratës së shitblerjes, ndërsa 800.000 lekë ishin gjendje në shtëpi. Sipas tij, kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2004, për shkak se ende nuk ishte realizuar kontrata e shitjes dhe nuk ishte e regjistruar në regjistrat publikë, kurse sa i takon mosdeklarimit të vlerës së apartamentit në deklaratën e vitit 2005, në vlerësimin e subjektit, për sa kohë kishte dorëzuar kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti në të cilën ishte vendosur edhe çmimi i shitjes, ishte parë e panevojshme vendosja e vlerës së blerjes. Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, duke deklaruar se apartamenti ishte blerë në shumën 1.700.000 lekë me akt noterial, për shkak se firma e ndërtimit nuk e respektoi kontratën e porosisë, e paguar nga shuma prej 2.500.000 lekësh që përfitoi nga shitja e banesës në Kavajë. Sipas subjektit, edhe sot pas mbi 15 vitesh, ai nuk ka mundur ta shesë këtë pasuri, për shkak të cilësisë së dobët të punimeve që ka kryer firma ndërtuese.

33.8 Bazuar në situatën e fakteve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar pasurinë e porositur me kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2001, në vlerën 50.000 USD, në DFPF-në e vitit 2004 dhe as në deklaratën *e personit që mbart detyrimin për deklarim* të vitit 2003, të paraqitur në cilësinë e provës në Kolegji; (ii) nuk ka deklaruar detyrime ndaj palëve të treta që buronin nga kjo kontratë, madje në DIPP-në e vitit 2005, ai deklaroi se nuk ka detyrime financiare; (iii) ka bërë deklarime të ndryshme për vlerën e pasurisë, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar vlerën 1.700.000 lekë, në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar vlerën 50.000 USD; (iv) ka bërë deklarime kontradiktore gjatë hetimit administrativ kur ka deklaruar se nuk është respektuar kontrata e porosisë sa i takon likuidimit të vlerës të apartamentit me sipërfaqe 163,28 m², ndërsa në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar *pakësuar depozita në Raiffeisen Bank ShA për shumën gjendje depozite në vlerën 2.500.000 lekë, për pagimin e këstit të fundit*, çka konfirmon faktin se të gjitha këstet e tjera sipas kontratës së sipërmarrjes janë likuiduar, ndërsa kësti i fundit është paguar në vitin 2006; (v) në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar që *në vitin 2001 është lidhur kontratë sipërmarrje nr. {***} rep./kol., datë 20.04.2001, formalizuar me marrëveshje verbale me ndërtuesit A. M. dhe M. Ç. në vitin 1999, [...], ndërsa në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep./kol., datë 20.04.2001, përcaktohet se leja e ndërtimit nr. {***}, datë 08.08.2000 dhe leje sheshi nr. {***}, datë 20.06.2000, të KRrT-së Durrës, janë dhënë në vitin 2000.*

33.9 Në konkluzion të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i kësaj pasurie të porositur me kontratë sipërmarrje më datë 20.04.2001, në DFPF-në e vitit 2004, fakti që në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi detyrime, deklarimet e ndryshme në lidhje me vlerën e apartamentit dhe pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të tij në deklaratë e pasurisë *vetting* krahasuar me DIPP-në e vitit 2006, deklarimet kontradiktore gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, si dhe mospërputhjet mes deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, provojnë të kundërtën e asaj që është deklaruar në deklaratën e

pasurisë *vetting*, se çmimi i blerjes së kësaj pasurie është 1.700.000 lekë, me burim krijimi depozitën e bashkëshortes në Bankën e Kursimeve në vitin 2004 e krijuar me të ardhura nga shitja e truallit dhe banesës karabina në qytetin e Kavajës, dhe që pagesa sipas kontratës së porosisë për çmimin 50.000 USD nuk është zbatuar ndonjëherë. Ekzistenca e këtyre mospërputhjeve e shoqëruar me mungesën e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 50.000 USD, sikurse argumentohet më poshtë, i krijojnë trupit gjykues bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me këtë pasuri. Për rrjedhojë të këtij arsyetimi, edhe dy kontratat e shitblerjes të paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, u konsideruan pa ndikim në vendimmarrjen e trupit gjykues lidhur me këtë çështje.

34. *Si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer shuma prej 2.500.000 lekësh nga shitja e banesës në Kavajë, e cila është depozituar pas disa ditësh me interes në bankë në Durrës dhe që është e ardhur e ligjshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, shitja e kësaj pasurie nuk është bërë me akt noterial, për arsye se duke qenë një objekt pa leje ndërtimi ajo nuk mund të regjistrohej sipas ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndërsa vërtetimi noterial i deklarimit të palëve blerëse dhe shitëse për pagesën në shumën 2.500.000 lekë për objektin 130 m² përbën provë me shkrim dhe ka vlerë sipas neneve 246, 253 e 257 të Kodit të Procedurës Civile. Për vlerën 500.000 lekë për shitjen e truallit, mbi të cilin është ndërtuar banesa, është paguar detyrimi tatimor.*
35. Nga kontrolli i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni pasojën ligjore, për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, e ka lidhur me mungesën e ligjshmërisë së depozitës bankare në Bankën e Kursimeve në vlerën 2.500.000 lekë në datën 02.04.2004, pasi nuk u provua burimi fillestar i saj që janë të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga puna në aktivitetin e ushtruar nga babai i saj.
36. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

36.1 Bashkëngjitur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ILDKPKI kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2004, me anë të së cilës subjekti i rivlerësimit Sali Hasa i ka shitur shtetasve H. dhe G. L., pasurinë tokë të llojit “arë”, me sipërfaqe 500 m², të regjistruar në ZVRPP-në Kavajë me nr. {***}, z. k. {***}, në vlerën 500.000 lekë, shumë të marrë nga blerësit plotësisht jashtë zyrës noteriale. Kësaj kontrate i është bashkëlidhur shkresa e thjeshtë *Aneks Kontratë Shitblerje*, e datës 19.03.2004, me vërtetim nënshkrimi nga noteri nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2004, në të cilën, pala shitëse Sali Hasa dhe blerësi H. L., deklarojnë se: “Më datën 19.03.2004, që të dy palët kemi nënshkruar një kontratë shitblerjeje me nr. {***}, në të cilën është përshkruar vetëm sipërfaqja e tokës arë dhe çmimi i shitblerjes së saj, pa përfshirë në të çmimin e shitblerjes së shtëpisë për shkakun se nuk figuron e regjistruar në ZVRPP-në Kavajë. Lidhur me çmimin e shitblerjes së shtëpisë së banimit, deklarojmë se është 2.500.000 lekë, të cilat janë dhënë nga blerësi dhe janë marrë nga shitësi plotësisht, pa pasur asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit, ku blerësi H. L., merr përsipër që të përfundojë vetë procedurat e regjistrimit të shtëpisë”.

36.2 I pyetur nga Komisioni se përse kjo ndërtesë dhe çmimi i saj nuk janë përmendur në kontratën noteriale të shitblerjes dhe në funksion të kërkesës së tij për të paraqitur dokumentacion justifikues mbi mënyrën e marrjes së kësaj shume, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar, *së pari*, se në kontratën e shitblerjes nuk është vendosur shuma e shitjes për shkak se likuidimi është bërë jashtë zyrës noteriale dhe noteri nuk mund të përcaktonte vlerën e shitjes dhe, *së dyti*, për faktin që kjo ndërtesë ka qenë *karabina*. Sa i takon dokumentacionit ligjor mbi mënyrën dhe marrjen e shumës 2.500.000 lekë, subjekti ka deklaruar se shuma është marrë *cash* nga shtetasi H. L., ditën kur është bërë kontrata e shitjes së ndërtimit *karabina* dhe nuk disponon ndonjë dokument, por më datë 02.04.2004, kjo shumë lekësh, është depozituar në Bankën e Kursimeve ShA, dega Durrës.

36.3 Nëpërmjet dokumentacionit të përcjellë në kuadër të hetimit administrativ, Raiffeisen Bank ShA⁵⁹ e ka informuar Komisionin se shtetasja M. H. ka pasur në llogarinë e saj, depozitë me afat njëvjeçar, shumën 2.500.000 lekë, të cilën e ka tërhequr më datë 04.04.2005, së bashku me interesat në shumën 151.268.73 lekë.

36.4 Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit⁶⁰, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ndërtesën me sipërfaqe 130 m² e ka shitur te shtetasi H. L. në vlerën 2.500.000 lekë, me aneks kontratë jo noteriale, por të vërtetuar me vërtetim nënshkrimi te noteri në datën 19.03.2004, sepse banesa ishte ndërtim pa leje, ishte e papërfunduar si *karabina* dhe, si e tillë, nuk mund të regjistrohej, ndërkohë që për truallin është lidhur kontratë shitblerje e rregullt. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën kthim përgjigje të datës 16.08.2021 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sipas së cilës *pasuria nr. {***}, z. k. {***}, e llojit arë me sipërfaqe 500 m² figuron në pronësi të z. H. L., e regjistruar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.03.2011, mes shitësit H. L. dhe blerësit H. H. L.. Kjo pasuri në seksionin "{***}" ka shënimin se mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa nr. {***}, me sip. 136,3 m² në emër të H. L., e cila është regjistruar me leje legalizimi nr. {***}, datë 19.12.2014. Në këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që shuma prej 3.000.000 lekësh (500.000 lekë toka + 2.500.000 lekë banesa) të konsiderohet si burim i ligjshëm dhe, gjithashtu, të thirren si dëshmitarë shtetasit H. L. dhe (G.) H. L.. Veç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me parashtrimet e tij në Kolegj, në cilësinë e provës edhe aktet: (i) veprim arke në Bankën e Kursimeve me përshkrim *derdhje cash**

⁵⁹ Sipas vërtetimit përcjellë Komisionit nga Raiffeisen Bank ShA me shkresë nr. {***} prot., datë 24.04.2020.

⁶⁰ Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit dhe i kaloi barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016: (i) është i dyshimtë qëllimi i mospërfshirjes së ndërtesës me sipërfaqe 130 m² dhe vlerës së saj në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2004. Duket se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me përdorimin e kontratës së datës 19.03.2004, si kontratë për shitjen e pasurisë *karabina*. Hartimi i aneks kontratës është me shkresë të thjeshtë dhe jo përpara noterit; (ii) duket se ka mospërputhje në deklaratat, pasi subjekti ka deklaruar se kontratën e shitjes së pasurisë objekt *karabina* e ka lidhur përpara noterit, por gjatë hetimit nuk rezultoi të jetë lidhur kontratë para noterit për shitjen e pasurisë ndërtesë; (iii) mungesë dokumentacioni ligjor për mënyrën dhe periudhën e përfitimit të shumës së pretenduar prej 2.500.000 lekësh; (iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka lidhur kontratë para noterit për shitjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 130 m² dhe nuk rezultoi të jenë paguar detyrimet përkatëse, tatimi mbi të ardhurat në shumën e pretenduar prej 2.500.000 lekësh; (v) në analizën financiare nuk janë marrë parasysh të ardhurat e shitjes së ndërtesës *karabina* 130 m² të deklaruar nga subjekti në vitin 2004, pasi nuk është vërtetuar kjo gjë nga subjekti dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj.

nga M. H., datë 02.04.2004, të vlerës 2.500.000 lekë; dhe (ii) veprim arke në Raiffeisen Bank ShA me përshkrim *tërheqje depozite 12-mujore* në datën 04.04.2005, në vlerën 2.651.268.73 lekë.

36.5 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurës prej 2.500.000 lekësh të përfituar nga shitja e objektit karabina me sipërfaqe 130 m², përmes një shkrese të thjeshtë në vitin 2004, trupi gjykues referuar nenit 83 të Kodit Civil vlerëson se kjo dispozitë kërkon në mënyrë të posaçme që veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se objekti karabina me sipërfaqe 130 m², duke qenë një send jashtë qarkullimit civil, si dhe për faktin se regjistrimi i përkohshëm i objektit në fazën e përfundimit të karabinasë u parashikua për herë të parë me ligjin nr. 9701, datë 02.04.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar⁶¹, nuk mund të tjetërsohej nëpërmjet një akti noterial dhe të regjistrohej. Në këto kushte, në vlerësimin e trupit gjykues, aneks kontrata e shitblerjes, si shkresë e thjeshtë përmes së cilës pretendohet shitja e objektit karabina, nuk përmbush elementin e formës që duhet të ketë një akt juridik që synon kalimin e të drejtës së pronësisë. Ndonëse aneksi i kontratës mbart fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë (private), në kuptim të neneve 246, 251, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Civile, në drejtim të vullnetit të palëve nënshkruese, trupi gjykues vlerëson se ky aneks nuk mbart vlerë provuese në funksion të procesit të rivlerësimit, qëllimit dhe standardeve të kërkuara prej tij, pasi nuk provohet *së pari*, përfitimi i të ardhurës prej 2.500.000 lekësh dhe *së dyti*, shlyerja e detyrimeve tatimore për këtë të ardhur. Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se e ardhura në vlerën 2.500.000 lekë nga shitja e ndërtesës, përveç se nuk u provua burimi i ligjshëm që ka shërbyer për ndërtimin e objektit (ligjshmëria e të ardhurave nga puna e bashkëshortes së subjektit në biznesin e babait Z. D.), nuk e kalon as testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar e ardhur e ligjshme. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se për të ardhurën në shumën 500.000 lekë nga shitja e truallit me sipërfaqe 500 m² është paguar detyrimi tatimor, trupi gjykues vlerëson se kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2004, përbën një nga format e krijimit të të ardhurave, sipas parashikimit të legjislacionit tatimor, nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998, dhe në kushtet kur kjo pasuri rezulton të jetë regjistruar në pronësi të blerësit të saj H. L., i cili më pas e ka tjetërsuar tek H. L., vlerësohet i përmbushur detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore, duke e bërë shumën prej 500.000 lekësh të ardhur të ligjshme, por që gjithsesi në vlerësimin e trupit gjykues mbetet e pamjaftueshme për ta konsideruar të ligjshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie në tërësi.

37. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk mund t’i referohet vlerës së ndërtimit në tregun e lirë për vitin 2005, sipas Udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “K” për vitin 2005”, pasi apartamenti është marrë karabina.*

37.1 Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në ngritjen e këtij pretendimi i referohet arsyetimit të bërë nga Komisioni në paragrafin 3.18 të vendimit objekt shqyrtimi, se nëse çmimi i apartamentit me sipërfaqe 163,3 m² do të llogaritej sipas vlerës së ndërtimit në tregun e lirë për

⁶¹ <http://qbz.gov.al/eli/ligji/2007/04/02/9701>

vitin 2005, atëherë ky çmim do të ishte në vlerën 8.955.045 lekë. Ndërkohë që referuar analizës financiare në vendim, rezulton se Komisioni vlerën e apartamentit e ka llogaritur 50.000 USD sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 20.04.2001 dhe jo sipas vlerës së ndërtimit në tregun e lirë për vitin 2005, të likuiduar sipas parashikimeve në këtë kontratë, 44.000 USD të paguar deri në fund të vitit 2001 dhe 6.000 USD në vitin 2005, në kushtet kur nuk ka deklarime për këtë pasuri nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e vitit 2003 paraqitur prej tij në cilësinë e provës apo deklaratat e vitit 2004 dhe 2005 administruar në dosjen e ILDKPKI-së, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit në vitet respektive (1 USD = 137.04 ALL në vitin 2001 dhe 1 USD = 103.33 ALL në vitin 2005). Trupi gjykues evidenton, gjithashtu, faktin se subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ, ashtu dhe me prapësimet për rezultatet e hetimit, nuk paraqiti ndonjë provë për të vërtetuar pretendimin që apartamenti ishte marrë në dorëzim prej tij në gjendje të papërfunduar apo *karabina*, pretendim i cili nuk mbështetet as nga kontrata e shitblerjes në të cilën ka deklaruar se ka marrë në dorëzim apartamentin dhe nuk ka pretendime, e as nga të dhënat e kartelës së pasurisë së paluajtshme përcjellë në Komision nga AShK, Drejtoria Vendore Durrës, nga e cila rezulton se pasuria nr. {***}, e llojit *apartament*, me sipërfaqe 163,28 m², është regjistruar në pronësi të shtetasve A. M. dhe H. Ç. që më datën 01.11.2001, çka dëshmon mbi faktin se objekti ka qenë i përfunduar përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes të datës 27.05.2005, pasi në rast të kundërt nuk do të ishte i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme⁶². Veç kësaj, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat në vijim investime të mëtejshme apo shpenzime të kryera në këtë apartament.

38. *Detyrimi për deklaram për herë të parë është vendosur në vitin 2006, me ligjin nr. 9530, datë 11.05.2006 dhe se subjekti ka qenë subjekt deklarues që në vitin 2003, kur ishte shef komisarati.*

38.1 Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ngritjen e këtij pretendimi e lidh me konstatimin e Komisionit në paragrafin 3.19/iii të vendimit objekt shqyrtimi, në të cilin citohet se: “*Deklaratën e pasurisë për herë të parë subjekti e ka dorëzuar disa muaj pas fillimit të detyrës në shkelje të afatit ligjor prej 30 ditëve (detyrim ligjor i caktuar nga ligji nr. 9049, viti 2003)*. Ndonëse këtij konstatimi Komisioni nuk i ka atribuuar ndonjë pasojë ligjore dhe nuk e ka lidhur as me ndonjë shkak shkarkimi, për t’i dhënë përgjigje këtij pretendimi, trupi gjykues, referon ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare, të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenet 6 dhe 9 të të cilit, parashikohet “*Deklarimi i parë*”⁶³ që ka të bëjë me deklaramin nga punonjësit që ndodhen në një funksion deklarues në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit dhe “*Deklarimin para fillimit të punës*”⁶⁴ që ka të bëjë me deklaramin e punonjësve që fillojnë punë për herë të parë pas hyrjes në fuqi të ligjit, në një nga funksionet që mbartin detyrimin për deklaram. Nga kjo pikëpamje, pretendimi i subjektit të

⁶² Regjistrimi i objektit në fazën e përfundimit të karabinasë u parashikua për herë të parë me ndryshimet e ligjit nr. 7843, datë 13.70.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ligjin nr. 9701, datë 02.04.2007.

⁶³ Neni 6 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i titulluar “*Deklarimi i parë*”, parashikon: “*Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklaram, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluarat, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre*”.

⁶⁴ Neni 9 i titulluar “*Deklarimi para fillimit të punës*” parashikon: “*Punonjësit që fillojnë punë për herë të parë në një nga funksionet, që mbartin detyrimin për deklaram, janë të detyruar të deklarojnë, sipas kërkesave të nenit 6 të këtij ligji*”.

rivlerësimit se “Deklarimi për herë të parë” është përcaktuar për herë të parë me ligjin nr. 9530, datë 11.05.2006, nuk qëndron. Gjithashtu, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, edhe deklarata e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, e dorëzuar më datë 17.03.2005 nga subjekti i rivlerësimit si subjekt deklarues në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, i emëruar më datë 16.07.2004, është deklarata “*Deklarimi para fillimit të punës*”, e parashikuar nga neni 9 i ligjit nr. 9049/2003, në faqen e parë të të cilës përcaktohet shprehimisht detyrimi për subjektet deklarues që ky deklarim duhet të plotësohet brenda 30 ditëve të fillimit të detyrës. Për sa i takon pretendimit se ai ka qenë subjekt deklarues që në vitin 2003 në detyrën e shefit të komisarariatit, referuar akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”⁶⁵, e ka gjetur subjektin e rivlerësimit në funksionin e punonjësit të efektivit të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan⁶⁶, ndërkohë që në dosjen e Komisionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja nuk rezulton i administruar një deklarim i tillë. Në kushtet kur Komisioni nuk i ka atribuar subjektit të rivlerësimit ndonjë pasojë ligjore lidhur me këtë çështje, por e ka lënë vetëm në nivel konstatim fakti, trupi gjykues e vlerëson jorelevant shqyrtimin e këtij pretendimi në drejtim të konkluzionit të Komisionit. Në këtë kuptim, edhe dokumenti “Deklaratë e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie e vitit 2003”, e plotësuar dhe e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në detyrën e punonjësit të Ministrisë së Rendit, të paraqitur në cilësinë e provës në Kolegj, në vlerësimin e trupit gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. nr.84/2016, është pa ndikim në vendimmarrjen e tij.

39. *Kjo pasuri, e ndodhur në qytetin e Durrësit, është përfshirë në mënyrë të gabuar në analizën financiare përpara vitit 2003, ndërkohë që duhej përfshirë në analizën pas vitit 2004 dhe se vlera e kontratave të sipërmarrjes nuk duhet të përllogaritet në analizë për të gjithë shumën, por vetëm për pjesën e likuiduar.*

39.1 Në analizë të këtij pretendimi, pas kontrollit të analizës financiare paraqitur në tabelën përmbledhëse në faqen 32 të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se kosto e apartamentit me sipërfaqe 163,28 m², ndodhur në Durrës, është përllogaritur në vlerën 44.000 USD apo 6.029.760 lekë (konvertuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2001, USD/ALL = 137.04) në kolonën *para vitit 2003* dhe në vlerën 6.000 USD apo 619.980 lekë (konvertuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2005, USD/ALL = 103.33), bazuar në dokumentacionin justifikues të administruar, konkretisht sipas parashikimit të likuidimit të kësteve në nenin “Çmimi dhe mënyra e pagesës”, të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2001 dhe sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2005.

39.2 Në vijim të analizimit të pretendimit mësipërm, bazuar në situatën e fakteve të përshkruar në paragrafët 33.1 – 33.7 të këtij vendimi, trupi gjykues vëren se referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2001, nga çmimi total i apartamentit në vlerën 50.000 USD, deri në fund të vitit 2001 duhet të ishin paguar nga porositësi Sali Hasa 44.000 USD dhe

⁶⁵ Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 15.05.2003 dhe ka hyrë në fuqi dy javë më pas, link: <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2003/04/10/9049>

⁶⁶ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 21.10.2016, të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, vërtetohet se subjekti rivlerësimit ka qenë ish-punonjës i efektivit, për periudhën 01.07.2002 - 20.10.2003.

kësti i fundit prej 12 % të vlerës së totalit e barabartë me shumën 6.000 USD do të likuidohet me dorëzimin e apartamentit, i cili, sipas parashikimeve në nenin “Detyrimet e palëve” të po kësaj kontrate, do të përfundonte deri më datë 30.10.2001. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se marrja në dorëzim e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit është bërë me lidhjen e kontratës së shitblerjes së datës 27.05.2005. Ndodhur përpara deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private lidhur me likuidimin e kësteve, si dhe deklarimit të tij në deklaratën e interesave private të vitit 2005 se nuk ka detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, trupi gjykues, vlerëson që mënyra e likuidimit të kësteve të konsiderohet sikurse edhe në Komision. Pas kontrollit të analizës financiare para vitit 2003 të kryer në Komision për këtë qëllim nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupit gjykues i rezulton mungesë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara për të njëjtën periudhë në vlerën (-) 7.464.755 lekë. Edhe nëse do të merreshin në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vlera e apartamentit ka qenë 1.700.000 lekë, sipas përcaktimeve në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2005, fakti që në deklaratë e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është paguar me likuiditet nga tërheqja e depozitës 2.500.000 lekë në ish-Bankën e Kursimeve ShA, në vitin 2004, për të cilat nuk u vërtetua ligjshmëria e tyre, e çon trupin gjykues në të njëjtin vlerësim si edhe më sipër se subjekti i rivlerësimit e ka krijuar këtë pasuri me burime jo të ligjshme.

40. *Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe ka kryer deklaram të rremë, duke u gjendur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.*

Në lidhje me pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 90 m², ndodhur në Sarandë”

41. *Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti argumente dhe prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të rezultateve të hetimit. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, kontradiktor dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këto konkluzione duke ngritur në ankim dhe në parashtrime pretendimet që trajtohen në vijim.*
42. *Kredia për blerjen e kësaj pasurie nuk është marrë sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, sepse ai nuk ka qenë as nëpunës civil dhe as funksionar politik, por kredia është marrë nga bashkëshortja e tij, sipas një vendimi të Këshillit Bashkiak Sarandë. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:*

42.1 *Nëpërmjet kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2011, M. e L. H. në cilësinë e kredimarrësit, me dorëzanës Sali Hasa e A. H., kanë marrë në Bankën Kombëtare Tregtare ShA kredi në shumën 3.168.000 lekë, me afat 20 vjet. Referuar *Aneks i Elementëve Specifikë të Kredisë* të datës 18.03.2011, shuma e kredisë prej 3.168.000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të*

transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar “{***}” ShPK me transfertë bankare. Në nenin 1 të kontratës “*Baza ligjore dhe statusi juridik*” përcaktohet se: [...]. *Palët kanë rënë paraprakisht dakord që në bazë të nenit 1031 e në vazhdim dhe të nenit 560 e në vazhdim të Kodit Civil, të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar; VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetëror dhe funksionarëve politik”; udhëzimit nr. 6257, datë 02.09.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr. 10240/1, datë 17.10.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, Marrëveshjes trepalëshe datë 18.02.2009, si dhe çdo marrëveshje tjetër e nënshkruar mes palëve në lidhje me këtë objekt, si dhe të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë [...].*

42.2 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka arritur në konkluzionin se *kredia e përfituar ka qenë në kushtet e kredisë lehtësuese, bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.09.2007. Duket e paqartë mënyra e përfitimit të kësaj kredie nga bashkëshortja e subjektit dhe djali, pasi duket se nuk përfaqësohen në kategorinë e personave përfitues, sipas VKM-së më sipër dhe për faktin se dispononin pasuri tjetër të paluajtshme [...], i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës se duket i paqartë përfitimi i kredisë së butë dhe respektimi i dispozitave (kushteve dhe kritereve) ligjore për përfitimin e saj. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime specifike lidhur me këtë çështje apo të ketë paraqitur dokumente provues.*

42.3 Ndonëse në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka rezultuar e paqartë mënyra e përfitimit të kësaj kredie dhe respektimit të dispozitave ligjore për përfitimin e saj, nga përmbajtja e vendimit të Komisionit, trupit gjykues nuk i rezulton që ky i fundit të ketë mbajtur ndonjë qëndrim apo të ketë arritur ndonjë konkluzion lidhur me ligjshmërinë e përfitimit të kredisë dhe as e ka lidhur atë me ligjshmërinë e pasurisë objekt shqyrtimi në tërësi, por e ka lënë qëndrimin e tij në nivel konstatimi paqartësie dhe pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me ndonjë shkak shkarkimi të parashikuar shprehimisht në ligj. Ndërkohë, nga të dhënat në dosjen e hetimit administrativ, përveç një baze ligjore të përgjithshme të cituar në kontratën e kredisë që jo automatikisht i bën ata përfitues të saj sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, nuk përftohen të dhëna mbi statusin dhe mënyrën e aplikimit e përfitimit të kësaj kredie nga bashkëshortja dhe djali i subjektit të rivlerësimit. Në mungesë të të dhënave të tilla që mund të hedhin dritë mbi veprime në tejkalim të ligjit nga subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur dhe, për më tepër, në mungesë të një konkluzioni të Komisionit lidhur me të, trupi gjykues e gjen jorelevant shqyrtimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të konkluzionit të Komisionit për këtë pasuri.

43. Subjekti pretendon se *dyshimi se çmimi i blerjes ka qenë më i ulët nuk bazohet në ndonjë element apo indicie për favorizim, përkundrazi injoron ligjin e kërkesës dhe ofertës, sidomos kushtet e urgjencës që kishte pala shitëse dhe nevojat e saj për para në momentin e transaksionit.*

43.1 Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit e lidh këtë pretendim me konstatimin e Komisionit në përfundim të hetimit administrativ se *duket se subjekti ka pasur çmim preferencial për blerjen e pasurisë apartamentit me sip. 90 m², në shumën*

3.960.000 lekë, porositur në vitin 2010 në qytetin e Sarandës”. Ndërsa në vendim, ndonëse nuk ka mbajtur një qëndrim konkret lidhur me këtë çështje, Komisioni është shprehur se subjekti nuk ka arritur të përmbysë rezultatet e hetimit e, për pasojë, nuk i janë shuar as dyshimet se subjekti është trajtuar me një çmim preferencial, edhe pse kësaj shtate nuk i ka dhënë ndonjë kualifikim ligjor të posaçëm apo ta ketë lidhur me ndonjë shkak shkarkimi. Trupi gjykues vëren se ky konkluzion i Komisionit i atribuohet llogaritjes së çmimit të apartamentit sipas vlerës së tregut të lirë të bazuar në udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2010, të Këshillit të Ministrave, që nga llogaritjet rezultonte të ishte 4.455.000 lekë, pavarësisht se në analizën financiare përmbledhëse, paraqitur në faqen 32 të vendimit të ankimuar, vlera e tij është përlllogarit si përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, në shumën 3.960.000 lekë. I pyetur gjatë hetimit administrativ, mbi rrethanat e negociimit për këtë çmim, i cili ishte më i ulët se çmimi mesatar i tregut, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁶⁷ se: “[...] apartamenti për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes ishte planifikuar nga shtetasi D. M., për baxhanakun e tij, emrin e të cilit nuk e di, por që jetonte në Greqi. Ky apartament kishte mbetur disa kohë i boshatisur. Në momentin që unë isha në kërkim të një banese, mësoj se ky shtetas kishte nxjerrë në shitje këtë apartament, për shkak se baxhanakut të tij i kishte pësuar djali një sëmundje të rëndë në Greqi dhe nuk kishte ndërmend të kthehej në Shqipëri. Për shkak se i duheshin lekët, është biseduar që këtë apartament të ma shisnin mua dhe çmimin ma kanë propozuar vetë shitësit”. Ndërsa në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shtuar si argumente edhe kushtet e urgjencës që kishte pala shitëse dhe nevojat e saj për para në momentin e transaksionit, por pa i mbështetur këto pretendime me ndonjë akt provues.

43.2 Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi që konkluzionin e Komisionit, bazuar në pretendimin e subjektit, ta analizojë edhe nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar⁶⁸, i cili në formën e tij në fuqi në datën e lidhjes së kontratës së porosisë më 21.12.2010⁶⁹, trajtimin preferencial të zyrtarit e lidhte pazgjydhshmërisht me lindjen e konfliktit të interesit⁷⁰. Në rastin konkret, nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që Komisioni të ketë kryer verifikime lidhur me faktin nëse kontrata e sipërmarrjes e datës 21.12.2010 është lidhur në kushtet e konfliktit të interesit mes D. M. në cilësinë e administratorit të shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit e, po kështu, nuk janë kryer verifikime as mbi marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë sipërmarrëse me të tjerë blerës, krahasuar me subjektin e rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vetëm pas një hetimi të thelluar mund të ngriheshin dyshime për trajtim preferencial.

⁶⁷ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

⁶⁸ Me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006 dhe ligjin nr. 9690, datë 05.03.2007.

⁶⁹ Në nenin 23 përcaktohet: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”.

⁷⁰ Kjo dispozitë ligjore ndryshoi me miratimin e ligjit nr. 86/2012, datë 18.09.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Sipas dispozitës së ndryshuar: “[...] është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”.

44. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi vetëm për faktin se mandatarkëtimi i datës 6.5.2014, për pagimin e vlerës 792.000 lekë, nuk është i njohur nga legjislacioni tatimor, pasi kjo nuk do të thotë se pagesa nuk është kryer*. Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i referohet paragrafit 5.11 të vendimit objekt shqyrtimi, në të cilin Komisioni shprehet se: *“Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 06.04.2018, të Drejtorisë së Tatimeve rezulton se mandatarkëtimi nuk është dokument i njohur nga legjislacioni tatimor, gjë që duket se nuk vërteton pretendimet e subjektit”*.
45. Në shqyrtim të këtij pretendimi, pas analizimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit për këtë çështje, trupi gjykues konstaton se:

45.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, lidhur midis bashkëshortes sime M. H. dhe sipërmarrësit D. M., në qytetin e Sarandës, është porositur ndërtimi i një apartamenti me sipërfaqe 90 m², me vlerë 3.960.000 lekë, që do të paguhej me këste. Me kontratën e kredisë bankare me BKT-në, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.3.2011, me kredimarrës M. e L. H. dhe Sali Hasa e A. H. dorëzanës për shumën 3.168.000 lekë ka kaluar direkt nga BKT tek sipërmarrësi. Ndërsa pjesa tjetër prej 720.000 lekësh është paguar pas prishjes së depozitës në shumën 800.000 lekë me BKT nga bashkëshortja ime M. H. në vitin 2014. “Vlera” deklarohet: “Pagesa për apartament nga kontrata e kredisë për 3.168.000 lekë. Pagesa e shumës prej 720.000 lekësh nga prishja e depozitës me BKT-në në vitin 2014”. Pjesa takuese deklarohet 100%.*

45.2 Në DIPP-në e vitit 2010 e në vijim nuk ka deklarime në lidhje me këtë pasuri, kontratën e sipërmarrjes, detyrime në zbatim të saj dhe as këstin 792.000 lekë, si detyrim ndaj shoqërisë sipërmarrëse për apartamentin me sipërfaqe 90 m², ndodhur në Sarandë. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2011 nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është deklaruar se: *“Me kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.201, kam marrë kredi në BKT Sarandë me qëllim mbulimin e pagesës për kontratën e porosisë për një apartament në qytetin e Sarandës me interes 3% akorduar nga Bashkia nga fondi për strehim. Shuma: 3.168.000 lekë”*. Marrja e kësaj kredie është deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private për vitin 2012 e në vijim.

45.3 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Të ardhura nga përfundimi i kontratës së depozitës me afat me BKT dega Sarandë, të ardhura të kursyera nga pagat gjatë disa viteve të deklaruara në vitet e mëparshme. Shuma 800.000 lekë dhe interesi i tre për një vit”*.

45.4 Nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010⁷¹, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka porositur te pala sipërmarrëse D. M. një apartament 2+1, me sipërfaqe 90 m², kundrejt çmimit 3.168.000 lekë, që do të likuidohet me dy këste: *kësti i parë* në shumën 792.000 lekë është paguar jashtë zyrës noteriale përpara nënshkrimit të kontratës; *kësti i dytë* dhe i fundit në shumën 3.168.000 lekë do të likuidohet nga porositësjja me marrjen prej saj të një kredie bankare pranë BKT-së.

⁷¹ Përcjellë nga ASHK-ja Sarandë me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2020.

45.5 Më datë 18.03.2011 është nënshkruar kontrata e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2011, mes Bankës Kombëtare Tregtare Sh.A, palës kredimarrëse M. e L. H. dhe dorëzanës Sali Hasa e A. H., për kredi në shumën 3.168.000 lekë, për 20 vjet. Referuar aneksit të elementëve specifikë të kredisë, të datës 18.03.2011, shuma e kredisë prej 3.168.000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të shitësit të objektit të kredituar “{***}” ShPK me transfertë bankare. BKT ShA, Dega Sarandë ka konfirmuar disbursimin e kredisë në shumën 3.168.000 lekë më datë 24.03.2011 dhe balancën e kredisë më datë 13.11.2019, në vlerën 1.975.361,96 lekë.

45.6 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi mosdeklarimin e blerjes së apartamentit dhe pagesën prej 792.000 lekësh në DIPP-në e vitit 2010, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *para lidhjes së kontratës së porosisë nuk është bërë asnjë pagesë nga ana e tyre. Kontrata është lidhur në vitin 2011. Fakti që në këtë kontratë është përshkruar sipas pikës 3 të saj, ka qenë mbetje kompjuterike nga kontratë e mëparshme dhe gjatë nënshkrimit, nuk është vënë re nga ana e palëve.* Më tej, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (a) mandatarkëtimin me nr. {***}, datë 06.05.2014, nënshkruar nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, D. M., por pa vulën e shoqërisë, me anë të së cilit kërkon të provojë faktin se i ka shlyer shoqërisë shumën prej 792.000 lekësh, mbetur pas disbursimit të kredisë në favor të firmës, nga BKT Sh.A dega Sarandë; (b) printim elektronik nga BKT-ja, datë 26.05.2020, sipas së cilës më datë 25.03.2011 është disbursuar kredia në shumën 3.100.000 lekë.

45.7 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka vlerësuar bazuar në shkresën nr. {***} prot., datë 06.04.2018, të Drejtorisë së Tatimeve se ky mandatarkëtim nuk është dokument i njohur nga legjislacioni tatimor, pasi ka konstatuar mosdeklarimin e pagesës së këstit në shumën 792.000 lekë në DIPP-të e viteve 2010 dhe 2014, si dhe ka evidentuar mospërputhjen mes deklaratës së pasurisë *vetting* dhe kontratës së sipërmarrjes për likuidimin e këtij kësti, i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit si vijojnë: (i) *Në analizën financiare vlera e pasurisë është e përfshirë e gjitha në vitin 2010, sipas kontratës së sipërmarrjes. Në vitin 2014, nuk është përfshirë ndonjë likuidim lidhur me këtë pasuri, meqë nuk ishte deklaruar një gjë e tillë në DPV-në e vitit 2014;* (ii) *Kontrata e sipërmarrjes është e datës 21.12.2010. Nga analiza financiare e vitit 2010, shihet se subjekti dhe familjarët e tij, kanë pasur burime të mjaftueshme për shtimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitin.* Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai ka pasur mundësi financiare për të hyrë në transaksione.

45.8 Nga analiza e fakteve të mësipërme, trupi gjykues vëren se kontrolli i vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me pagesën e këstit të parë të vlerës së apartamentit në Sarandë prej 792.000 lekësh, është bërë nga ana e Komisionit, jo vetëm përmes verifikimit të dokumentit financiar depozituar prej tij për të vërtetuar këtë pagesë, por duke ballafaquar deklaratën *vetting* me DIPP-të ndër vite e dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit në Komision, si dhe mundësinë financiare për kryerjen e kësaj pagese. Vetëm në përfundim të kësaj analize, Komisioni e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, duke konkluduar se ka kryer deklarim të pasaktë, kontradiktor dhe ka mungesë të

burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

45.9 Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, bazuar në situatën e fakteve të parashtruara më sipër, lidhur me pagesën e këstit në shumën 792.000 lekë, trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting se [...] pjesa tjetër prej 720.000 lekësh është paguar nga prishja e depozitës në shumën 800.000 lekë në BKT ShA nga bashkëshortja M. H., në vitin 2014*, nuk përputhet me përcaktimet e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, në të cilën parashikohet shprehimisht që *këstin e parë* në shumën 792.000 lekë palët deklarojnë ta kenë likuiduar jashtë zyrës noteriale, para nënshkrimit të saj. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se mandatarkëtimi nr. {***}, datë 06.05.2014, i depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ për të provuar faktin që pagesa e shumës 792.000 lekë është kryer në vitin 2014, pra, sipas deklaramit në deklaratën *vetting*, nuk përmbush kërkesat e nenit 6⁷² të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, lidhur me regjistrimet kontabël, pasi i mungon origjina e tij, për shkak të mungesës së vulës. Në këto kushte, trupi gjykues verifikoi përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të likuiduar shumën 792.000 lekë, paguar përpara datës së nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes datë 21.12.2010, duke kontrolluar analizën financiare të Komisionit, nga ku subjekti i rivlerësimit rezultoi me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për likuidimin e shumës prej 792.000 lekësh në vitin 2010.

- 46.** Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues arrin në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë vetting, lidhur me pagesën e këstit të parë në shumën 792.000 lekë në vitin 2014, duke u gjendur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr.84/2016, por pa ndonjë peshë specifike në masën disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.*

Në lidhje me pasurinë “Tokë kullotë në Porto Palermo, Himarë”

- 47.** Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Pas shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit shkresor të administruar rezultoi se sipërfaqja e tokës e dhuruar nga shtetasi V. R. ishte 1.000 m², por Komisioni konstatoi se subjekti nuk shpjegoi bindshëm si është përfituar ky dhurim nga një shtetas, i cili nuk ndodhet në rrethin familjar të tij. Pranimi i dhurimit nga një prokuror të një sipërfaqe të konsiderueshme toke, ndonëse nuk evidentohet ndonjë rast i drejtpërdrejtë i konfliktit të interesit me dhuruesin, cenon besimin e publikut. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë, duke mos u gjendur në kushtet e germës “a” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë”.*

⁷² Në nenin 6 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: *“Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji. 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes”.*

48. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *ashtu sikurse ILDKPKI-ja ka vlerësuar, ai nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe se ka shpjeguar bindshëm dhurimin prej 1.000 m² tokë nga shtetasi V. R., me të cilin ka një miqësi familjare prej gati 20 vitesh, fakt i njohur botërisht në komunitetin e bashkisë Sarandë*. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

48.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2014, shtetasi V. R. u ka dhuruar një sipërfaqe toke (kullote) prej 1.000 m² në Palermo, Himarë, dy fëmijëve të mi, L. H. dhe A. H., që është e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në regj nr. {***}, datë 05.02.2015. Në këtë sipërfaqe toke nuk është bërë asnjë investim”*. Pjesa takuese: *“50% me 50%”*. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Të dy fëmijët L. dhe A. H. kanë përfituar një sipërfaqe prej 1.000 m² toke në Porto Palermo, Himarë, të regjistruar në ZVRPP-në Vlorë si dhuratë nga z. V. M. R.. Bashkëlidhur vërtetimi hipotekor”*. Pjesa takuese: *100%*.

48.2 Me kontratë dhurimi pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2014, shtetasi V. R. i dhuron dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit L. H. dhe A. H. në bashkëpronësi të pandarë me nga ½ një parcelë toke prej 1000 m², në pasurinë e tij prej 38.000 m² në Palermo, Himarë, dhurim i cili pranohet nga pala pranuese e dhurimit përmes deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2014.

48.3 I pyetur gjatë hetimit administrativ mbi marrëdhënien aktuale mes tij dhe shtetasit V. R., subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁷³ se kanë një marrëdhënie miqësie mes tyre dhe shkëmbejnë vizita të vazhdueshme, pasi ai është rezident në Greqi. Sa i takon sipërfaqes së dhuruar subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁷⁴ se nuk ka pasur asnjëherë procese penale apo civile, si në kohën kur është përpiluar kontrata e dhurimit, ashtu edhe më vonë, kurse për shtetasin V. R. informon se në fund të vitit 2017 apo fillim të vitit 2018, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është nisur një procedim penal, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për një pronë tjetër, të cilën ai e kishte të përfituar me ligjin nr. 7501/1991, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pafajësinë e tij dhe çështja ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit⁷⁵. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të deklaruar dhe paraqitur dokumentacion provues të lëshuar nga institucionet përkatëse, nëse gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit ka trajtuar çështje ku palë në proces të ketë qenë shtetasi V. R., subjekti ka deklaruar⁷⁶ se: *“Shtetasi V. R. ka vendbanimin e tij në qytetin e Himarës që është në juridiksion të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe unë si prokuror nuk kam ushtruar detyrën ndonjëherë në atë prokurori dhe deklaroj me përgjegjësi të plotë se nuk kam ndjekur ndonjë çështje penale ku palë ka qenë shtetasi V. R.. Nga sistemi CAMS për menaxhimin e çështjeve në prokurori, kam verifikuar dhe rezulton se nuk kam ndjekur asnjë*

⁷³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

⁷⁴ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

⁷⁵ Në mbështetje të këtyre pretendimeve subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet shkresore: i) vendim nr. {***}, datë 21.06.1995, i ish KKKP-së Vlorë, për kthimin e 15 ha tokë në Palermo; ii) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2014; iii) vërtetim nga regjistrat hipotekorë nr. {***}, datë 02.07.2013; iv) vërtetim hipotekor me nr. {***}, datë 16.01.2015; v) deklaratë noteriale për pranimin e dhurimit nga L. e A. H..

⁷⁶ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 të Komisionit.

çështje penale ku palë ka qenë shtetasi V. R. apo familjarë të tij. [...] Për shkak të volumit të madh, nuk janë printuar shfaqe nga sistemi CAMS për menaxhimin e çështjeve penale në prokurori. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] nuk ka pse ngrihen dyshime për ta lidhur këtë dhurim me funksionin tim si prokuror sepse zoti V. nuk ka pasur asnjëherë ndonjë çështje penale ku unë të kem pasur konflikt interesi me të”.

48.4 Nga analizimi i vendimit objekt ankimi dhe të dhënave nga hetimi administrativ i Komisionit, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij, që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, e ka arsyetuar si në drejtim të marrëdhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe dhuruesit, duke mos e gjetur atë bindëse për të realizuar këtë dhurim, ashtu edhe në drejtim të ekzistencës së konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe dhuruesit, duke arritur në konkluzionin se nuk evidentohet ndonjë rast i drejtpërdrejtë konflikti interesi. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson ta analizojë këtë dhurim në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm konkretisht ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave më ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me ligjin nr. nr. 86/2012, datë 08.09.2012, në nenin 23, në pikën 1 të të cilit, parashikohet: “*Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat*”. Referuar kësaj dispozite, trajtimi preferencial i shprehur në formën e dhurimit mund të qëndrojë edhe i pavarur nga konflikti i interesit. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se dhurimi i kësaj pasurie në vitin 2014, bie në kushtet e ndalimit ligjor të parashikuar nga neni 23, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Për rrjedhojë të këtij arsyetimi, edhe shkresa nr. {***} prot., datë 28.01.2020, e ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë, drejtuar të birit L. H., në të cilën jepen sqarime mbi sipërfaqen e dhuruar nga shtetasi V. R., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës në Kolegj, në vlerësimin e trupit gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet pa ndikim në vendimmarrjen e trupit gjykues në lidhje me këtë çështje.

48.5 Trupi gjykues, sikurse arsyetuar në paragrafin 75 në vijim të këtij vendimi, vlerëson se problematika e evidentuar në rastin konkret meriton të vlerësohet prej Kolegjit në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016, si një sjellje që bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror edhe në jetën jashtëgjyqësore dhe që nuk është në përputhje me *parimet e Bangalores*⁷⁷ mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit, mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005⁷⁸, pavarësisht justifikimit të subjektit të rivlerësimit se ky dhurim lidhet me marrëdhëniet e miqësisë mes tij dhe dhuruesit.

Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë {}, në vlerën 1.000.000 lekë***

49. Komisioni në lidhje me këtë pasuri ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, duke u gjendur në kushtet e*

⁷⁷ Komentari i Parimeve të Bangalores për sjelljen Gjyqësore:

https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

⁷⁸ Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datë 31 maj 2005, pjesa IV “Sjellja private”:

<https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

germës “b” të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke ngritur në ankim dhe në parashtrime pretendimet që trajtohen në vijim.

50. Subjekti i rivlerësimit pretendon se sipas ligjit tatimor, fatura tatimore e shitjes shërben si kontratë për blerjen e kësaj pasurie, pasi shitësi i mjetit ka pasur certifikatë regjistrimi për biznes shitblerje makinash. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga analizimi i përmbajtjes së vendimit objekt ankimi dhe dokumentacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”)⁷⁹ administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK automjetin e markës “Mercedes-Benz”, me targë {***}⁸⁰, me faturë tatimore shitjeje nr. {***}, datë 22.11.2008, në vlerën 667.309 lekë⁸¹ dhe e ka shitur atë në vitin 2013, me kontratë shitje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.05.2013, në vlerën 400.000 lekë. Komisioni, në vlerësim të këtyre fakteve, në përfundim të hetimit administrativ, ka arritur në konkluzionin se: “Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për blerjen e automjetit me targa {***}, në vitin 2008, në vlerën e deklaruar prej 1.000.000 lekësh”. Ndonëse referuar të dhënave të hetimit administrativ rezulton që pasuria objekt shqyrtimi nuk është përfituar përmes ndonjë akti ligjor për kalimin e pronësisë në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil, ndërkohë që fatura tatimore e shitjes ka efekt në kuptim të legjislacionit tatimor lidhur me pagimin e detyrimeve përkatëse, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur Komisioni në vendim nuk i ka atribuar subjektit të rivlerësimit ndonjë pasojë ligjore apo ta ketë lidhur këtë konstatim me ndonjë shkak shkarkimi, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, e gjen jorelevant shqyrtimin e këtij pretendimi në drejtim të konkluzionit të Komisionit.
51. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka llogaritur në mënyrë të gabuar si detyrime edhe penalitetet që nuk i janë kërkuar dhe nuk i janë paguar shtetasit I. M.. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se në paragrafin 7.20, Komisioni shprehet: “Komisioni nuk i ka llogaritur subjektit detyrime lidhur me penalitetet siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me deklaratim kontradiktore të bëra prej tij në DPV-të lidhur me shlyerjen e detyrimit”. Edhe nga kontrolli i analizës financiare pasqyruar në faqen 32 të vendimit, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, nuk rezulton që subjektit të rivlerësimit t’i jenë ngarkuar penalitetet për mos shlyerjen në afat të detyrimeve për huanë e dhënë nga shtetasi I. M., sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2008. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është jorelevant për shqyrtim në raport me konkluzionin e Komisionit.
52. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në mënyrë të gabuar nuk ka përfshirë si burim të ligjshëm huanë e marrë në shumën 1.000.000 lekë, dhe se nuk ka kryer hetime në lidhje me huadhënësin I. M.. Sipas subjektit, në vendim nuk janë pasqyruar sqarimet e dhëna prej tij në kërkesën e datës 24.08.2021 (prapësime) lidhur me fitimin neto të huadhënësit dhe depozitat bankare të tij, si dhe nuk është sqaruar përse nuk janë marrë parasysh, sepse fitimi neto mund të nxirret edhe nga të dhënat që mund të merren nga INSTAT-i për vitet në fjalë, ku sipas atyre që ka

⁷⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 28.04.2020.

⁸⁰ Aktualisht mjete mban statusin çregjistrim i përhershëm prej datës 17.09.2013.

⁸¹ Më datë 21.09.2008, për këtë automjet, janë paguar detyrimet doganore në vlerën 347.491 lekë.

publikuar revista ekonomike Monitor për vitin 2016 “bizneset e vogla me 1-4 punonjës janë më fitimprurëset dhe kanë të paktën një normë fitimi prej së paku 36%”.

53. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni konkluzionin e tij, për mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi, e ka mbështetur në argumentin se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar me dokumentacion justifikues mundësinë financiare të huadhënësit për të dhënë hua në shumën prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2008. Në shqyrtim të këtij pretendimi nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

53.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Në vitin 2008 kam blerë një autoveturë të markës Mercedes-Benz me vlerë prej 1.000.000 lekësh, të regjistruar në DRShMTRr Sarandë me targë {***}. Burimi i lekëve për blerjen ka qenë kontrata e huasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2008, redaktuar nga noter S. S., në Kavajë, me shtetasin I. M., me një afat 5-vjeçar, me këste 200.000 lekë në vit, e cila nuk është përfunduar plotësisht pasi është shtyrë me marrëveshje gojore. [...]”. Bashkëlidhur kësaj deklaratë, subjekti ka paraqitur kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2008, nga e cila rezulton që subjekti i rivlerësimit ka marrë hua në shumën 1.000.000 lekë nga shtetasi I. M., me qëllim blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”. Sipas kësaj kontrate, shuma e marrë hua i dorëzohet huamarrësit që në datën e nënshkrimit të kontratës dhe do të shlyhet në një afat 5-vjeçar, duke nisur nga data 05.12.2008 deri më datë 04.12.2013, duke u shlyer çdo vit shuma 200.000 lekë. Në rast mospagimi të kësaj shume brenda afatit, huamarrësi do të paguajë përveç shumës së marrë hua edhe 2% kamatë për çdo ditë vonesë. Kontrata e huasë dhe gjendja e detyrimit është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-të për vitet 2008, 2009, 2010, 2012, 2013, 2016, 2017 dhe në të vitit 2018, deklarohet edhe likuidimi i saj.

53.2 Pas kërkesës së Komisionit, për të provuar mundësinë financiare me burime të ligjshme të huadhënësit I. M., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁸² se : [...] për këtë hua që unë kam përfituar nga shtetasi I. M., banues në qytetin e Kavajës, kam deklaruar se është lidhje miqësore e imja, dhe në periudhën që unë kam marrë këtë hua në vitin 2008 ai ka zhvilluar në atë kohë (pasi aktualisht ka dalë në pension dhe ka mbyllur licencën në emër të tij, në vitin 2014), aktivitet tregtar në fushën e “Tregtimit të mishit”, regjistruar me NIPT {***} në qytetin e Durrësit, ku ka edhe një dyqan për këtë qëllim. Gjithashtu, informon se [...] ky shtetas në atë periudhë ka pasur depozita në bankë dhe konkretisht në ish-Bankën e Kursimeve, sot Raiffeisen Bank ShA, por nuk ka mundur të sigurojë të dhëna se sa ka qenë shuma e depozituar në këtë bankë. Për të provuar faktin se huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të dhënë këtë hua në vitin 2008, bashkëlidhur shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 26.05.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës (në vijim “DRT Durrës”) drejtuar shtetasit I. M., me të cilën informohet se [...] sipas të dhënave të sistemit informatik c@ts, qarkullimi vjetor për vitet 2006, 2007 dhe 2008, i tatimpaguesit “I. M.” regjistruar me NIPT {***}, me objekt aktiviteti “Tregti mishi”, me status “Pasiv” që më datë 30.09.2014, ka qenë si vijon: për vitin 2006, xhiro 3.600.000 lekë, për vitin 2007, “në Bashki”; për vitin 2008 “s’ka informacion”.

⁸² Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

Përveç të tjerash, sipas të dhënave të sistemit c@ts, më datë 26.05.2020, ky subjekt tregtar, rezulton me detyrime në c@ts, në shumën 335.000 lekë. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me konstatimin se duket se subjekti nuk ka provuar mundësinë e huadhënësit I. M. për dhënien e huasë në vitin 2008 në shumën prej 1.000.000 lekë. Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues vetëm për xhiron e aktivitetit dhe jo për fitimin neto. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit të datës 24.08.2021, subjekti i rivlerësimit në referim të përgjigjes e DRT-së Durrës ka shpjeguar se huadhënësi I. M. ka pasur mundësi për të dhënë hua duke llogaritur normën e fitimit të tij për vitin 2006, me 34%, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që ai ka pasur depozita kursimi në bankat e nivelit të dytë në vlera të konsiderueshme, por duke qenë se ato janë të dhëna personale nuk ka pasur mundësi të marrë informacion.

53.3 Në vijim të pretendimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me parashtrimet e tij në Kolegj, disa akte në cilësinë e provës⁸³, sipas së cilave Instituti i Statistikave Tiranë, përmes Drejtorisë së Statistikave Ekonomike, mbi bazën e kërkesës së përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, informon se INSTAT-i nuk disponon të dhëna lidhur me normat e fitimit të ndërmarrjeve të vogla, dhe se në bazën e të dhënave të tij, gjendet informacion mbi treguesit ekonomikë të ndërmarrjeve, akte që, sipas subjektit të rivlerësimit, provojnë faktin se ai është në kushte pamundësie për të gjetur normën e fitimit të bizneseve të vogla, kur edhe vetë institucionet shtetërore nuk e disponojnë.

53.4 Bazuar në situatën e fakteve të mësipërme, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka kryer hetime mbi huadhënësin, trupi gjykues sjell në vëmendje se specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 -32 të ligjit nr. 84/2016, është që detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuar nga persona të tjerë të lidhur e ka vetë subjekti i rivlerësimit. Po kështu, edhe barra e provës⁸⁴ në këtë proces është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra, i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim. Për t'iu kthyer zbatimit të këtyre normave në rastin konkret, nga analizimi i fakteve të mësipërme, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përmbushur detyrimin ligjor për ta konsideruar shtetasin I. M. person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë burimin e ligjshëm dhe mundësinë financiare të huadhënësit për dhënien e kësaj huaje e, *së fundi*, ka përmbushur edhe detyrimin ligjor duke i kaluar subjektit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e dokumentacionit të sipërcituar, trupit gjykues i rezulton i provuar fakti që shtetasi I. M. ka ushtruar aktivitet “*Tregti mishi*”, por nuk evidentohet fitimi *neto* i aktivitetit të tij për vitet 2006-200, dhe masa konkrete e të ardhurave të përfituara, me qëllim që të mund të verifikohet mundësia financiare e huadhënësit për të dhënë huanë në dhjetor të vitit 2008. Përgjigja e INSTAT-it, se ky institucion nuk disponon të dhëna mbi normat e fitimit të ndërmarrjeve të vogla, në vlerësimin e

⁸³ Kërkesë për informacion e datës 11.11.2021, drejtuar Institutit të Statistikave Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 02.12.2021, e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike, shoqëruar me komunikimin elektronik të datës 24.11.2024.

⁸⁴ Sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës në procesin e rivlerësimit i kalon subjektit të rivlerësimit.

trupit gjykues, nuk provon të qenit në kushte të pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion mbi të ardhurat konkrete të shtetasit I. M. nga aktiviteti i tij për vitet 2006-2008 dhe në këtë kuptim, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr.84/2016, vlerësohet si një provë e panevojshme për vendimmarrjen e trupit gjykues. Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues, pasi e gjeti të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për të mos e përfshirë shumën prej 1.000.000 lekësh të marrë hua, si burim të ligjshëm për blerjen e pasurisë, kontrollon përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare të kryer për periudhën 01.01.2008 - 31.12.2009, e cila rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti, për shkak të një balance negative në vlerën (-) 1.030.686 lekë për vitin 2008 dhe (-) 939.402 për vitin 2009.

53.5 Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se në vendim nuk janë pasqyruar shpjegimet mbi fitimin *neto* të huadhënësit dhe depozitat bankare të tij të dhëna në prapësimet e datës 24.08.2021, si dhe nuk është arsyetuar përse nuk janë marrë parasysh, trupi gjykues, referuar vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni, pasi ka analizuar në paragrafin 7.16⁸⁵ shkresën me nr. {***} prot., datë 26.05.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, për të provuar mundësinë financiare të huadhënësit, në përfundim, ka mbajtur qëndrimin: *"7.19 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni. [...] 7.21 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit në shumën prej 1.000.000 lekësh në vitin 2008, në përputhje me pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në kushtet në të cilat subjekti i rivlerësimit dhe shkresa e DPT-së nuk provojnë masën konkrete të të ardhurës/fitimit *neto* që huadhënësi I. M. ka realizuar nga aktiviteti ekonomik apo të ardhura të tjera për të mundësuar kryerjen e analizës për të verifikuar mundësinë financiare të këtij shtetasi për të dhënë hua 1.000.000 lekë në vitin 2008, duke mos përmbushur kështu detyrimin ligjor për të përmbysur barrën e provës, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, ndonëse nuk i ka cituar në mënyrë analitike, i ka analizuar e vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe ka mbajtur qëndrim të drejtë në raport me to.*

54. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni nuk ka arsyetuar se përse nuk pranohen argumentet e dhëna në prapësime, të tilla si automjetet kanë qenë të përdorura, çmimet e momentit sipas ligjit të kërkesës dhe ofertës, rastet e shtesës së vlerës për shkak të riparimeve kapitale, kryerja e transaksioneve me persona që nuk kanë pasur konflikt interesi dhe në çdo rast me dokumente zyrtare. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga kontrolli i vendimit objekt ankimi, konstaton se Komisioni, qoftë në përfundim të hetimit administrativ, qoftë në vlerësimin përfundimtar të tij, nuk rezulton të ketë pasur gjetje apo të ketë mbajtur ndonjë qëndrim lidhur me çmimin e blerjes së këtij automjeti apo ndonjë situatë trajtimi preferencial. Në të tilla kushte, trupi gjykues vlerëson se ky shkak ankimor nuk është relevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzioneve të Komisionit për këtë automjet.*

⁸⁵ Në paragrafin 7.16 të vendimit citohet: *"Sipas shkresës së tatimeve me nr. {***} prot., datë 26.5.2020, vërtetohet xhiroja për vitin 2006, për biznesin në emër të shtetasit I. M., në vlerën 3.600.000 lekë. Subjekti nuk vërteton fitimin neto nga biznesi i huadhënësit për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënies prej 1.000.000 lekësh".*

55. Në mbyllje të analizës së shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues i rezulton që automjeti, tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, nuk ka ekzistuar si pasuri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, pasi është shitur në vitin 2013. Në këto kushte dhe në zbatim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilëve subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* pasuritë që ata disponojnë në momentin e plotësimit të kësaj deklarate dhe burimet e financimit të tyre, trupi gjykues vlerëson se fakti i deklarimit të tij nga subjekti i rivlerësimit në këtë deklaratë, edhe pse nuk ka pasur detyrim të deklarojë, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi sipas ligjit. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, për të dhëna që nuk duhet të ishin pjesë e këtij deklarimi, sipas përcaktimit ligjor, është në tejkalim të situatave të parashikuara për t’u kualifikuar, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, nga kontrolli i analizës financiare përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, trupi gjykues arrin në përfundimin se lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e saj në vitin 2008.

Automjet i markës “Peugeot”, me targë {}, në vlerën 500 euro***

56. Komisioni, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke ngritur pretendimet në vijim.

57. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbajë përgjegjësi se përse e ka deklaruar në ILDKPKI me vonesë shitblerjen e kësaj makine dhe se analiza financiare mbi mundësinë e blerjes së automjetit tip “Peugeot” më 23.01.2012, në vlerën 500 euro, është pjesore dhe e pambështetur në metodologji të përcaktuar në shtojcën kushtetuese, ligjin nr. 84/2016 apo ndonjë ligj tjetër. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

57.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Në datën 23.01.2012, kam blerë nga shtetasi A. G. një auoveturë të markës “Peugeot 106”, për një vlerë 500 euro, të cilën e kam regjistruar me targë {***} dhe ia kam shitur shtetasit B. M. për shumën 2.200 euro. Blerë auoveturë për 500 euro, shitur 2.200 euro, gjendje 1.700 euro”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2012, ka deklaruar: “Shitje e një auoveture tip “Peugeot 106” me targë {***}, shtetasit B. M. me kontratë shitje nr. {***} rep./kol., datë 06.02.2012, në vlerën “2.200 euro”, pjesa takuese “100%”. Në këtë deklaratë, nuk rezulton të jetë deklaruar blerja e automjetit “Peugeot” në datën 23.01.2012.

57.2 Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja⁸⁶ administruar në Komision, rezulton se përmes një deklarate personale (të thjeshtë) të datës 23.01.2012, shtetasi A. G., deklaron se i ka shitur subjektit të rivlerësimit, automjetin e markës “Peugeot”, në të cilën nuk evidentohet çmimi i shitjes⁸⁷. Me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2012, ky automjet i është shitur blerësit B. M., kundrejt vlerës 2.200 euro likuiduar ndërmjet tyre, jashtë

⁸⁶ Dokumentacion i përcjellë nga DPSHTRr-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 28.04.2020.

⁸⁷ Më datë 26.01.2012, për këtë automjet janë paguar detyrimet doganore në vlerën 22.832 lekë.

zyrës noteriale. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, i pyetur nga Komisioni, lidhur me faktin e mosdeklarimit të blerjes së këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2012, si dhe lidhur me faktin e realizimit të një fitimi prej 1.700 eurosh brenda 2 (dy) javësh, subjekti ka sqaruar se mosdeklarimi ka ardhur si për faktin se shitja dhe blerja kishin ndodhur shumë shpejt për shkak të këmbënguljes së blerësit, ashtu dhe për arsye të vlerës së vogël të blerjes. Fitimin e realizuar, subjekti e ka lidhur me faktin se automjetit i ishin bërë shumë shërbime të tjera, si dhe zhdoganimi, targimi, siguracioni dhe likuidimi i taksave. Këto sqarime nuk shoqërohen me dokumentacion provues mbi shpenzimet e shërbimeve të kryera. I pyetur nga Komisioni mbi shpenzimet e kryera, vlerat përkatëse, periudhën e kryerjes së tyre, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore për këtë automjet, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për automjetin “Peugeot” dhe “Audi” që trajtohet në vijim ka kryer veprimet për zhdoganimin dhe regjistrimin e tyre, ndërkohë që për vlerat e përfituara nga shitja nuk është paguar ndonjë tatim për fitimin, pasi nuk i është kërkuar nga asnjë institucion tatimor që të paguhej një vlerë e tillë. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁸⁸ në ankim apo në parashtrime, nuk rezultojnë të jenë paraqitur dokumente që të provojnë pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ apo në raprësime se kjo rritje çmimi kishte ardhur për shkak të riparimeve kapitale.

57.3 Bazuar në situatën e fakteve si më sipër, trupi gjykues vëren se automjeti “Peugeot” rezultojnë të jetë shitur nga subjekti 2 (dy) javë pas blerjes së tij, pra, nuk ka ekzistuar si pasuri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin për të deklaruar në deklaratën *vetting* të gjitha pasuritë që ata disponojnë në momentin e plotësimit të kësaj deklarate dhe burimet e financimit të tyre. Në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim të deklarojë lidhur me të, dhe se fakti i mosdeklarimit të këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2012, si detyrim ligjor në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi për pasaktësi të deklaratës *vetting*, sipas ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklaratën *vetting* është në tejkallim të situatave të parashikuara për t’u kualifikuar, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për metodologji financiare të gabuar duke kryer analizë financiare pjesore, për sa kohë që për qëllim të procesit të rivlerësimit kjo analizë i referohet momentit të krijimit të pasurisë⁸⁹, për më tepër që në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, kursime *cash* në banesë apo likuiditete gjendje në bankë akumuluar nga periudha të mëparshme, të ardhura të realizuara nga shitje pasurie apo të tjera. Në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, me të drejtë vlerësimi i situatës financiare të subjektit të rivlerësimit është kufizuar në verifikimin e mundësisë së tij për të krijuar këtë pasuri në periudhën 01.01.2012-23.01.2012. Nga kontrolli i kësaj analize, të kryer për periudhën nga Njësia e Shërbimit Ligjor, trupit gjykues arrin në përfundimin se

⁸⁸ Në përfundim të hetimit administrativ subjektit i kaloi, ndër të tjera, barra e provës se ngelet i dyshimtë fakti i blerjes së kësaj pasurie në vlerën prej 500 euro dhe shitjen në vlerën 2.200 euro

⁸⁹ Pika 7 e Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, përcakton: “7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie të luajshme në datën 23.01.2012, si dhe shpenzimet e kryera e kursimet e realizuara deri në këtë datë, pasi rezultojn me diferencë negative në vlerën (-) 142.205 lekë dhe, për rrjedhojë, të mos konsiderohen në analizën e vitit 2012, të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në datën 06.02.2012.

57.4 Përveç konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i çmimit të shitjes së këtij automjeti brenda 2 (dy) javësh, nga 500 euro në 2.200 euro, për më tepër në rrethana të tilla si përfitimi i tij jo përmes një akti ligjor në kuptim të Kodit Civil dhe mosdeklarimi i blerjes por vetëm i shitjes së automjetit, është disproporcional me provat e administruara dhe parimet e barazisë e të paanësisë mbi marrëdhëniet kontraktuale të përcaktuara në dispozitat e Kodit Civil⁹⁰ dhe përbën një sjellje që meriton të vlerësohet në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit 84/2016 si një sjellje që bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror dhe që nuk është në përputhje me parimet e *Bangalores* mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005.

58. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk ka arsyetuar mbi mospranimin e argumenteve të dhëna në prapësime, të tilla si automjetet kanë qenë të përdorura, çmimet e momentit sipas ligjit të kërkesës e ofertës, shtesa e vlerës për shkak të riparimeve kapitale, si dhe kryerja e transaksioneve me persona që nuk kanë pasur konflikt interesi e në çdo rast me dokumente zyrtare, çka përbën mosarsyetim vendimi*. Në shqyrtim të këtij pretendimi, i cili është i njëjtë edhe për automjetet e markave “Audi” dhe “Volkswagen” që trajtohen në vijim, trupi gjykues vëren se pavarësisht konkluzionit⁹¹ të arritur në vendim se *subjekti nuk paraqiti prova dhe argumente bindëse lidhur me mosdeklarimet e pasurisë automjet, mungesën e kontratave të blerjes, pamundësinë financiare dhe krijimin e tyre, si dhe çmimin preferencial të përfitimit, duke i shitur me vlerë më të madhe se vlera e blerjes*, nuk rezultojn që Komisioni të ketë mbajtur ndonjë qëndrim apo ta ketë kualifikuar situatën në rastin konkret si trajtim preferencial në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, por e ka lënë qëndrimin e tij në nivel konstatimi e pa lidhje të drejtpërdrejtë me ndonjë nga shkaqet e shkarkimit të parashikuara shprehimisht nga ligji. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mungesë arsytimi nga ana e Komisionit në këtë çështje, trupi gjykues konstaton se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Për sa i përket makinave që kam blerë unë, gruaja, djali dhe vajza ime del qartë se ato kanë qenë të gjitha makina të përdorura dhe si mallra konsumi në qarkullimin civil, çmimet e tyre kanë qenë të momentit sipas kërkesës dhe ofertës. Rëndësi ka që asnjëherë ato nuk janë bërë pa dokumente zyrtare, janë transaksione të bëra me persona që nuk kanë pasur konflikte interesi me mua si prokuror. [...] Komisioni kur ngre dyshime për çmimet e blerjes apo shitjes nuk bën të ditur se mbi bazën e cilave standarde i ngre dyshimet, kur nuk merr parasysh vitet e prodhimit të makinave (vjetërsinë), rastet e shtesës së vlerës, për shkak të riparimeve kapitale që ja rritin vlerën makinës”*. Në paragrafët 10.6 dhe 10.7 të vendimit, Komisioni shprehet se: *“Subjekti i rivlerësimit, në*

⁹⁰ Në nenin 686, paragrafi i 2-të i Kodit Civil përcaktohet se: *“Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuara të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale”*.

⁹¹ Paragrafi 10.7 i vendimit të Komisionit.

përgjigje të rezultateve të hetimit nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni. Konstatimet e Komisionit janë për të tria pasuritë automjete të përmendura në pikat 8.9 dhe 10 të vendimit. Subjekti nuk paraqiti prova dhe argumente bindëse lidhur me mosdeklarimet e pasurisë automjet, mungesën e kontratave të blerjes, pamundësinë financiare për krijimin e tyre, si dhe çmimin preferencial të përfitimit, duke i shitur me vlerë më të madhe se vlera e blerjes”. Në analizë të këtyre fakteve, përkundër sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni i ka nënshtruar vlerësimin të tij shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative⁹², duke i konsideruar ato të pamjaftueshme për të përmbysur konstatimet e Komisionit, ndonëse në përfundim nuk i ka atribuar subjektit ndonjë pasojë ligjore të parashikuar shprehimisht nga ligji.

Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e saj në vitin 2012.

Automjet i markës “AUDI” tip “A4”

59. Komisioni, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
60. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë pasuri si një analizë pjesore dhe të pa mbështetur në metodologji dhe në ligjin nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

60.1 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, trupi gjykues konstaton se: (i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Me faturën nr. {***}, datë 12.07.2012, kam blerë nga shtetasi A. P. një autoveturë të markës “Audi A4” për një vlerë prej 850 euro, prodhim i vitit 1997. Pas targimit, këtë autoveturë ia kam kaluar djalit tim L. H. me kontratë shitje [...]”. Në rubrikën “Vlera me shifra dhe me fjalë” deklarohet: “Blerë një autoveturë për 850 euro dhe shitur më pas për 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”. (ii) Në DIPP-në vitit 2012, deklarohet: “Blerje e një autoveture të përdorur “Audi A4”, viti 1997, e regjistruar në emër të djalit L. H.. Vlera është deklaruar 850 euro. Pjesa takuese: 100%. Fatura nr. {***}, datë 12.07.2012”. (iii) Në DIPP-në vitit 2014, deklarohet: “Të ardhura nga shitja e autoveturës e markës “Audi” me targë {***} me shitës L. H. dhe blerës A. A.”.

60.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë në Komision nga DPSHTRr-ja⁹³, rezulton se ky automjet është përfituar me faturë për shitje autoveture të përdorur me targë {***}, me nr. {***}, datë 12.07.2012, përkthyer dhe noterizuar, në vlerën 850 euro, për të cilën më datë 17.07.2012 është kryer edhe pagesa e detyrimeve doganore në shumën 34.400 lekë. Me kontratë shitblerje

⁹² *Ku nen parashikon se organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrativ.*

⁹³ *Me shkresë nr. {***} prot., datë 28.04.2020.*

automjeti, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2012, subjekti Sali Hasa ia shet këtë automjet të birit L. H., kundrejt çmimit 1.000 euro, shumë e likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale. Më pas, me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.09.2014, ky automjet rezulton t'i jetë shitur blerësit A. A., kundrejt vlerës 400.000 lekë. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dhënë sqarime lidhur me faktin se në çfarë mënyrë vlera e këtij automjeti me kalimin e kohës nuk ishte zvogëluar por ishte rritur, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁹⁴ se kjo kishte ndodhur për shkak të vlerës së shpenzimeve të kryera për zhdoganimin e mjetit, shërbimeve të kryera dhe gjendjes shumë të mirë të automjetit. Këto shpjegime nuk shoqërohen me dokumentacion provues mbi shpenzimet e shërbimeve të kryera. I pyetur më tej nga Komisioni mbi pagesën e detyrimeve tatimore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁹⁵ se nuk është paguar ndonjë tatim për fitimin, pasi nuk i është kërkuar nga asnjë institucion tatimor që të paguhej një vlerë e tillë. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁹⁶ në ankim apo në parashtime, nuk rezulton të jenë paraqitur dokumente që të provojnë pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ apo në prapësime se kjo rritje çmimi kishte ardhur për shkak të riparimeve kapitale.

60.3 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të kryer në Komisioni për periudhën 24.01.2012 – 17.07.2012, e cila rezultoi me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit të markës “Audi” në korrik të vitit 2012, shpenzimet e kryera e kursimet e realizuara, në vlerën (-) 690.820 lekë. Me arsyetimin e bërë më sipër në këtë vendim, nuk është përfshirë në këtë analizë, e ardhura në vlerën 2.200 euro përfituar nga shitja e automjetit “Peugeot” më datë 06.02.2012.

60.4 Trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i çmimit të shitjes së këtij automjeti nga 850 euro në vitin 2012, në 400.000 lekë në vitin 2014, për më tepër i përfituar jo përmes një akti ligjor në kuptim të Kodit Civil, është një veprim jashtë logjikës financiare dhe përbën një sjellje që duhet të kualifikohet, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një sjellje që bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror dhe që nuk është në përputhje me *parimet e Bangalore*s mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005.

60.5 Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri, bazuar në të njëjtin arsyetim si në pasurinë e mësipërme se subjekti i rivlerësimit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për një pasuri që nuk ka ekzistuar në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme në vitin 2012, në vlerën (-) 690.820 lekë.

⁹⁴ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit.

⁹⁵ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

⁹⁶ Në përfundim të hetimit administrativ subjektit i kaloi, ndër të tjera, barra e provës se ngelet i dyshimtë fakti i blerjes së kësaj pasurie në vlerën prej 850 euro në vitin 2012 dhe shitjen më pas të saj në vlerën prej 400.000 lekë në vitin 2014.

Në lidhje me pasurinë “Automjet tip Volkswagen”

61. Komisioni, në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
62. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë pasuri si një analizë pjesore dhe të pambështetur në metodologji dhe në ligjin nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet e dosjes së Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

62.1 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, trupi gjykues konstaton se: (i) Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, i biri L. H., ka deklaruar: “*Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2016, kam blerë një autoveturë tip ‘Volkswagen’ nga shtetasi E. L. dhe e kam regjistruar në DRShMT-në Durrës dhe ka targë {***}. Burimi i lekëve për blerjen është shuma e përfituar nga makina Audi A4. Blerë: 200.000 lekë. Kam shpenzuar dhe 100.000 lekë për riparime. Pjesa takuese: 100%”.* (ii) Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Me kontratë shitblerje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2016, djali im L. H. ka blerë një autoveturë të markës ‘Volkswagen Golf’ e vitit 2005 me çmimin 200.000 lekë nga shtetasi E. L.. Burimi i të ardhurave janë të ardhura të akumuluar nga shitja e autoveturës ‘Audi A4’ shtetasit A. A. për shumën 400.000 lekë”.*

62.2 Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga DPSHTRr-ja, rezulton se ky automjet është përfituar përmes kontratë shetje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.5.2016, të lidhur mes shitësit E. L. dhe blerësit L. H., kundrejt çmimit 200.000 mijë lekë, ku ky i fundit është dakord për blerjen e automjetit pa pasur ndonjë pretendim për gjendjen në të cilën ndodhet. Me kontratë shetje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.06.2018, L. H. ia ka shitur këtë pasuri të luajtshme, shtetasit A. D. në vlerën 4.900 euro, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit⁹⁷, në ankim apo në parashtrime nuk rezulton të jenë paraqitur dokumente që të provojnë pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ apo në prapësime se kjo rritje çmimi kishte ardhur për shkak të riparimeve kapitale.

62.3 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues kontrollon përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare të kryer në Komision për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për krijimin e kësaj pasurie, nga ku konstatoi se me të drejtë Komisioni nuk ka përfshirë në të të ardhurat nga shitja e automjetit “Audi” në shumën 400.000, si burim krijimi të kësaj pasurie, për sa kohë rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e tij. *Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

⁹⁷ Në përfundim të hetimit administrativ subjektit i kaloi, ndër të tjera, barra e provës se ngelet i dyshimtë fakti i blerjes së automjetit në raport me vlerën e tregut [...].

62.4 Përveç konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i çmimit të shitjes së këtij automjeti nga 200.000 lekë (dhe riparimet në vlerën 100.000 lekë) në vitin 2016, në 4.900 euro në vitin 2018, është një veprim jashtë logjikës financiare dhe përbën një problematikë që duhet të kualifikohet, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një sjellje që bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror dhe që nuk është në përputhje me *parimet e Bangalores* mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005, sipas së cilave prokurorët kanë përgjegjësinë që edhe në jetën e tyre jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm e të mos lejojnë përfitime apo trajtime që mund të ngrenë pikëpyetje mbi integritetin e tyre.

Në lidhje me pasuritë në përdorim

63. Në lidhje me këto pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti argumente bindëse lidhur me përdorimin e këtyre pasurive, pa kundërshtpërblim ndër vite. Për Komisionin, veprime të tilla, pavarësisht mospasjes në dukje të konfliktit të interesit, cenojnë figurën e gjyqtarit dhe humbin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.*
64. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në vendim nuk janë parashtruar prapësimet e tij dhënë në përgjigjet e pyetësorëve dhe arsyet se përse nuk janë marrë parasysh këto pretendime. Sipas tij kjo përbën shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor, në formën e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstaton se:*

64.1 Në lidhje me *automjet i markës “Mercedes-Benz”, me targë {***}*: (i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Aktualisht kam në përdorim një autoveturë të markës ‘Mercedes-Benz’, me targë {***}, prodhim i vitit 2001, që nuk është regjistruar në emrin e tim. E kam në provë dhe e kam marrë nga shtetasi D. A., banues në lagjen nr. {***} Sarandë”*; (ii) Në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar: *“Kam përdorur në vitin 2017 një autoveturë të markës ‘Mercedes-Benz’, që ka qenë në pronësi të shtetasit P. H. dhe me qëllim për ta blerë, të cilën e ka pasur me prokurë shtetasi D. A., por për shkak se nuk më vinte në kërkesat e mia, ia kam kthyer përsëri pronarit që e ka pasur”*; (iii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: *“[...] Nuk kemi përpiluar asnjë deklaratë apo akt noterial për të përdorur këtë automjet, sepse e kisha për të provuar dhe nuk është realizuar shitja e tij në favorin tim”*; (iv) Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar, ndër të tjera, se: *“[...] shtetasin P. H. nuk e njeh dhe se nuk ka pasur asnjëherë kontakte me të”*; (v) Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të deklaruar e paraqitur dokumentacion provues nga institucionet përkatëse nëse gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror ka ndjekur çështje me shtetasit D. A. dhe P. H., subjekti ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 se nga verifikimet e kryera në sistem dhe aktet që disponon nuk ka ndjekur asnjë procedim penal ku palë të kenë qenë këta shtetas, por për shkak të volumit të madh nuk janë printuar dokumentet nga sistemi i menaxhimit të çështjeve në prokurori.

64.2 Në lidhje me *automjet i markës “Mercedes-Benz”, me targë {***}*: (i) Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, vajza e subjektit të

rivlerësimit A. H., ka deklaruar se *ka në përdorim një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në pronësi të shtetasit E. Gj.*; (ii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se vajza e tij ka përdorur në periudhën 15.09.2016 - 25.12.2016, automjetin në pronësi të shtetasit E. Gj., shok i ngushtë me të birin L. H., i cili asokohe dispononte dy automjete. Sipas subjektit, në atë kohë nuk është përpiluar ndonjë akt për ta përdorur mjetin, me mendimin se do ta blinin atë, por nuk u dakordësuar për çmimin. Subjekti i ka shoqëruar këto shpjegime me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2020, të shtetasit E. Gj.; (iii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar se nuk ka ndjekur asnjë procedim penal, ku palë ka qenë ky shtetas, fakt që provohet, sipas tij, nga verifikimi në sistemin e menaxhimit të çështjeve në prokurori.

64.3 Në lidhje me dy apartamente në përdorim në qytetin e Sarandës: (i) Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *“Nga muaji korrik 2003 deri në muajin janar 2005 kam jetuar në banesën që ishte në pronësi të shtetasit P. S., në lagjen nr. {***}, Sarandë. Ky shtetas këtë banesë ma ka lënë përkohësisht në përdorim, pashpërblim (qira), pasi e kishte të lirë dhe në të nuk banonte ndonjë person. Nuk kemi lidhur akt përdorimi, por është bërë me mirëbesim reciprok, duke mirëkuptuar se në momentin që do të kërkohej lirimi i banesës do të lirohej menjëherë nga ana ime [...]. Nga muaji janar 2005 deri në muajin qershor 2010, kam jetuar në banesën që ishte në pronësi të shtetasit A. M. Xh., banesë e cila ndodhet në lagjen nr.{***}, rruga “{***}”, Sarandë, banesë të cilën e kam pasur në përdorim pashpërblim, pasi ky shtetas dispononte banesë tjetër që jetonte me familjen e tij në qytetin e Sarandës [...]”*. Subjekti i ka shoqëruar këto shpjegime me deklaratat noteriale⁹⁸ të shtetasve E. S. dhe A. Xh.; (ii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: *“[...] me të dy titullarët e banesave, që kam përdorur unë në qytetin e Sarandës, kam pasur njohje si qytetar i këtij qyteti. [...] kam jetuar në këto apartamente, pasi kanë qenë të pabanuar nga ndonjë person tjetër, ishin të lirë dhe ka qenë vullneti i vetë pronarëve të tyre, që të jetonim në to, pas shpërblim, me qëllim për t’i pasur në ruajtje dhe që ato apartamente të mos amortizoheshin nga mbajtja mbyllur. Ky është një fenomen shumë i përhapur në qytetin e Sarandës, ku shumë apartamente jepen në ruajtje apo në përdorim, për t’i ruajtur dhe mirëmbajtur, pasi pronarët e tyre jetojnë e punojnë jashtë shtetit [...]”*; (iii) I pyetur nga Komisioni, nëse ka pasur ndonjë çështje gjatë ushtrimit të funksionit shtetëror me pronarët e këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar se: *“Me të dy personat, si me shtetasin P. S. dhe me shtetasin A. Xh., që unë kam qëndruar në banesat e tyre, nuk kam pasur në vlerësim apo hetim ndonjë çështje që kishte të bënte me ushtrimin e funksionit shtetëror si prokuror, nga viti 2003 deri në vitin 2004 nuk kam qenë prokuror, por as nga viti 2004 e deri në vazhdim”*. Subjekti i ka shoqëruar shpjegimet e tij me akte shkresore⁹⁹ mbi pronësinë e apartamentit të shtetasit P. S.; (iv) Pas kërkesës së Komisionit, për të deklaruar e paraqitur dokumentacion provues nga institucionet përkatëse, nëse gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror ka ndjekur çështje me shtetasit A. Xh. dhe P. S., subjekti i

⁹⁸ Deklaratat noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.01.2020 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.01.2020.

⁹⁹ a) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.02.2000, me palë P. S. dhe K. M., me objekt apartament banimi të ndodhur në qytetin e Sarandës, lagja nr. {***}, pall. {***}, me sipërfaqe 65 m²; b) vërtetim nga dokumentet hipotekor të apartament në lagjen nr. {***}, Sarandë, me sipërfaqe 65 m², në pronësi të P. S., më datë 29.03.2000; c) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2007, me palë P. S. dhe E. V., me objekt apartament në lagjen nr. {***}, Sarandë.

rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 4, se nuk ka ndjekur asnjë çështje penale ku palë ka qenë A. Xh. apo familjarët e tij, ndërsa në lidhje me shtetasin P. S., banesën e të cilit ka pasur në përdorim, ka shpjeguar se pas caktimit me short ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 14.11.2017, mbi referimin e bërë nga Komisariati i Policisë Sarandë, mbi bazën e kallëzimit të kryer nga ky shtetas lidhur me vjedhjen e një biçiklete, procedim penal për të cilin është vendosur pezullimi i hetimit për shkak se nuk është gjetur autori i vjedhjes. Sipas subjektit, ai ka urdhëruar regjistrimin e çështjes, për shkak se ka vlerësuar se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

64.4 Në analizë të fakteve si më sipër, për sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se Komisioni nuk ka paraqitur parashtrimet e subjektit të rivlerësimit dhënë në përgjigje të pyetësorëve dhe nuk ka arsyetuar rrëzimin e tyre, trupi gjykues konstaton se pavarësisht se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, paraqiten në paragrafët 12.1, 12.2, 12.3 dhe 12.4 të vendimit, jo në një mënyrë të detajuar, në paragrafët vijues 12.5 – 12.9, Komisioni, pasi ka bërë një vlerësim paraprak të tyre, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të gjitha gjetjet e konstatimet¹⁰⁰ në lidhje me pasuritë në përdorim. Në përfundim, në paragrafin 12.11, ka mbajtur qëndrimin se subjekti nuk ka mundur të provojë dhe të argumentojë deri në atë masë sa të kundërshtojë, pra, të përmbysë barrën e provës së dërguar nga Komisioni, çka dëshmon në vetvete se argumentet dhe provat e paraqitura prej tij i janë nënshtruar një procesi analize e vlerësimi në përputhje me bindjen e brendshme të trupit gjykues. Fakti që Komisioni nuk i vlerësoi bindëse argumentet e subjektit mbi përdorimin pa kundërshtpërblim të këtyre pasurive nuk do të thotë se nuk i ka vlerësuar ato, por që ka pasur një vlerësim të ndryshëm nga ai i pritshëm nga subjekti i rivlerësimit, e cila mbetet një çështje diskrecionale e organeve të rivlerësimit, në zbatim të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016.

64.5 Përveç konkluzionit të mësipërm, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit përdorimi pa kundërshtpërblim dhe pa ndonjë akt formal i dy pasurive të paluajtshme në qytetin e Sarandës, përkatësisht në periudhat korrik 2003 - janar 2005 (përdorim i cili ndonëse ka nisur një vit përpara nisjes së detyrës së prokurorit në këtë qytet¹⁰¹ ka vijuar përgjatë saj) dhe janar 2005 – qershor 2010, si dhe përdorimi pa akt formal i dy automjeteve përkatësisht nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2017 dhe personi i lidhur në periudhën 15.09.2016-25.12.2016, përbëjnë elementë që meritojnë të vlerësohen, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016, si veprime që bien ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror dhe që nuk është në përputhje me *parimet e Bangalores* mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të

¹⁰⁰ 12.5. Komisioni e konstatoi të dyshimtë faktin se subjekti ka përdorur apartamentin në rrugën “{***}”, për gati 2 vjet, 5 vjet apartamentin në rrugën “{***}”, pa kundërshtpërblim dhe pasurinë automjet për të cilat kreu hetimin administrative. 12.6 Përdorimi i këtyre pasurive nga subjekti për disa vite, pa kundërshtpërblim, u konsiderua i dyshimtë nga Komisioni. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se ndër vite ka pasur në përdorim apartamentin në pronësi të shtetasve P. S. dhe A. Xh. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezultoi se këto pasuri të paluajtshme ishin në emër të personave të deklaruar nga subjekti. Pasuritë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa {***} dhe automjet tip “Mercedes-Benz” me targa {***}, rezultuan me mungesë dokumentacioni ligjor për përdorimin e tyre, si dhe lidhur me pronësinë dhe afatet kohore të marrjes/dorëzimit.

¹⁰¹ Subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, më 16.07.2004.

Përgjithshëm në datën 31 maj 2005, pavarësisht justifikimit të subjektit të rivlerësimit që këto sjellje lidhen me marrëdhëniet shoqërore, marrëdhënie rastësore apo mirëbesimi reciprok mes qytetarësh të të njëjtit qytet.

Lidhur me dhurimin nga shtetasit J. B. dhe M. B., në formën e përballimit të shpenzimeve për një udhëtim në Moskë në vitin 2006

65. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] *Pas shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit shkresor të administruar rezultoi se sipërfaqja e tokës e dhuruar nga shtetasi V. R. ishte 1000 m², por Komisioni konstatoi se subjekti nuk shpjegoi bindshëm si është përfituar ky dhurim nga një shtetas, i cili nuk ndodhet në rrethin familjar të tij. Pranimi i dhurimit nga një prokuror të një sipërfaqeje të konsiderueshme toke, ndonëse nuk evidentohet ndonjë rast i drejtpërdrejtë i konfliktit të interesit me dhuruesin, cenon besimin e publikut. 6.14 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, duke mos u gjendur në kushtet e gërmës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.*
66. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke pretenduar në ankim dhe në parashtrime se *nuk mund të flitet për konflikt interesi, të ngrihen dyshime në lidhje me shumën e paguar apo të konsiderohet si humbje e besimit të publikut, pasi bashkëshortja e tij, M. H. dhe M. B. (T.) kanë lidhje familjare mes tyre, fakt i njohur botërisht si në qytetin e Sarandës dhe në atë të Kavajës, që edhe mund të vërtetohet nëse krahasohen certifikatat familjare të tringjeve të familjeve të përmendura. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës me parashtrimet në Kolegj edhe aktet: (i) certifikatë martesë të J. dhe M. B.; (ii) certifikatë familjare e familjes B.; (iii) certifikatë familjare e familjes D.; (iv) certifikatë familjare e familjes T.; si dhe (v) certifikatë familjare e familjes S.*

66.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga aktet në dosjen gjyqësore ,trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 2006, shtetasit M. B. dhe J. B., për shkak të marrëdhënieve familjare me bashkëshorten e tij M. H., kanë mbuluar shpenzimet e një udhëtimi me avion (biletat) për në Moskë, Rusi, ku studionin fëmijët e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që çifti B. do të merrte informacion për biznesin në fushën e ndërtimit. Sipas subjektit, kostot e akomodimit në hotel i ka mbuluar me shpenzimet e veta, në vlerën 480 USD gjithsej, por nuk disponon fatura për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.01.2020, të shtetases M. B., përmes së cilës konfirmohen deklaramet e tij lidhur me këtë fakt. Pas kërkesës së Komisionit, për të dhënë sqarime e paraqitur dokumentacion provues nga institucionet përkatëse, nëse gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit ai ka ndjekur çështje penale me shtetasit J. B. e M. B., subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka deklaruar se: “Nga verifikimi në sistemin CAMS dhe në aktet që unë administroj në lidhje me shtetasit J. B. dhe M. B., nuk më rezulton që të kem ndjekur ndonjë procedim penal ku palë të kenë qenë këta shtetas”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte provuese për të mbështetur këto deklarime, me sqarimin se *për shkak të volumit të madh nuk janë printuar shfaqje nga sistemi CAMS, për menaxhimin e çështjeve në prokurori.* Nga verifikimi i

deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ky dhurim nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në DIPP-në e vitit 2006, madje në këtë të fundit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nuk ka dhënë ose marrë asnjë dhuratë*. Mbështetur në të dhënat e administruara, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës se *ngelet e dyshimtë lidhja e subjektit me këta shtetas, shuma e dhuruar, si dhe ky dhurim nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratat e pasurisë*. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, nuk rezultojnë sqarime të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë situatë.

66.2 Bazuar në situatën e fakteve më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në rastin konkret nuk mund të flitet për konflikt interesi, në kushtet kur Komisioni nuk rezulton të ketë arritur në një konkluzion të tillë, përkundrazi ka vlerësuar se subjekti nuk ndodhet në kushte konflikti interesi në dukje, është jorelevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues e gjen me vend të nënvizojë faktin se një konkluzion i tillë nga Komisioni duhet të kishte ardhur mbi bazën e analizimit të kësaj situatë nën dritën e kuadrit ligjor përkatës, më konkretisht ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i cili, në gjendjen e tij në fuqi¹⁰² në vitin 2006, marrjen e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale i renditnin si një nga rastet e kufizimit të interesave private të zyrtarit, duke e lidhur ngushtësisht me lindjen e konfliktit të interesit. Në zbatim të këtyre dispozitave, në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit mbi mungesë të konfliktit të interesit duhet të ishte bazuar në akte provuese të lëshuara nga organi i prokurorisë, sikurse ishte kërkuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe jo të bazohej vetëm në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit argumentuar me faktin se *për shkak të volumit të madh nuk janë printuar shfaqje nga sistemi CAMS, për menaxhimin e çështjeve në prokurori*. Vetëm pas një analize të tillë, mund të përjashtohet plotësisht versioni që mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit nga bashkëshortët Barka të kishte ardhur si pasojë e ndonjë vendimmarrjeje të subjektit të rivlerësimit në ndonjë çështje penale dhe që kjo vendimmarrje të ketë qenë e ndikuar nga interesi i tij privat.

66.3 Lidhur me pjesën tjetër të pretendimit të subjektit, se Komisioni nuk mund të ngrejë dyshime mbi shumën e dhuruar apo ta konsiderojë këtë rrethanë si cenim të besimit të publikut, duke iu referuar marrëdhënies së afërt të bashkëshortes së tij dhe shtetasës M. B., trupi gjykues, bazuar në situatën e fakteve si më sipër, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, këtë situatë në formë dhurimi apo trajtimi preferencial, të parashikuar nga neni 4, shkronja “F” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, sipas së cilit subjektet deklaruese detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, lidhur me dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale, me përjashtim të rastit kur vlera e dhuratës ose trajtimit

¹⁰² Në nenin 23 të ligjit përcaktohet: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”.

preferencial është më e vogël se 10.000 lekë. Nga ana tjetër, i vetmi dokumentacion i administruar që lidhet me këtë situatë është deklarata noteriale e shtetases M. B., e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, të cilën, trupi gjykues, referuar jurisprudencës së Kolegjit, në mungesë të ndonjë dokumenti tjetër të kohës e konsideron me vlerë të kufizuar provuese për faktet që deklarohen në të. Në këto kushte, në mungesë të deklarimit të subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2006, si dhe të ndonjë tjetër dokumenti të kohës lidhur me këtë rrethanë, trupi gjykues nuk i gjen të justifikuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ky dhurim ka ardhur si pasojë e marrëdhënies së afërt mes bashkëshortes së tij dhe shtetases M. B.. Në këtë kuptim, edhe certifikatat familjare të sipërcituara, paraqitur në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës për të provuar lidhjen familjare të bashkëshortes së tij me dhuruesit e biletave të udhëtimit të familjes së subjektit në Moskë, në vitin 2006, konkretisht me shtetasen M. B. (T.), në vlerësimin e trupit gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, janë të panevojshme për vendimmarrjen e tij, duke i përjashtuar nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.

66.4 Përveç konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se problematika në rastin konkret meriton të vlerësohet në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr.84/2016, si sjellje e subjektit të rivlerësimit që bie ndesh me sjelljen që pritet të ketë një prokuror dhe që nuk është në përputhje me *parimet e Bangalores* mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët dhe *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005, pavarësisht justifikimit të tij se kjo lloj sjelljeje lidhet me marrëdhëniet e miqësisë mes bashkëshortes së tij dhe dhuruesve.

Në lidhje me shpenzimet e arsimimit të fëmijëve dhe analizën financiare

67. Lidhur me shpenzimet e arsimimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në Rusi, Komisioni ka arritur në përfundimin se: i) *Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni; ii) Nuk u provua mundësia financiare e babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të saj për të kontribuar në shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në Rusi; iii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të arsimimit të fëmijëve, duke u gjendur në kushtet e përcaktimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këto konkluzione, duke ngritur pretendimet që trajtohen si vijon.*
68. *Nuk mund të shkruhet në vendim që “subjekti pretendon” për sa kohë është provuar me dokumente zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Arsimit se dy fëmijët e tij kanë qenë me bursa për studime në Rusi, në referim të paragrafit 11.1 të vendimit të Komisionit, në të cilin arsyetohet se referuar dokumenteve të përcjella nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, në analizën financiare janë llogaritur vetëm shpenzimet e jetesës dhe jo ato të arsimimit, nga ku subjekti i rivlerësimit pretendon se arsimimi i tyre është kryer falas me mbështetjen e shtetit shqiptar dhe atij rus. Trupi gjykues, në shqyrtim të këtij pretendimi, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstaton se Komisioni nuk i ka llogaritur subjektit shpenzime arsimimi, pra, pagesë shkolle, por vetëm shpenzime akomodimi,*

ushqimi dhe transporti. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson këtë pretendim jorelevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit për shpenzimet e arsimimit. Edhe aktet¹⁰³ e paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës me parashtrimet në Kolegj, me qëllim për të vërtetuar faktin se i biri L. H. dhe e bija A. H., kanë studiuar në Fakultetin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Moskë, me kohë të plotë, përkatësisht në periudhat 01.09.2004-12.10.2009 dhe 01.09.2006-30.06.2012, me bursë, në vlerësimin e trupit gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, vlerësohen si të parëndësishme për vendimmarrjen, për sa kohë fakti që kërkohet të provohet përmes tyre rezulton i provuar gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes në Komision.

69. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni si organ quasi gjyqësor, nuk mund të vendosë standarde lidhur me shpenzimet e jetesës dhe se të vetmet standarde që duhet të merren parasysh janë ato të INSTAT-it, të cilat palët kanë të drejtë t'i debatojnë nëpërmjet ekspertëve*. Në ngritjen e këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i referohet paragrafit 11.5 të vendimit të Komisionit në të cilin arsyetohet: *“11.5 Për pjesën e vitit kur fëmijët e subjektit kanë qenë në Shqipëri, shpenzimet e jetesës janë vendosur sipas standardit të zbatuar nga Komisioni, të plotpjestuar me muajt e qëndrimit në Shqipëri”*. Në akt ekspertimet private të paraqitura në Kolegj në cilësinë e provës, pretendohet se shpenzimet jetike duhet të përllogariten sipas numrit të anëtarëve të familjes në vitin përkatës. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, pas kontrollit të analizës financiare paraqitur në faqen 32 të vendimit objekt shqyrtimi nga Njësia e Shërbimit Ligjor, trupi gjykues vëren se Komisioni i ka përllogaritur shpenzimet e jetesës sipas shkresës së përcjellë nga ILDKPKI-ja në Kolegj¹⁰⁴, bazuar në standardet e raportuara nga institucioni i vetëm i specializuar për statistikat, INSTAT-i, duke konsideruar numrin e anëtarëve në familje, bazuar edhe në informacionin e ekstraktuar nga të dhënat për hyrje-daljet e tyre nga vendi evidentuar nëpërmjet sistemit TIMS, administruar në Komision, përmes së cilit, konkretisht, janë përllogaritur muajt e qëndrimit të L. dhe A. H. në Shqipëri.
70. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *“Shuma prej 7.880 eurosh e transferuar për fëmijët për studime, përmes Western Union, duhet konsideruar për efekt të analizës financiare sepse kjo shumë është dy herë, si në deklaratën vetting, ashtu dhe në përgjigje të pyetësorit nr. x. Mospërputhjet me deklaratimet e pyetësorit standard mund të kenë ardhur nga keqkuptimet në lidhje me pyetjet për kohën dhe pasja parasysh e kontributeve të gjyshërve dhe familjarëve”*. Këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit e ngre në referim të paragrafit 11.6 të vendimit të Komisionit, në të cilin arsyetohet se: *“11.6 Subjekti ka bërë deklaratime të ndryshme lidhur me shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për fëmijët në Rusi. (i) Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se për periudhën 01.01.2010-31.12.2014 ka transferuar përmes Western Union për fëmijët për studime shumë prej 7.880 eurosh. (ii) Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se për të përballuar jetesën e fëmijëve ka pasur shpenzime që kapin vlerat 11.800 euro dhe 500 euro. (iii) Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se së bashku me bashkëshorten kanë transferuar nëpërmjet Unionit Financiar shumë prej 7.880 eurosh nga kursimet nga pagat*

¹⁰³ (i) Vërtetim nr. {***}, datë 15.01.2020, lëshuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë; si dhe (ii) dy vërtetimet në gjuhën ruse, përkatësisht, nr. {***}, datë 14.01.2020 dhe nr. {***}, datë 15.01.2020, lëshuar nga Instituti Shtetëror i Moskës për Marrëdhëniet me Jashtë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, së bashku me vërtetimet përkatëse të përkthimit.

¹⁰⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

e tyre". Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës edhe një tabelë përmbledhëse mbi vlerat monetare prej 11.800 EUR + 500 USD në total, të dërguara në Moskë, Rusi, gjatë periudhës 2004 – 2010, nëpërmjet Western Union Albania, shoqëruar me 8 (tetë) mandate dërgese parash që i përkasin viteve 2004, 2005, 2006, 2007, 2008 dhe 2010, në adresë të të birit L. H. dhe të bijës A. H., në cilësinë e provës. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, trupi gjykues konstaton se këto shpenzime janë përfshirë në analizën financiare në vlerën 11.800 EUR + 500 USD, aq sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson këtë pretendim jorelevant në drejtim të kundërshtimit të konkluzionit të Komisionit lidhur me shpenzimet e studimit dhe aktet e sipërcituara, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, vlerësohen si të parëndësishme për vendimmarrjen, për sa kohë fakti që kërkohet të provohet përmes tyre rezulton i provuar gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes në Komision.

71. Subjekti i rivlerësimit pretendon që *dhurimet e gjyshërve dhe dajës Q. D. nuk ishte e nevojshme të deklaroheshin, sepse nuk janë bërë me kontrata, por janë bërë cash dhe edhe sikur ato të bëheshin me kontrata, përsëri do të quheshin fiktive dhe të pabesueshme nga ILDKPKI-ja*. Sipas tij, gjyshërit dhe daja i fëmijëve kanë pasur mundësi financiare për përballimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve në Rusi, duke iu referuar aktit noterial që ngarkonte shtetasin Q. D. për tërheqjen e depozitës bankare, të lënë si trashëgimi nga babai i tyre, nga e cila bashkëshortja M. H. kishte marrë edhe pjesën e nënës së saj.

71.1 Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në paragrafin 11.8 arsyeton: *"Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk paraqiti argumente të mjaftueshme për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni. Siç ka shpjeguar edhe në lidhje me mundësinë financiare për krijimin dhe përdorimin e depozitës prej 2.500.000 lekësh nga puna e bashkëshortes në biznesin e babait të saj Z. D., subjekti i rivlerësimit thekson faktin se gjyshërit dhe daja i fëmijëve kanë kontribuar në shkollimin e fëmijëve në Rusi, por pa provuar mundësinë financiare të tyre për përballimin e këtyre shpenzimeve"*. Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në parashtrimet në Kolegj, duke pretenduar se: *"Komisioni me pa të drejtë nuk ka konsideruar si burim të ligjshëm depozitën bankare në vlerën 2.652.476,03 lekë si pasuri të trashëgimlënësit Z. D., nga të cilat bashkëshortja e subjektit përveç 1/7 kishte përfituar edhe pjesën e nënës së saj S. D., duke përfituar në total vlerën prej 757.850 lekësh"*.

71.2 Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga analizimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se: (i) në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, si një ndër burimet e përballimit të shpenzimeve të studimit të fëmijëve, ka deklaruar edhe ndihmën nga prindërit e bashkëshortes; (ii) i pyetur mbi vlerën e shpenzimeve të përballuara nga gjyshërit dhe ato të përballuara nga vetë ai, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, se Z. D., *i cili ka ndërruar jetë në vitin 2005, i ka mbuluar të gjitha shpenzimet për ushqim dhe akomodim djalit, për vitet akademike 2003-2004 dhe 2004-2005, në shumën 500.000 lekë për çdo vit akademik. Këtë shumë lekësh, ai ua jepte fëmijëve në ditën që niseshin për në shkollë. Fëmijët kanë 5 (pesë) daja, vëllezër të nënës së tyre M., të cilët çdo fillim viti, kur L. dhe më pas A., niseshin për në shkollë, kontribuonin me shumë të hollash në lekë apo valutë të*

huaj, si dhuratë për të përballuar me sukses studimet. Pas vdekjes së gjyshit të tyre [...] në vitin 2005, deri në vitin 2007, këtë veprim e kryente gjyshja e tyre, e ndjera S. D., e cila ka ndërruar jetë në këtë vit; (iii) kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumente provues mbi këto shpenzime, subjekti i rivlerësimit deklaroi në përgjigje të pyetësorit nr. 3 se nuk disponon dokumente provues, pasi shumat e lekëve u jepeshin fëmijëve në dorë, kur largoheshin për fillimin e vitit shkollor. Sipas subjektit, shpenzimet për akomodim dhe ushqim të fëmijëve në periudhën 2006 - 2007 janë mbuluar nga gjyshja S. D., ndërsa pas vitit 2007 deri në vitin 2011, janë mbuluar nga daja i tyre Q. D., me të ardhurat e depozituara nga gjyshërit e vajzës në Raiffeisen Bank ShA, depozitë të cilën e ka tërhequr me aktin *veprim arke*. Në vijim, subjekti ka deklaruar se: “Për shkak se në periudhën që fëmijët kanë qenë të dy bashkë, dhe jetonin në të njëjtin konvikt, shumat e lekëve të shpenzuara prej tyre, për ushqim dhe akomodim, kanë qenë në masën 700.000 lekë, për një vit shkollor, për të dy fëmijët. Shumën prej 2.650.000 lekësh e ka paguar Q. D., ndërsa pjesën tjetër në shumën që kemi transferuar unë dhe bashkëshortja ime nëpërmjet Unionit Financiar në shumën 7880 euro janë paguar nga ana ime dhe e bashkëshortes sime, me kursimet nga pagat tona, për periudhën nga 2007 deri në vitin 2011, [...]”.

71.3 Lidhur me burimin dhe mundësinë financiare të gjyshërve dhe dajës së fëmijëve për përballimin shpenzimeve për shkollimin e fëmijëve, në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se Z. D. ka nisur që në vitin 1992 aktivitetin ekonomik “{***}”, në qytetin e Kavajës, të cilin e ka ushtruar deri në vitin 2005. Sipas subjektit ai ka pasur depozitë në Raiffeisen Bank në shumën 2.652.416 lekë, të cilat janë tërhequr nga i autorizuari me prokurë të posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.04.2006, Q. D., daja i fëmijëve, shumë e cila është tërhequr me mandatin e datës 19.04.2006 nga Raiffeisen Bank ShA. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti i rivlerësimit i ka shoqëruar përgjigjet e tij me aktet shkresore: (i) certifikatë regjistrimi biznesi i vogël në emër të Z. D.t, person fizik, me NIPT {***}, regjistruar në gjykatë me vendim nr. {***}, datë 18.07.1992; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 08.05.2020, e DRT-së Durrës, e cila konfirmon që subjekti “Z. D.”, ka qenë i regjistruar, me aktivitet në Durrës, *me objekt aktiviteti* “{***}”, me status *çregjistruar*, duke realizuar të ardhura për periudhën 1992 - 2005; (iii) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.04.2006, përmes së cilës shtetasit S., B., E., A., M. dhe E. D., në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit Z. D., sipas vendimit nr. {***}, datë 07.03.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, caktojnë si përfaqësues të posaçëm bashkëtrashëgimtarin Q. D., të cilit i japin tagër të tërheqë depozitën që trashëgimlënësi ka pasur në Raiffeisen Bank ShA, sipas librezës së kursimit nr. {***} dhe nr. klienti {***}, datë 01.11.2004; (iv) veprim arke në Raiffeisen Bank ShA të datës 19.04.2006 të kryer nga Q. D. me përshkrim “Mbyllje depozite, tërheqje me prokurë [...] në vlerën 2.652.475.03 lekë”; (v) në rapësimet mbi rezultatet e hetimit¹⁰⁵, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar faktin e moskonsiderimit me burime të ligjshme të kontributeve për shkollimin e fëmijëve, për shkak të mosdeklarimit të tyre në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, duke deklaruar se ndarja

¹⁰⁵ Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arriti në konkluzionin se: “Në analizën financiare, shumat e deklaruara nga subjekti si kontribute të gjyshërve, për shkollimin e fëmijëve në Rusi, nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme. Kjo për faktin se subjekti nuk i ka deklaruar asnjëherë këto dhurime dhe as burimet e tyre në deklaratat periodike dhe as në deklaratën vetting”.

e depozitës në vitin 2006, nga e cila 2/6 i takoi bashkëshortes M. H., përveç kontributeve të tjera që kanë dhënë dajat, janë prova të plota për t'i konsideruar ato me burime të ligjshme.

71.4 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i kuadrit ligjor në fuqi, trupi gjykues vëren se ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në nenin 15, pika 1, shkronja “b”, parashikon se: “[...] *Nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi*”. Ky përcaktim ka gjetur pasqyrim edhe në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale” të deklaratës së interesave privatë periodikë, e cila kërkohet të plotësohet nga subjektet e rivlerësimit, nëse kanë marrë dhurata dhe trajtime preferenciale në vlera mbi 10.000 lekë, në mënyrë të pakushtëzuar nga fakti nëse këto dhurime janë kryer në *cash* ose përmes ndonjë kontrate. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në asnjë prej DIPP-ve 2005-2011, nuk ka deklaruar dhurime në vlera mbi 10.000 lekë, gjatë periudhës së studimit të fëmijëve në Moskë, Rusi. Lidhur me mundësinë financiare të gjyshit dhe dajës së fëmijëve, përkatësisht Z. D. dhe Q. D., nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar, trupi gjykues konstaton se shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.05.2020, e DRT-së Durrës nuk jep informacion mbi të ardhurën *neto* të realizuar nga aktiviteti “{***}” në emër të Z. D., ndërkaq nuk provohet me ndonjë dokument që daja i fëmijëve Q. D. ka përdorur depozitën e sipërcituar për të paguar 500.000 lekë në vit për shpenzime akomodimi dhe ushqimi, për fëmijët e subjektit, gjatë shkollimit të tyre në Moskë, pas vdekjes së të atit Z. D. në vitin 2005. Në konkluzion të kësaj analize, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit *së pari*, nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë dhe, *së dyti*, nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor apo financiar që të provojë transferimin e këtyre shumave për llogari të fëmijëve të subjektit në Rusi, trupi gjykues vlerëson, sikurse edhe Komisioni, të mos i konsiderojë këto dhurime me burime të ligjshme.

72. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *Komisioni nuk ka tagër nga Kushtetuta apo ligji nr. 84/2016, që të përllogarishë shpenzimet e subjektit/ve, bazuar në vendimin e Kolegjit, pasi çdo rast është individual, çmimet e biletave të udhëtimit varen nga destinacioni, klasi i udhëtimit, mjeti, linja. Shpenzimet për fjetje dhe qëndrim varen nga vendi dhe niveli i jetesës që ka vendi ku kanë udhëtuar subjektet*. Subjekti i rivlerësimit e ngre këtë pretendim në referim të arsyetimit të Komisionit në shkronjën “c”, pika (ii), faqe 33 të vendimit objekt shqyrtimi, sipas së cilës, në zërin “shpenzime” përfshihen ndër të tjera: *shpenzime udhëtimi, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS – për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2015, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [...]*. Në aktet e ekspertimit private të datës 21.05.2024 dhe datës 24.06.2024, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës me parashtrimet e tij në Kolegj, kundërshtohet përllogaritja e shpenzimeve të udhëtimit nga ana e Komisionit. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës edhe të dhënat mbi hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes dhe dy fëmijëve

të tij, të printuara nga sistemi *TIMS*, për periudhën 01.01.2004 -19.01.2006, përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë¹⁰⁶.

72.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, në kushtet e mungesës së një rregullimi të posaçëm ligjor dhe nënligjor për vlerësimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, Kolegji në vendimin nr. 11/2019 (JR), bazuar në tagrin ligjor të dhënë nga neni 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcaktuar një metodologji për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, e cila përbën jurisprudencë të konsoliduar të tij dhe është orientuese për Komisionin. Sa i takon pretendimeve të ngritura lidhur me shpenzimet e udhëtimit, trupi gjykues konstaton fillimisht se në akt ekspertimet e depozituara përkatësisht me parashtrimet e datës 21.05.2024 dhe në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024, ngrihen pretendime të ndryshme për të njëjtin fakt, konkretisht:

i. Ndërsa në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 nuk pretendohen shpenzime udhëtimi për vitin 2003, në aktin e datës 24.06.2024 këto shpenzime pretendohen të paguara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë, duke deklaruar se *vlerën e biletës nuk e dimë*.

ii. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2006 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 796.647 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 476.420 lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 542.542 lekë, argumentuar me faktin *se ka dy bileta vajtje-ardhje lënë të hapura për një vit*. Ky pretendim i subjektit nuk mbështetet në dokumentacion.

iii. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2007 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 483.640 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 108.348 lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 321.257 lekë, argumentuar me faktin *se ka dy bileta vajtje-ardhje lënë të hapura për një vit*.

iv. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2008 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 150.899 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 98.664 lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 124.469 lekë.

v. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2009 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 348.412 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 55.284 lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 212.031 lekë.

vi. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2010 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 259.575 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 0 (zero) lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 105.884 lekë.

vii. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2011 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 230.961 lekë, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 0 (zero) lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 205.801 lekë.

viii. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2012 përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 167.664 lekë, në

¹⁰⁶ Sipas shkresave me nr. {***} prot., nr. {***} prot., nr. {***} prot., nr. {***} prot., datë 30.05.2024.

akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 49.532 lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 125.550 lekë.

ix. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2014, në akt ekspertimin e datës 21.05.2024 pretendohen në vlerën 0 (zero) lekë, ndërsa në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024 pretendohen në vlerën 27.896 lekë. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit i pretendon në akt ekspertimin e depozituar në seancën gjyqësore të datës 24.06.2024, në vlerën 87.035 lekë nga 22.024 lekë përlllogaritur nga Kolegji në linjë me Komisionin.

x. Në përmbledhje të sa konstatuar më sipër, ndodhur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion sa pretendon, ndërsa paraqet vlera të ndryshme në akte të ndryshme për koston e udhëtimeve ndër vite, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i tij lidhur me shpenzimet e udhëtimit nuk qëndron dhe vendos t'i konsiderojë ato sikurse përlllogaritur edhe nga Komisioni në vendim, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në vendimin nr. 11, datë 22.05.2019, të Kolegjit.

73. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *është e pakuptueshme se si është llogaritur pamundësia financiare në total në shumën 15.212.981 lekë dhe aq më tepër sa është shuma e llogaritur si e ardhur e ligjshme. Kjo sipas tij për të bërë vlerësimin nëse është tejkalluar parashikimi kushtetues për "dyfishin e pasurisë"*. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues referuar përmbajtjes së vendimit vëren se në asnjë pjesë të tij Komisioni nuk mban qëndrim apo konstaton se pasuria e subjektit të rivlerësimit është më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Edhe masa disiplinore e shkarkimit nga detyra dhënë për subjektin e rivlerësimit i atribuohet deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe cenimit të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji dhe jo sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me dyfishin e pasurisë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe jorelevant për shqyrtim në raport me zgjidhjen e çështjes.
74. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Metodologjia financiare e zbatuar nga këshilltarët ekonomikë, duke bërë analiza pjesore dhe jo të nisura nga viti i parë deri në vitin e fundit, nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Aneksit të Kushtetutës e as nga ligji nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se metodologjia e analizës financiare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, përcaktohet në shkencën e financës bazuar në parimin "të ardhura - shpenzime - pasuri neto = tepriçë/mungesë" dhe i referohet momentit të krijimit të pasurisë¹⁰⁷. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për analizë të nisur nga viti i parë tek i fundit, duke përlllogaritur në mënyrë totale të ardhurat e gjithë periudhës, përkundrajt pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar dhe vjen në kundërshtim me logjikën e ligjit dhe metodologjinë e procesit të rivlerësimit.*

¹⁰⁷ Pika 7 e Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, përcakton: "7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre".

75. Trupi gjykues, në vijim të trajtimit të shkakut të ankimit në paragrafin 20 të këtij vendimi, e gjen me vend të ndalet në kontrollin e zbatueshmërisë së nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga ana e Komisionit. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut të drejtësia lidhet me vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kritere apo vlerësimin tërësor të procedurave, por nga ana tjetër kjo dispozitë nuk e lidh aplikimin e konkluzionit për cenimin e besimit të publikut në formë kumulative me secilin prej kritereve. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se ky konkluzion i referohet vlerësimit tërësor të çështjes, nga analizimi i të cilës evidentohen një sërë sjelljesh të subjektit të rivlerësimit, shfaqur përmes veprimeve apo mosveprimeve të tij, të tilla si: (i) pranimi i dhurimit të pasurisë së paluajtshme “Tokë kullotë” në vitin 2014 nga persona të lidhur me të, në kushtet e ndalimit ligjor të parashikuar nga neni 23, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; (ii) përdorimi nga subjekti i rivlerësimit pa kundërshtëpërblim dhe pa ndonjë akt formal, i dy pasurive të paluajtshme në qytetin e Sarandës, përkatësisht në periudhat korrik 2003 - janar 2005 dhe janar 2005 - qershor 2010; (iii) përdorimi pa akt formal i automjetit të markës “Mercedes-Benz” nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, përkatësisht në vitin 2017, në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe periudhën 15.09.2016 - 25.12.2016; (iv) pranimi i dhurimit për mbulimin e shpenzimeve të një udhëtimit në Rusi në vitin 2006, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur; si dhe (v) transaksione jashtë logjikës financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me shitblerje automjetesh, si veprime që ngjallin dyshime mbi vërtetësinë e tyre e që bien ndesh me sjelljen jashtëgjyqësore që një prokuror duhet të ketë, duke iu bindur ligjit gjatë gjithë kohës, me qëllim për të forcuar besimin e publikut dhe të mos pranojë dhurata, përfitime apo trajtime që mund të ngrenë pikëpyetje mbi integritetin e tij, parashikuar në *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë*, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005¹⁰⁸ dhe *parimet e Bangalores*¹⁰⁹ mbi sjelljen e gjyqtarëve, të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët. Bazuar në këto argumente, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit që subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kryerjes së këtyre veprimeve, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.
76. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 433, datë 03.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

¹⁰⁸ *Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datë 31 maj 2005, pjesa IV “Sjellja private”:*

<https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

¹⁰⁹ *Komentari i Parimeve të Bangalores për sjelljen Gjyqësore, paragrafi 181:*

https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 433, datë 03.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sali Hasa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 08.07.2024, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANETAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

Nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi